FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 92

Tiranë – E premte, 28 qershor 2019

PËRMBAJTJA

		Faqe
Dekret i Presidentit nr. 11208, datë 19.6.2019	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	6539
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 390, datë 12.6.2019	Për autorizimin e drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për negociimin e nënshkrimin e rinovimit të Marrëveshjes së Partneritetit Strategjik, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë "*Microsoft Corporation*".....	6539
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 398, datë 19.6.2019	Për miratimin e dokumentit "Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri – tema 'Modeli digjital i terrenit'".....	6540
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 400, datë 19.6.2019	Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe të Planit të Veprimit 2019–2022.....	6597
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 416, datë 21.6.2019	Për një ndryshim në vendimin nr. 313, datë 15.5.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2019, miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për organizimin e zgjedhjeve për organet e vetëqeverisjes vendore të vitit 2019".....	6689
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 431, datë 26.6.2019	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikualifikimi i sheshit 'Italia'", Tiranë.....	6689

DEKRET
Nr. 11208, datë 19.6.2019

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e Ministrisë së Brendshme

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Ardian Sulejman Aliaj
2. Esravita Elez Lisaj
3. Elisabeta Albert Gravani
4. Blerta Man Hilaj (Hasa)
5. Suzana Vahit Zlatiçanin (Eminaj/Kerstoja)
6. Geraldo Hekuran Kormaku
7. Matilda Sejdin Sejdinaj
8. Merita Vasil Shtrepi
9. Bojana Zllatko Matanoviq (Matanović)
10. Lindita Ali Buhmann (Gorniak/Emini)
11. Ivana Velko Zlatiçanin (Kerstoja)
12. Albana Lavdosh Qejvanaj
13. Afrim Florian Ismailaj
14. Kastriot Enver Çelanji
15. Adela Xhevdet Bakalli (Shehu)
16. Zdravko (Zdrafko) Arso Krstoviq (Nikollaj/Krstovic)
17. Jorin Bujar Luzi
18. Dejana Zllatko Matanović (Matanoviq / Matanović)
19. Petraq Pandeli Seva
20. Edisona Andrea Sokoli (Diamandi)
21. Elda Ylli Dedja

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 390, datë 12.6.2019

PËR AUTORIZIMIN E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT PËR NEGOCIIMIN E NËNSHKRIMIN E RINOVIMIT TË MARRËVESHJES SË PARTNERITETIT STRATEGJIK, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQËRISË "*MICROSOFT CORPORATION*"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", dhe të ligjit nr. 35/2016, "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizimin e drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për negociimin e nënshkrimin e rinovimit të marrëveshjes së partneritetit strategjik, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë "*Microsoft Corporation*".
2. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 398, datë 19.6.2019

PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT "STANDARDET SHTETËRORE PËR SPECIFIKIMET TEKNIKE TË INFORMACIONIT GJEOHAPËSINOR NË SHQIPËRI – TEMA 'MODELI DIGJITAL I TERRENIT'"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "gj", të pikës 2, të nenit 11, e të pikës 1, të nenit 16, të ligjit nr. 72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentit "Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri – tema 'Modeli digjital i terrenit'", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) dhe autoritetet përgjegjëse për krijimin, ruajtjen e përditësimin e të dhënave gjeohapësinore për ndjekjen e zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

STANDARDET SHTETËRORE PËR SPECIFIKIMET TEKNIKE
TË INFORMACIONIT GJEOHAPËSINOR
NË SHQIPËRI
TEMA: MODELI DIGJITAL I TERRENIT

PËRMBAJTJA

1. PËRSHKRIMI I STANDARDEVE
2. HYRJE
2.1 Si lexohet dokumenti
2.2 Detyrimet ligjore
2.3 Fusha e veprimit
3. TEMA
3.1 Modeli Digjital i Terrenit
3.1.1 Përshkrimi i Nëntemës – Lartësitë: Tipat bazë
3.1.1.1 Diagrami Uml
3.1.1.1.1 Lartësitë: Tipi bazë: Numërtimet - Diagrami
3.1.1.2 Katalogu i Tipologjisë
3.1.1.2.1 Vlerat e llojit të sipërfaqes
3.1.1.2.2 Vlerat e llojit të lartësisë së matur
3.1.2 Përshkrimi i Nëntemës – Rrjeti i mbulimit i të dhënave të lartësive
3.1.2.1 Diagrami Uml
3.1.2.1.1 Rrjeti i mbulimit i të dhënave të lartësive: Të përgjithshme - Diagrami
3.1.2.1.2 Rrjeti i mbulimit i të dhënave të lartësive: Numërtimet dhe Kodlistat - Diagrami
3.1.2.1.3 Rrjeti i mbulimit i të dhënave të lartësive: Diagrami
3.1.2.1.4 Rrjeti i mbulimit i të dhënave të lartësive: Klasat e jashtme, Diagrami
3.1.2.2 Katalogu i Tipologjisë
3.1.2.2.1 Rrjeti i mbulimit i të dhënave të lartësive
3.1.2.2.2 Rrjeti i mbulimit shtesë i të dhënave të lartësive
3.1.3 Përshkrimi i Nëntemës - Elementet Vektor të Lartësive
3.1.3.1 Diagrami Uml
3.1.3.1.1 Elementet vektor të lartësive - Të përgjithshme - Diagrami
3.1.3.1.2 Elementet vektor të lartësive - Diagrami
3.1.3.1.3 Elementet Vektor Të Lartësive: Numërtimet dhe Kodlistat - Diagrami
3.1.3.2 Katalogu i Tipologjisë
3.1.3.2.1 Datumi i Projektuar
3.1.3.2.2 Izoipse
3.1.3.2.3 Lartësia e pikës
3.1.3.2.4 Objektet vektor të lartësive
3.1.3.2.5 Vijat e thyerjes
3.1.3.2.6 Vlerat e klasifikimit të lartësisë së pikës
3.1.3.2.7 Vlerat e llojeve të lartësisë së pikës
3.1.3.2.8 Vlerat e llojeve të vijave të thyerjes
3.1.3.2.9 Zona pa informacion
3.1.3.2.10 Zonat e kufizuara
3.1.3.2.11 Vlerat e llojit të izoipseve
3.1.4 Përshkrimi i Nëntemës – Lartësitë TIN
3.1.4.1 Diagrami Uml
3.1.4.1.1 Lartësitë-TIN: diagrami

3.1.4.2 Katalogu i Tipologjisë

3.1.4.2.1 Lartësitë Tin

3.1.5 Metadata

3.1.6 Sistemi Referencë, Njësitë e Matjes dhe Rrjetat Gjeografike

Sistemet Standarde të Referimit, Njësitë e Matjeve dhe Rrjetet

A. Korniza referuese gjeodezike e Shqipërisë

B. Sistemet koordinative referencë sipas INSPIRE

C. Sistemet e referencës kohore

D. Njësitë e matjeve

3.1.7 Cilësia e të Dhënave

3.1.7.1 Kompletimi - Autorizimi. (Completness-Commission)

3.1.7.2 Kompletimi - Përjashtimi. (Completeness – Omission)

3.1.7.3 Përputhja ligjore – Përputhja konceptuale. (Logical consistency – Conceptual consistency)

3.1.7.4 Përputhja ligjore – Përputhja me domain-in. (Logical consistency – domain consistency)

3.1.7.5 Përputhja logjike – Përputhja e formatit. (Logical consistency – format consistency)

3.1.7.6 Përputhja logjike – Përputhja topologjike. (Logical consistency- Topological consistency)

3.1.7.7 Saktësia e pozicionimit – Saktësia absolute apo e jashtme. Positional accuracy - absolute or external accuracy)

3.1.7.8 Saktësia e pozicionimit - Saktësia e pozicionimit të të dhënave të rrjetit të rregullt (Gridded data position accuracy)

4. ANEKSE

4.1 Katalogu i Topologjive

4.2 Mbledhja e të Dhënave – (*Data Capture*)

4.3 Kodi Epsg për Krgjsh

1. PËRSHKRIMI I STANDARDEVE

Ky dokument përmban standardet e specifikimeve teknike të të dhënave gjeohapësinore për ndërtimin e NSDI, duke u mbështetur në Direktivën INSPIRE. Autori i këtij produkti është Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG). Data e publikimit të versionit Nr.1 është Maj 2017. Emërtimi i dokumentit është: ASIG_Standard_NSDI_2017_ DTM _v.1 ku:

ASIG – Autoriteti përgjegjës për krijimin e standardit

Standard – Lloji i dokumentit

NSDI – Qëllimi i dokumentit

2017 – Viti i krijimit

DTM – Tema për të cilën është krijuar standardi: Modeli Dixhital i Terrenit. Kjo temë sipas nenit 11 të ligjit nr. 72/2012 përkon me temën "Elevation" të aneksit II të Direktivës INSPIRE.

v.1 – Numri i versionit të standardit

2. HYRJE

2.1 SI LEXOHET DOKUMENTI

Ky material është i organizuar në katër kapituj kryesorë:

1. Përshkrimi i standardeve: Në këtë pjesë jepet emërtimi dhe autori i standardeve.

2. Hyrje: Në këtë pjesë jepen përshkrime dhe shpjegime për të kuptuar mënyrën si organizohet i gjithë informacioni dhe si mund të kuptohet më lehtë.

3. Tema: Në këtë pjesë jepen specifikimet teknike për këtë temë.

4. Anekse: Në këtë pjesë jepen informacione shtesë shpjeguese në ndihmë të lexuesve.

Përmbajtja e kapitullit 3 është strukturuar në 6 pjesë kryesore:

1. **Përshkrimi i temës:** Këtu flitet në mënyrë të përgjithshme për përmbajtjen e temës.

2. **Diagramet UML:** Këtu jepet Përmbajtja e Katalogut të Tipologjive përkthyer sipas gjuhës UML.

3. **Katalogu i Tipologjive**: Këtu shpjegohet struktura e temës me të gjithë elementet e saj përbërëse.

4. **Metadata**: Këtu jepen specifikimet teknike për metadata-t e temës përkatëse.

5. **Sistemi Koordinativ Referencë**: Këtu përcaktohet sistemi koordinativ referencë që është miratuar sipas vendimit nr. 669, datë 7.8.2013, i ndryshuar me vendim nr. 322, datë 27.4.2016.

6. **Cilësia e të dhënave**: Këtu jepet një përshkrim mbi cilësinë e të dhënave të elementeve dhe matjes së tyre.

Diagramet UML ofrojnë një mënyrë të shpejtë për të parë elementet kryesore të specifikimeve dhe marrëdhëniet mes tyre. Përkufizimi mbi llojin e objektit gjeohapësinor, atributet dhe marrëdhëniet janë të përfshira në

'Katalogun e tipologjive' (*Feature Catalogue*). Personat të cilët kanë ekspertizë tematike, por nuk janë të familjarizuar me UML-në, mund ta kuptojnë plotësisht përmbajtjen e modelit të të dhënave duke u fokusuar te Katalogu i tipologjive. Për përdoruesit, Katalogu i tipologjive mund të jetë veçanërisht i dobishëm për të kontrolluar nëse ai përmban të dhënat e nevojshme për aplikacionet që ata përdorin.

Në tabelat e mëposhtme shpjegohet përmbajtja dhe mënyra e organizimit të informacionit në tabelat e të dhënave në Katalogun e tipologjive.

Tabelat nr. 1, 2, me anë të një shablloni, shpjegojnë mënyrën e organizimit të informacionit në tabelën e tipologjive dhe të atributeve të tyre.

Tabela nr. 3, me anë të një shablloni, shpjegon mënyrën e organizimit të informacionit në tabelën e kod listës.

Tabela 1

Emri - Emërtimi i tipologjisë	
Përkufizimi	Përkufizimi sipas direktivës INSPIRE për tipologjinë.
Përshkrimi	Shënime dhe përshkrime të tjera për tipologjinë.
Tipi i tipologjisë	**Tipi i elementit** që mund të jetë i këtyre llojeve: **«featureType»** - një element që mund të jetë real në terren apo një dukuri abstrakte **«dataType»** - një element tabelor që shërben vetëm si tabelë atributesh për t'u lidhur me një element tjetër **«enumeration» «codeList»** - listë e parapërgatitur vlerash ku elementi duhet të marrë vlerë. *Enumeration* nënkupton "renditje vlerash", ndërsa *codeList* nënkupton "listë vlerash ose ndryshe kod listë". Në dokument gjenden të shqipëruara si "Numërtimet dhe kodlistat". **«Imported»** - të dhëna të specifikuara në tema të tjera të direktivës INSPIRE. Në dokument gjenden "Të dhënat e importuara"
Gjeometria	Gjeometria e elementit sipas formatit vektor mund të gjendet në tri forma: **pikë, linjë ose poligon.** **Abstrakt** – kur elementi nuk është element real në terren, por konsiderohet vetëm si dukuri.
Shumëllojshmëria	Lloji dhe numri i vlerave që mund të marrë atributi: 0..* - mund të marrë shumë lloje vlerash ose asnjë vlerë 1..* - mund të marrë minimumi 1 vlerë ose shumë vlera 0..1 - mund të mos marrë asnjë vlerë ose nëse merr vlerë, duhet të marrë vetëm 1 vlerë të vetme. 1 - duhet të marrë detyrimisht 1 vlerë
I detyrueshëm	Po – nëse atributi është i detyrueshëm të plotësohet Jo – nëse atributi nuk është i detyrueshëm të plotësohet
Rol shoqërimi	Në tabelën e lidhjeve "Rol shoqërimet" tregohen marrëdhëniet hierarkike ndërmjet elementeve të ndryshme në këtë temë, si dhe në temat e tjera. Këto marrëdhënie pasqyrojnë lidhjet që realizohen në skemat UML.

Tabela 2

ATRIBUTET
-- Emri -- Emërtimi i atributit **-- Përkufizimi --** Përkufizimi sipas direktivës INSPIRE të elementeve **-- Përshkrimi --** Shënime dhe përshkrime të tjera për elementin [I detyrueshëm: Detyrueshmëria nëse atributi duhet të marrë vlerë, p.sh: PO]

Tabela 3

ATRIBUTET
Vlera e parë e listës së gatshme, p.sh: ***Ligjor*** **-- Emri --** Emërtimi i vlerës **-- Përkufizimi --** Përkufizimi sipas direktivës INSPIRE të elementeve
Vlera e dytë (etj.) e listës së gatshme, p.sh: ***Joligjor*** **-- Emri --** Emërtimi i vlerës **-- Përkufizimi --** Përkufizimi sipas direktivës INSPIRE të elementeve

2.1.1 KARAKTERISTIKAT E <<*VOIDABLE*>> DHE SHUMËLLOJSHMËRIA

Stereotipi <<*voidable*>> përdoret për të përshkruar ato përkatësi të objekteve gjeohapësinore që mund të jenë ose mund të mos jenë të pranishme në grupet e të dhënave gjeohapësinore, edhe pse mund të ekzistojnë në botën reale. Kjo nuk do të thotë që këtyre përkatësive duhet t'u jepet një vlerë.

Për të gjitha përkatësitë e përcaktuara për objektet gjeohapësinore duhet të paraqitet një vlerë – ose vlera përkatëse (nëse është e disponueshme në grupin e të dhënave që mirëmbahet nga ofruesi i të dhënave), ose vlera '*void*'. Një vlerë *void* nënkupton që nuk ekziston një vlerë përkatëse në grupet e të dhënave gjeohapësinore që mirëmbahen nga ofruesi i të dhënave ose që asnjë vlerë përkatëse nuk mund të nxirret nga vlerat ekzistuese.

Arsyeja e përdorimit të vlerës void duhet të paraqitet kurdo që të jetë e mundur duke përdorur një nga vlerat e listuara në kod listën Vlera e Arsyes së Pavlefshmërisë (*Void Reason Value*).

Stereotipi <<*voidable*>> nuk jep informacion nëse karakteristika ekziston apo jo në botën reale. Kjo shprehet duke përdorur shumëllojshmërinë:

Nëse një karakteristikë mund të ekzistojë apo mund të mos ekzistojë në botën reale, vlera minimale do të përcaktohet si 0. P.sh. nëse një adresë ka apo nuk ka një numër shtëpie, shumëllojshmëria e përkatësisë përkatëse do të jetë 0..1.

Nëse për një karakteristikë të caktuar ekziston të paktën një vlerë në botën reale, vlera minimale do të përcaktohet si 1. P.sh. nëse një njësi administrative ka gjithmonë të paktën një emër, shumëllojshmëria e përkatësisë përkatëse do të jetë 1..*.

2.1.2 NUMËRTIMET DHE KOD LISTAT (ENUMERATION AND CODELIST).

Kod listat modelohen si klasa në skemat e aplikimit, por vlerat e tyre menaxhohen jashtë skemave të aplikimit. Në kod listë, 'vlera të tjera' përcakton llojin e përmbajtjes së kod listës, e përcaktuar specifikisht si më poshtë:

'jo' përfaqëson kod lista që përmbajnë vetëm vlera të specifikuara në këtë rregullore.

'të kufizuara' përfaqëson kod lista që përmbajnë vlera të specifikuara në këtë rregullore dhe vlera të tjera të limituara të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave.

'të hapura' përfaqëson kod lista që përmbajnë vlera të specifikuara në këtë rregullore dhe vlera shtesë në çdo nivel, të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave.

'po' përfaqëson kod lista që përmbajnë vlera të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave.

Vlerat shtesë të përcaktuara nga ofruesit e të dhënave nuk duhet të zëvendësojnë apo të modifikojnë vlerat ekzistuese të përcaktuara në rregullore.

Në rastin kur ofruesit e të dhënave do të përdorin kod lista me vlera jo të përmbajtura në rregullore, ofruesit janë të detyruar t'i bëjnë këto vlera bashkë me përkufizimet e tyre, të disponueshme në një regjistër. Kjo do të mundësojë që dhe përdoruesit e tjerë t'i kuptojnë këto vlera dhe të kenë mundësi t'i përdorin.

2.1.3 PARAQITJA E DIMENSIONIT KOHOR

Skemat e aplikimit përdorin atributin "Fillimi i Ciklit Jetësor" dhe "Përfundimi i Ciklit Jetësor" për të regjistruar jetëgjatësinë e një objekti gjeohapësinor.

Atributi "Fillimi i Ciklit Jetësor" specifikon datën kur versioni i objektit gjeohapësinor është futur apo ndryshuar në grupin e të dhënave gjeohapësinore (në sistem). Atributi "Fillimi i Ciklit Jetësor" specifikon datën kur versioni i objektit gjeohapësinor është zëvendësuar apo tërhequr nga grupi i të dhënave gjeohapësinore (në sistem). Këto vlera kohore nuk kanë të bëjnë me karakteristikat kohore të objektit në botën reale.

Ndryshimet që bëhen në atributin "Fillimi i Ciklit Jetësor" nuk shkaktojnë ndryshime në atributin "Fillimi i Ciklit Jetësor".

Shënim i rëndësishëm:

Disa terma në Katalogun e tipologjive, si p.sh. FeatureType, DataType etj., nuk janë përkthyer qëllimisht në gjuhën shqipe. Qëllimi parësor është që të mos humbasin kuptimin gjatë përkthimit dhe së dyti të përdoret një gjuhë unike sipas termave të Direktivës INSPIRE.

2.2 DETYRIMET LIGJORE

Në bazë të ligjit nr. 72/2012, neni 16, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë", ASIG është përgjegjës për krijimin e standardeve për secilën nga temat e përcaktuara në ligj (neni 11), në përputhje me standardet evropiane (direktiva INSPIRE).

Standardet teknike të të dhënave gjeohapësinore për krijimin e NSDI në Shqipëri janë përshtatur nga specifikimet teknike të temave përkatëse në direktivën INSPIRE. Për implementimin e direktivës, kërkohet që të gjithë aktorët të zbatojnë disa standarde të përbashkëta, të cilat mundësojnë ndërveprimin e shërbimeve dhe harmonizimin e të dhënave.

Standardet (Rregullat e implementimit - IR) duhet të krijohen për fushat e mëposhtme:

- Metadata – në këtë fushë direktiva përcakton standardet se si duhen të jenë metadatat. Ky standard është unik dhe i aplikueshëm për të gjitha institucionet ose palët e treta (siç është e përcaktuar në fushën e veprimit të kësaj direktive), të cilët do të implementojnë këtë direktivë.

- Specifikimi i të dhënave – standardet e kësaj kategorie përfshijnë të gjitha atributet e objekteve të ndryshme që do të publikohen. INSPIRE ka përcaktuar disa atribute bazë të cilat do të shërbejnë për publikimin e të dhënave të ndryshme. Vendet e ndryshme, në varësi të ligjeve ose të nevojave të brendshme, mund të shtojnë atribute të tjera për t'i bërë sa më të përdorshme të dhënat. Të gjitha të dhënat që do të shtohen duhet të jenë të dokumentuara dhe të miratuara nga institucionet në rolin e autoritetit publik përgjegjës.

2.3 FUSHA E VEPRIMIT

Të gjitha autoritetet publike, kompani private apo individë që mbajnë ose përpunojnë të dhëna gjeohapësinore për llogari të institucioneve publike, janë të detyruar t'i nënshtrohen kësaj rregulloreje.

Bazuar në modelet e proceseve të biznesit, sistemi i propozuar nga direktiva INSPIRE ka proceset dhe ciklin jetësor si më poshtë:



Figura 1

Planifikimi – Është procesi gjatë të cilit krijohen strukturat e të dhënave të nevojshme për të publikuar informacionin në portal. Rezultatet e këtij procesi janë modelet e ndryshme të të dhënave.

Vlerësimi – Është procesi gjatë të cilit të dhënat ekzistuese testohen kundrejt modelit. Rezultati i këtij procesi do të jetë certifikimi i të dhënave ose nevoja për të modifikuar të dhënat që të përshtaten me modelet e përcaktuara gjatë procesit të vlerësimit.

Procesimi – Është procesi gjatë të cilit mblidhen dhe modifikohen atributet e të dhënave për të prodhuar informacion kuptimplotë. Manipulimi i tyre bëhet kundrejt modeleve të përcaktuara gjatë planifikimit. Rezultatet e këtij procesi janë bashkësi të dhënash gati për t'u publikuar.

Shpërndarja – Është procesi gjatë të cilit të dhënat vihen në dispozicion për përdoruesit (qytetarët, autoritetet publike, organizatat ose palët e treta). Përdoruesi mund të shkarkojë, të përdorë, të analizojë ose të citojë të dhënat. Publikimi i të dhënave bazohet në modelet e ndryshme të përdorimit.

Zbulimi – Është proces i vazhdueshëm gjatë të cilit zbulohen të dhëna të reja ose të dhëna jocilësore në të dhënat e publikuara.

Analiza – Është procesi i analizimit të të dhënave të evidentuara në fazën e zbulimit. Gjatë këtij procesi merret vendimi çfarë do të bëhet më të dhënat që janë evidentuar.

Përditësimi – Është procesi kur propozohet shtimi, modifikimi ose fshirja e të dhënave. Ky proces regjistrohet nga procesi i analizimit të të dhënave ekzistuese dhe të publikuara.

Arkivimi – Është procesi gjatë të cilit bashkësitë e të dhënave që nuk nevojiten të aksesohen arkivohen duke u bazuar në standarde lokale dhe në legjislacionin në fuqi të vendeve ku implementohet. Rezultat i këtij procesi janë të dhënat që bëhen të paaksesueshme për publikun, me akses vetëm nga autoritetet specifike. Këto të dhëna vazhdojnë të ruhen për arsye të përputhshmërisë me kuadrin ligjor në fuqi ose me standardet specifike.

Shkatërrimi – Është procesi gjatë të cilit të dhënat bëhen të parikuperueshme. Ky proces bazohet në standarde lokale ose në legjislacione në fuqi.

3. TEMA

3.1 MODELI DIXHITAL I TERRENIT

PËRMBLEDHJE

Lartësitë e sipërfaqes së një terreni, qoftë tokësorë ose barimetrike në natyrë, është një nga përshkruesit më të rëndësishëm të morfologjisë së Tokës. Tema e të dhënave të Modeli Dixhital i Terrenit përfshin modelet dixhitale të lartësisë për tokën, akullin dhe sipërfaqet oqeanike për lartësitë tokësore dhe barimetrike, si dhe për vijat bregdetare.

Të dhënat e Modelit Dixhital të Terrenit po përdoren në një gamë të gjerë aplikimesh si fusha e inxhinierisë civile, shkenca për Tokën (veçanërisht harta e përmbytjeve), planifikimi dhe menaxhimi i burimeve, fotogrametria (në veçanti

ortoimazheria) dhe qëllime ushtarake (mbrojtja), e cila është e reflektuar te rastet e përdorimit, që drejtojnë procesin e specifikimit të të dhënave.

Qëllimi kryesor i *Modelit Dixhital të Terrenit* është dhënia e një vlere të matur të lartësisë duke iu referuar një origjine të specifikuar (*Referencë Vertikale ose Datumi*). Kjo vlerë e matur mund të jetë kuotë (kur vlera matet në drejtim të kundërt të fushës së gravitetit të Tokës) ose *thellësi* (kur vlera matet në drejtim të fushës së gravitetit). Prandaj ato ndajnë parimet bazë të modelimit. Modelet e integruara të tokës-detit mund të jepen duke përdorur një vlerë të matur, të lartësisë ose thellësisë, referuar një reference të njohur vertikale. Kur një vlerë e matur e lartësisë përshkruan sipërfaqen e zhveshur të tokës ose fundit të detit modeli përkatës quhet *Modeli Dixhital i Terrenit (DTM*). Kur një vlerë e matur e lartësisë përfshin kuotat e objekteve të pranishme në sipërfaqe (p.sh. bimësia, objektet e krijuara nga dora e njeriut) modeli përkatës quhet *Modeli Dixhital i Sipërfaqes (DSM*).

Në linjë me teknologjitë ekzistuese janë dhënë tri metoda të përfaqësimit gjeohapësinor: rrjeti i rregullt (grid), si një kusht i detyrueshëm, gjithashtu vektori dhe rrjeti i parregullt i trekëndëshave (TIN), si kushte jo të detyrueshme. Secila prej tyre përshkruhet në një paketë të veçantë. Përveç kësaj, elementet e përgjithshme të modelimit, si numërtimet apo kodlistat dhe shërbimet e përgjithshme (dataType) përfshihen në skemën e aplikimit të llojeve të të dhënave.

Specifikimet e të dhënave për *Modelin Dixhital të Terrenit* përfshijnë paraqitjen e rrjetit të rregullt (*grid*), gjerësisht të përdorur, i cili bazohet në një gjeometri *mbulimi*, duke treguar vlerat e lartësive te pikat e një rrjeti të rregullt të rektifikuar (korrektuar). Për qëllime ndërkombëtare (paneuropiane) dhe ndërkufitare specifikimi i të dhënave rekomandon përdorimin e një rrjet specifik të përbashkët bazuar në koordinatat gjeodezike ETRS89 (e ngjashme me të dhënat e specifikimeve të *Ortoimazherisë*).

Në rastin e modelit të vektorit, ky specifikim të dhënash lejon përdorimin e gjeometrive 2-D ose 2.5-D. Në rastin e parë komponenti vertikal i koordinatave jepet si një atribut i një objekti gjeohapësinor dy dimensional, ndërsa në rastin e dytë të gjitha pikat në grupin e të dhënave të lartësisë shprehen duke përdorur tri koordinata, ku vlera e lartësisë përcakton koordinatën Z (të tretë). Modeli vektorial përbëhet nga lartësia e tokës dhe elementet e batimetrisë në formën e pikave me lartësi, izoipseve, si dhe vijave të thyerjeve. Këto elemente njihen mirë nga hartat topografike ose detare.

Forma tjetër alternativë e përfaqësimit gjeohapësinor specifikuar në INSPIRE është rrjeti i parregullt i trekëndëshave TIN, ku një grup elementesh gjeometrike (pika kontrolli, viza thyerje etj.,) që përfaqësojnë terrenin mblidhen bashkë. Paraqitja e të dhënave gjeohapësinore sipas këtij formati për këtë standard është opsionale. Ky grup mund të përdoret më vonë për të llogaritur një sipërfaqe duke ndjekur rregullat dhe metodat e trekëndëshave.

Ndërveprimi mbështetet duke harmonizuar elementet e metadatave, rekomandimet për cilësinë e të dhënave, dhe kodimet e përcaktuara për të lehtësuar shkëmbimin e të dhënave. Kodimi i parazgjedhur është GML. Të dhënat e rrjetit të rregullt të lartësive tokësore dhe lartësive barimetrike kodohen duke përdorur Mbulimin GML (Gjuha e Përcaktimit Gjeografik - Geography Markup Language). Më të parat (lartësitë tokësore), vlerat e lartësisë tokësore mund të jepen në mënyrë të alternuar duke përdorur skedarët e jashtëm në format TIFF. Për të fundit, vlerat batimetrike mund të përdoret në mënyrë opsionale, një skedar në përputhje me formatin standard BAG i Organizatës Hidrografike Ndërkombëtare, si një skedar i jashtëm për të dhënë vlerat e lartësisë. Vetëm metodat e kompresimit të të dhënave, që nuk çojnë në humbjen e të dhënave janë të vlefshme.

PËRKUFIZIME

1. 2-D

Koordinata hapësinore dydimensionale. Shembull - Dimensionet X dhe Y. Shënim - Në paraqitjen 2-D vlera e lartësisë përfshihet si një vlerë atributi i objektit gjeohapësinor (përfaqësimi vektorial).

2. 2.5-D

Koordinata hapësinore dydimensionale, ku vlera e lartësisë paraqitet nga një koordinatë shtesë e tretë (z). Shënim 1: Ndryshe nga paraqitja e saktë 3-D, koordinata e vërtetë Z nuk është pjesë e strukturës të të dhënave. Paraqitja

2.5-D mund të përdoret për llogaritjen e sipërfaqeve, por nuk mund të përdoret për volumet e llogaritura. Shënim 2: Nga një këndvështrim matematikor modelet e lartësisë 2.5-D janë funksione të tilla f(x y) ku çdo pikë P(x y) lidhet në mënyrë unike me një objekt f(x y)=z. Prandaj, format e terrenit si ngritjet nuk mund të modelohen, pasi një pozicion gjeohapësinore mund të shoqërohet vetëm me një vlerë të matur të lartësisë.

3. **Dimensioni i koordinatave**

Numri i matjeve ose boshtet që duhen për të përshkruar një pozicion në një sistem koordinativ [ISO 19107:2005].

4. **Mbulimi (Coverage)**

Funksionet "Coverage" përdoren për të përshkruar karakteristikat e një fenomeni të botës reale që zhvillohet në kohë dhe /ose hapësirë. Shembuj tipikë janë temperaturat, lartësitë, precipitimet, imazheria etj. Një "Coverage" përmban një grup vlerash, të cilat shoqërohen me një element gjeohapësinor, kohor, kohor-hapësinor, në përputhje me ISO 19123:2007. Shënim 1: Me fjalë të tjera, mbulimi është një tipar që ka vlera të shumta për çdo lloj atributi, ku çdo pozicion direkt brenda paraqitjes gjeometrike të tiparit ka një vlerë teke për çdo lloj atributi. Një vlerë e matur lartësie mund të jetë një nga llojet e atributit.

5. **Thellësia**

Vlera e Lartësisë së matur përgjatë një vije pingule në një drejtim që përputhet me fushën e gravitetit të Tokës (tatëpjetë). Shënim 1: Ky përkufizim shmang me qëllim referimin e termave kompleksë gjeodezikë. Nevojitet specifikimi i drejtimit në të cilin është matur vlera e lartësisë.

6. **Modeli Dixhital i Lartësisë (DEM)**

Modeli Dixhital i Sipërfaqes (DSM) ose Modeli Dixhital i Terrenit (DTM).

7. **Modeli Dixhital i Sipërfaqes (DSM)**

Modeli që përshkruan formën tredimensionale të sipërfaqes së Tokës, përfshirë të gjitha tiparet statike të vendosura mbi të. Fenomenet e përkohshme nuk formojnë pjesë të sipërfaqes, por për shkak të vështirësive teknike në heqjen e tyre disa prej tipareve mund të jenë të pranishme edhe në sipërfaqe.

Shembulli 1: Bimësia, ndërtesat dhe urat janë shembuj të tipareve statike. Shembulli 2: Makinat, kamionët dhe tipare të tjera dinamike janë shembuj të fenomeneve të përkohshme. Shënim 1: Për sipërfaqet DSM që përshkruajnë bazamentin e trupave ujorë (p.sh. tabani i detit) dhe ato tipare të vendosura mbi to, trupat ujorë nuk konsiderohen si pjesë të sipërfaqes së zhveshur të Tokës. Si rrjedhojë, ato përjashtohen nga DSM-ja. Shënim 2: Për sipërfaqet DSM ku çdo fenomen i përkohshëm nuk është filtruar dhe përjashtuar, devijimet duhet të shpjegohen në metadata.

8. **Modeli Dixhital i Terrenit (DTM)**

Sipërfaqja që përshkruan formën tredimensionale të sipërfaqes së zhveshur të Tokës, duke përjashtuar aq sa është e mundur çdo tipar tjetër të vendosur mbi të.

Shembull: Ndërtesat, urat ose bimësia nuk formojnë pjesë të një DTM-je. Shënim 1: Për sipërfaqet DTM që përshkruajnë bazamentin e trupave ujorë (p.sh. tabani i detit) dhe ato tipare të vendosura mbi to, trupat ujorë nuk konsiderohen si pjesë të sipërfaqes së zhveshur të Tokës. Si rrjedhojë, ato përjashtohen nga DTM-ja. Shënim 2: Për sipërfaqet DTM ku çdo tipar në sipërfaqen e zhveshur të Tokës nuk është filtruar dhe përjashtuar plotësisht, devijimet duhet të shpjegohen në metadata.

9. **Pozicioni direkt**

Pozicioni i përshkruar nga një grup i vetëm i koordinatave brenda një sistemi referues koordinativ [ISO 19107:2005].

10. **Domain**

Nënkupton një bashkësi vlerash të mirë përcaktuara, në përputhje me ISO/TS 19103:005. Shënim 1: Në rastin e një mbulimi të lartësisë, domain është struktura e mirë përcaktuar ku një mbulim është definuar. Me fjalë të tjera, pozicionimi ku jepen vlerat e lartësisë.

11. **Lartësia**

Vlerat e dimensionit vertikale të një objekti gjeohapësinor, që përfitohet nga një matje absolute referuar një të sipërfaqe të mirë përcaktuar, e cila në përgjithësi konsiderohet si origjinë.

Shembull 1: Kuota dhe thellësia janë tipare të lartësisë. Shembull 2: Gjeoidi ose niveli mesatar i detit janë shembuj të sipërfaqeve të konsideruara si origjinë për vlerat e lartësisë. Shënim 1: Termi, siç përdoret në këtë specifikim, integron të gjitha

matjet absolute të dimensioneve të kushtëzuara nga përbërësi vertikal, duke pasur ose pozicion ngjitës (lartësia) ose drejtim zbritës (thellësia). Interpretime të tjera të termit do të shmangen. Shënim 2: Termi nuk përfshin lartësitë relative të objektit gjeohapësinor me referencë tek objektet e tjera gjeohapësinore.

12. **Kuota**

Vlera e Lartësisë se matur përgjatë një vije pingule në drejtim të kundërt me fushën e gravitetit të Tokës (përpjetë). Shënim 1: Ky përkufizim shmang me qëllim referimin e termave kompleksë gjeodezikë. Nevojitet specifikimi i drejtimit në të cilin është matur vlera e lartësisë.

13**. Gamë**

Një grup vlerash atributesh e karakteristikash të shoqëruara nga një funksion me elemente të domain-it të një mbulimi [ISO 19123]. Shënim 1: Në rastin e një mbulimi të lartësisë, shtrirja është mbledhja e vlerave të lartësisë, të cilat njihen për vendndodhjet e përfshira brenda domain-it.

14. **Reference Sistemi Koordinativ – CRS**

Sistemi koordinativ referencë në të cilin mbështeten matjet gjeodezike.

15. **Rrjet koordinativ i rektifikuar (transformuar)'**

Nënkupton një rrjet koordinativ për të cilin ka një transformim afin përkatës mes koordinatave të rrjetit dhe koordinatave të një sistemi referimi koordinativ.

3.1.1 PËRSHKRIMI I NËNTEMËS – LARTËSITË: TIPET BAZË

Përshkrimi:

Modeli Dixhital i Terrenit përshkruan modele dixhitale për përshkrimin e tokës, akullit dhe sipërfaqeve oqeanike për sa i përket informacionit të lartësisë tokësore (kuotat) që lidhet me gravitetin absolut dhe informacionit për të dhënat batimetrike (thellësitë).

Kjo temë Tema përfshin:

- Lartësinë tokësore (domethënë lartësitë në sipërfaqen toka), paraqiten si:
- Modelet Dixhitale të Terrenit (DTM) që përshkruajnë formën tredimensionale të sipërfaqes së Tokës (topografia e sipërfaqes së tokës).
- Modelet Dixhitale të Sipërfaqes (DSM) që specifikojnë gjeometrinë tredimensionale përfshirë çdo tipar mbi tokë, për shembull bimësia, ndërtesat dhe urat.
- Të dhënat batimetrike, për shembull një rrjet i rregullt model i tabanit të detit.

Modeli i të dhënave i përfshirë në këtë specifikim synon të përshkruajë formën tredimensionale të sipërfaqes së Tokës për sa i përket vlerave të matura të Lartësive, si ato të kuotave ose të thellësive. Të dy vlerat i nënshtrohen dimensionit fizik vertikal, që matet përgjatë vijave pingule nga një sipërfaqe të mire-përcaktuar, siç është gjeoidi ose një nivel i mirë-përcaktuar i ujit.

VLERAT E MATURA TË LARTËSISË: KUOTA DHE THELLËSIA

Modelet e të dhënave të përfshira në këtë specifikim synojnë përshkrimin e formës tredimensionale të sipërfaqes së Tokës për sa i përket vlerave të matura të Lartësisë, ato kuotës ose thellësisë. Të dyja vlerat janë të kushtëzuara nga dimensioni vertikal fizik, i cili matet përgjatë vijes pingule nga një sipërfaqe e mirë përcaktuar, siç është gjeoidi ose një nivel specifik i ujit.

Orientimi i boshteve pozitive është ana e kundërt e fushës së gravitetit të Tokës në rastin e vlerës së kuotës (lartë) dhe në përputhje me fushën e gravitetit të Tokës në rastin e vlerës së thellësisë (poshtë). Si rrjedhojë, kuotat janë pozitive mbi sipërfaqen e konsideruar si origjinë, ndërsa thellësitë janë pozitive poshtë saj, siç tregohet në figurën e radhës.



Figura 4 – Matja e vlerës së lartësisë.

Siç konstatohet nga më sipër, lartësitë e tokës dhe batimetria përfshihen në këtë specifikim. Të dy llojet e të dhënave konsiderohen në këtë specifikim si elementet thelbësore të nëntemave të Modelit Dixhital të Terrenit. Më poshtë paraqiten në mënyre skematike konceptet kryesore të kësaj teme.



Figura 5 – Shembull: Përshkrimi i lartësisë së tokës.



Figura 6 - Shembull Përshkrimi i shtratit të detit.



Figura 7 – Shembull: Përshkrimi i bazamentit të një trupit ujore.



Figura 8 – Shembull: Përshkrimi i shtratit të një lumi të lundrueshëm.

MODELET E INTEGRUARA TOKË-DET

Lartësia e tokës dhe të dhënat batimetrike mund të kombinohen në të njëjtin grup të dhënash duke përdorur vlera të ndryshe (kuota ose thellësi), të cilat jepen si referencë shumë shpesh për sisteme të ndryshme koordinatash vertikale). Megjithatë, kur ka të bëjë me raste të caktuara përdorimi dhe aplikimi është e nevojshme dhënia e një sipërfaqeje të vetme të Tokës. Kjo bëhet veçanërisht e rëndësishme në zonat bregdetare, ku pamja e integruar e tokës dhe zonave të zhytura në ujë është shumë e dobishme.

Ky specifikim mbështet përshkrimin e këtij lloj modeli për sa i përket një karakteristike të vetme lartësie (qoftë kuotë ose thellësi), duke iu referuar vetëm një reference vertikale.



Figura 9 – Shembull: Përshkrimi i një modeli të integruar tokë-det.

SIPËRFAQET E TERRENIT

Pavarësisht nëntemave të lartësisë të paraqitura në një grup të dhënash, dy koncepte të formës tredimensionale të sipërfaqes së Tokës janë të mundshme:

- Modeli Dixhital i Terrenit (DTM), i cili përshkruan sipërfaqen e zhveshur të Tokës, duke përjashtuar çdo tipar të vendosur mbi të.
- Modeli Dixhital i Sipërfaqes (DSM), i cili përshkruan sipërfaqen e Tokës duke përfshirë të gjitha tiparet statike të vendosura mbi të (si përjashtimi i një fenomeni të përkohshëm / dinamik).

Shënim: Këtu përdoren konceptet bazë të DTM dhe DSM. Në praktike, të dhënat reale mund të kenë devijime disi nga situata e imagjinuar, për shkak të kufizimeve teknike në procesin e prodhimit. Modeli Dixhital i Lartësisë (DEM) mbulon të dyja konceptet që përmendem më sipër.



Figura 10 – Modelet dixhitale të lartësisë (DEM): Diferenca mes DTM dhe DSM.

3.1.1.1 DIAGRAMI UML

3.1.1.1.1 Lartësitë: Tipi bazë: Numërtimet – Diagrami



Figure 1: Lartësitë - Tipi bazë: Numërtimet

3.1.1.2 KATALOGU I TIPOLOGJISË
3.1.1.2.1 Vlerat e llojit të sipërfaqes

-- Emri --
Vlerat e llojit të sipërfaqe.
-- Përkufizimi --
Lloji i numërtimit që përcakton sipërfaqen e lartësisë që i referohet sipërfaqes së zhveshur të Tokës.
-- Përshkrimi --
SHËNIM 1 - DTM (Modeli dixhital i terrenit) dhe DSM (Modeli dixhital i sipërfaqes).
Tipi i elementit – Numërtim

ATRIBUTET
◆ DTM: **-- Emri --** Modeli dixhital i terrenit **-- Përkufizimi --** Sipërfaqja që përshkruan formën tredimensionale të sipërfaqes së zhveshur të Tokës, duke përjashtuar aq sa është e mundur çdo tipar tjetër të vendosur mbi të. **-- Përshkrimi --** SHEMBULL Ndërtesat, urat ose bimësia nuk formojnë pjesë e një DTM-je. SHËNIM 1 Për sipërfaqet DTM që përshkruajnë shtratin e trupave ujorë (p.sh. shtrati i detit) dhe ato karakteristika të vendosura mbi to, trupat ujorë nuk konsiderohen si pjesë të sipërfaqes së zhveshur të Tokës. Si rrjedhojë, ato përjashtohen nga DTM-ja. SHËNIM 2 Për sipërfaqet DTM ku çdo karakteristikë në sipërfaqen e zhveshur të Tokës nuk është filtruar dhe përjashtuar plotësisht, devijimet duhet të shpjegohen në metadata.
◆ DSM: **-- Emri --** Modeli dixhital i sipërfaqes **-- Përkufizimi --** Modeli që përshkruan formën tredimensionale të sipërfaqes së Tokës, përfshirë të gjitha tiparet statike të vendosura mbi të. **-- Përshkrimi –** Fenomenet e përkohshme nuk formojnë pjesë të sipërfaqes, por për shkak të vështirësive teknike në heqjen e tyre disa prej tipareve mund të jenë të pranishme edhe në sipërfaqe SHEMBULLI 1 - Bimësia, ndërtesat dhe urat janë shembuj të karakteristika statike. SHEMBULLI 2 - Makinat, kamionët dhe karakteristika të tjera dinamike janë shembuj të fenomeneve të përkohshme (përjashtohen). SHËNIM 1 - Për sipërfaqet DSM që përshkruajnë shtratin e trupave ujorë (p.sh. shtrati i detit) dhe ato karakteristika të vendosura mbi to, trupat ujorë nuk konsiderohen si pjesë të sipërfaqes së zhveshur të Tokës. Si rrjedhojë, ato përjashtohen nga DSM-ja. SHËNIM 2 - Për sipërfaqet DSM ku çdo fenomen i përkohshëm nuk është filtruar dhe përjashtuar, devijimet duhet të shpjegohen në metadata.

3.1.1.2.2 VLERAT E LLOJIT TË LARTËSISË SË MATUR

-- Emri --
Vlerat e llojit të lartësisë së matur.
-- Përkufizimi --
Lloji i numërtimit që përcakton karakteristikën e lartësisë, e cila është matur ose llogaritur.
-- Përshkrimi –

SHËNIM 1. Një karakteristikë lartësie është një karakteristikë dimensionale e kushtëzuar vertikalisht e një objekti gjeohapësinor që përbëhet nga një matje me reference absolute në një sipërfaqe e përcaktuar qartë dhe që konsiderohet si origjinë (p.sh. gjeoidi, një nivel mesatar i detit Adriatik, etj.).

SHËNIM 2. Ajo nuk përfshin lartësitë relative të elementit me referencë tek objektet e tjera gjeohapësinore.

SHEMBULL: Kuota (lartësia mbi nivelin e detit), thellësia.
Tipi i elementit - Numërtim

ATRIBUTET
Kuota: **-- Emri --** Kuota (Lartësia mbi nivelin e detit) **-- Përkufizimi --** Vlera e lartësisë së matur përgjatë vijës pingule në drejtim të kundërt me fushën e gravitetit të Tokës (Drejtimi lart). **-- Përshkrimi --** SHËNIM - Ky përkufizim shmang me qëllim referimin në terma kompleksë gjeodezikë. Nevojitet specifikimi i drejtimit në të cilin është matur vlera e lartësisë.
Thellësia: **-- Emri --** Thellësia **-- Përkufizimi --** Vlera e lartësisë së matur përgjatë vijës pingule në drejtimin që përputhet me fushën e gravitetit të Tokës (Drejtimi poshtë). **-- Përshkrimi --** SHËNIM - Ky përkufizim shmang me qëllim referimin në terma kompleksë gjeodezikë. Nevojitet specifikimi i drejtimit në të cilin është matur vlera e lartësisë.

3.1.2 PËRSHKRIMI I NËNTEMËS – RRJETI I MBULIMIT I TË DHËNAVE TË LARTËSIVE
PARAQITJA E MBULIMIT TË TË DHËNAVE TË LARTËSIVE

Të dhënat e lartësisë të paraqitura në një rrjet të rregullt janë lloje të dhënash raster. Kjo është një formë e thjeshtë informacioni gjeografik, e cila konsiston në një grup vlerash që matin një vlerë lartësie, organizuar në një grup të rregullt pikash së bashku me metadatat dhe të gjeoreferencuara.

Mbulimi është një lloj tipologjie (tipari) që përshkruan karakteristikat e fenomeneve të botës reale që ndryshojnë në hapësirë. Ndryshe nga llojet e tjera të tipologjive, atributet e saj jo-gjeohapësinore shoqërohen ngushtësisht me atributet gjeohapësinore (d.m.th. gjeometrinë e tij). Ai vepron si një funksion për t'i kthyer vlerat e atributeve nga rangut të tij për çdo pozicion direkt brenda domain-it të përkohshëm. Meqenëse ai përshkruan fenomene që ndryshojnë vazhdimisht, një rrjet i mbulimit të lartësive në thelb është një mbulim i vazhdueshëm.

Vlerat e atributeve të një rrjeti mbulimi të lartësive janë organizuar duke përdorur gjeometrinë e një rrjeti të rregullt katërkëndëshash në dy dimensione. Një rrjet i rregullt tillë është i përbërë prej dy grupesh me vija paralele të ndara në mënyrë të barabartë që ndërpriten në kënde të drejta. Pikat e ndërprerjes quhen pika të rrjetit të rregullt ose pika model. Zonat e kufizuara nga vijat e rrjetit të rregullt quhen qeliza të rrjetit dhe mbështesin cilësinë e mbulimit përmes interpolimit. Ato nuk janë domosdoshmërisht katrore, por drejtkëndore. Duhet të mbahet parasysh që qelizat e rrjetit të rregullt dhe pikat model janë dy nocione të veçanta.

Një sistem rrjeti i rregullt koordinativ përkufizohet me anë të origjinës dhe boshteve të rrjetit. Koordinatat e rrjetit maten përgjatë boshteve nga origjina.



Figura 14 - Shembull rrjeti të rregullt katërkëndëshash i rektifikuar

Gjithashtu, rrjeti i mbulimit të lartësisë është i gjeorektifikuar në kuptim të SSH EN ISO 19123:2007. Ai lidhet me Tokën nëpërmjet një lidhje afine, që krijon një transformim të thjeshtë mes rrjetit të rregullt të koordinatave dhe koordinatave në sistemin e shoqëruar të referimit bazuar në Tokë. Parametrat e transformimit përcaktohen nga vendndodhja e origjinës së rrjetit të rregullt, orientimi i boshteve dhe hapësirës së rrjetit në secilin drejtim brenda sistemit të jashtëm të referimit të koordinatave.

KONCEPTI I PRERJES ME KUADRATE

Motivime të ndryshme mund t'i bindin prodhuesit e të dhënave t'i ndajnë të dhënat e rrjetit të lartësisë në pjesë më të vogla. Zakonisht ky proces njihet si "prerje me kuadrate (Tiling)", i cili përdoret edhe në ortoimazheri. Megjithatë, ky term mund të përfshijë kuptime të ndryshme në varësi të nivelit të paraqitjes së përshkrimit. Duhen dalluar tri nivele kryesore:

Së pari, prerja me kuadrate mund të implementohet nga brenda në formate skedarësh (p.sh. formati tiff kudrator). Duke organizuar sërish përmbajtjen e lartësisë në kuadrate thuajse katrore në vend të shiritave horizontalisht të gjerë, kjo metodë përmirëson performancën për aksesimin dhe përpunimin e rrjeteve të rregullt DEM me rezolucion të lartë. Meqenëse kjo metodë reflekton strukturën e ruajtjes së të dhënave, nuk shfaqet në skemën e aplikimit që kushtëzohet nga niveli konceptual.

Së dyti, rrjetet e rregullt DEM me rezolucion të lartë që mbulojnë territore të gjera përfaqësojnë volume të mëdha të dhënash, që shpesh nuk mund të ruhen në mënyrë të arsyeshme në një skedar të vetëm DEM-i. Zakonisht prodhuesit e të dhënave i ndajnë ato në skedarë të veçantë individualë për të lehtësuar ruajtjen e tyre, shpërndarjen dhe përdorimin. Skema më e zakonshme e prerjes me kuadrate që përdoret në lartësi për këtë qëllim është një rrjet i thjeshtë drejtkëndor ku kuadratet përputhen nga skajet pa mbivendosje të imazheve apo hapësirave (figura 15 a). Megjithatë, ndonjëherë kërkohet që kuadratet individuale të mbivendosen me ato ngjitur për të garantuar një vazhdimësi të caktuar gjeohapësinore gjatë trajtimit të tyre (figura 15 b). Skema e prerjes me kuadrate mund të ketë edhe një gjeometri më pak të rregullt me një densitet të ndryshueshëm të kuadrateve (figura 15 c).



Figura 15 - Konfigurimet e ndryshme të skemës së prerjes me kuadrate

Së treti, DEM të mëdha të rrjetit të koordinatave mund të ndahen edhe në nëngrupe që kanë kuptim edhe në vetvete, sepse përshkruajnë struktura logjike (p.sh. fletët e hartave, njësisë administrative si qarqet ose rrethet etj.). Ndryshe nga rasti i mëparshëm, ky lloj i prerjes me kuadrate duke u bazuar në skedar është plotësisht brenda shtrirjes së modelit konceptual.

Prerja me kuadrate mund të ofrojë mundësi të tjera dhe duhet të rrisë harmonizimin e të dhënave: në të vërtetë prerja me kuadrate mund të shikohet edhe si një proces shtimi në vend të një procesi prerje. Pra, mund të shtohet një koleksion i rrjetit të mbulimit të lartësive për të formuar një mbulim të vetëm më të madh. Kjo gjë ka avantazhet e mëposhtme:

- Mbulimet e lartësive të dhëna mund të kontribuojnë pjesërisht për mbulimin e shtuar.
- Rrjedhimisht, mbulimet e lartësive të dhëna mund të mbivendosen në hapësirë kur është e nevojshme.

Ky mekanizëm quhet "Rrjeti i mbulimit shtesë i të dhënave të lartësive" dhe përshkruhet më hollësisht më poshtë në këtë dokument.

STRUKTURA E TË DHËNAVE

Përmes konceptit të mbulimit jepet niveli i parë i strukturës së të dhënave. Për më tepër skema e aplikimit të Rrjetit të mbulimit të të dhënave të lartësive ofron një nivel të dytë që përbëhet nga grupe mbulimesh në një strukturë tjetër logjike. Me fjalë të tjera, nëngrupet nga rrjeti i mbulimit të të dhënave të lartësive homogjene mund të kombinohen që të ndërtojnë një mbulim të ri të lartësive. Mbulimi shtesë nuk i mban direkt vlerat e veta të qelizave të rrjetit të rregullt. Kjo i referohet mbulimeve të dhëna, duke shmangur duplikimin e të dhënave. Gama e caktuar e mbulimit llogaritet nga një shërbim ose aplikacion kur kërkohet nga përdoruesit.

Për zbatueshmëri, mbulimet e dhëna dhe të shtuara të rrjetit të mbulimit të lartësive do të jenë pjesë e të njëjtit grup të dhënash të lartësive.



Figura 16 - Parimi i rrjetit të mbulimit shtesë të të dhënave të lartësive

Siç shihet në figurën 16, mbulesat e mbivendosura të lartësisë A, B dhe C përbëjnë mbulimin shtesë të lartësisë D, kutia kufizuese e së cilës është e pikëzuar.

Ky mekanizëm është plotësisht i përsëritur në mënyrë që mbulimi i lartësisë mund të jetë një përbërje e mbulimeve tashmë të shtuara të lartësisë.

3.1.2.1 DIAGRAMI UML

3.1.2.1.1 RRJETI I MBULIMIT I TË DHËNAVE TË LARTËSIVE: TË PËRGJITHSHME - DIAGRAMI



Figure 2: Rrjeti i mbulimit të lartësive: Të përgjithshme

3.1.2.1.2 RRJETI I MBULIMIT I TË DHËNAVE TË LARTËSIVE: NUMËRTIMET DHE KODLISTAT - DIAGRAMI



Figure 3: Rrjeti i mbulimit të të dhënave të lartësive: Numërtimet dhe Kodlistat

3.1.2.1.3 RRJETI I MBULIMIT I TË DHËNAVE TË LARTËSIVE: DIAGRAMI



Figure 4: Rrjeti i mbulimit i të dhënave të lartësive.

3.1.2.1.4 RRJETI I MBULIMIT I TË DHËNAVE TË LARTËSIVE: KLASAT E JASHTME DIAGRAMI



Figure 5: Rrjeti i mbulimit i të dhënave të lartësive: Klasat e jashtme

3.1.2.2. KATALOGU I TIPOLOGJISË
3.1.2.2.1 RRJETI I MBULIMIT I TË DHËNAVE TË LARTËSIVE

-- Emri --
Rrjeti i mbulimit i të dhënave të lartësive

-- Përkufizimi --
Mbulim i vazhdueshëm që përdor një mozaik sistematik bazuar në një rrjet të rregullt të rektifikuar katërkëndëshash për të mbuluar domenin e tij, ku vlera e karakteristikës së lartësisë zakonisht njihet për secilën prej pikave të rrjetit që formojnë këtë domein.

-- Përshkrimi --
Burimi është adaptuar nga [ISO 19123:2005].

Tipi i elementit – Feature Type

KUFIZIMET

OCL. Vlerat e Gamës së të Dhënave janë Lloji Float

/* Vlerat e kësaj game të dhënash do të përshkruhen nga lloji i vlerës "Float" */

OCL. Shtrirja e Domainit Përmban Element Gjeografik

/* Shtrirja e Domainit do të popullohet të paktën me një nënlloj të EX_ShtrirjeGjeografike. */

OCL. Shmangie Identike Vektoriale në Mbulimin Shtesë të Lartësive

/*Të gjithë shembujt e Rrjeti i Mbulimit i të Dhënave të Lartësive tek i cili referohet një shembull i Rrjeti I Mbulimit Shtesë i të Dhënave të Lartësive, do të ndajnë të njëjtin orientim të boshteve të rrjetit dhe të njëjtën hapësirë boshtesh në çdo drejtim*/

OCL. Origjina e Dimensioneve 2

/* Origjina e rrjetit të koordinatave do të përshkruhet në dy dimensione */

OCL. Kërkesat E DomainitCRS

/* Sistemi koordinativ referencë që përdoret për të referuar rrjetin duhet të parapërcaktohet*/

OCL. Dimensioni i Domainit 2

/* Dimensioni i rrjetit të koordinatave do të jetë gjithmonë 2 për një mbulim të rrjetit të lartësisë */

LIDHJE STRUKTURORE TË JASHTME

Gjeneralizim nga «featureType» Rrjeti I Mbulimit I Të Dhënave Të Lartësive te «featureType» Rrjeti Koordinativ i Rektifikuar (Transformuar)

[Drejtimi: 'Burim -> Destinacion'.]

ATRIBUTET

Fillimi i Ciklit Jetësor: Datë-Orë
Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --
Fillimi i ciklit jetësor

-- Përkufizimi --
Data në të cilën ky version i objektit gjeohapësinor është krijuar ose ndryshuar në të dhënat gjeohapësinore.

[I detyrueshëm: PO]

Inspire Id: Identifikues
Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --
Inspire Id

-- Përkufizimi --
Identifikues i jashtëm i objektit hapësinor.

ATRIBUTET

-- Përshkrimi --
Një objekt identifikues i jashtëm është një identifikues unik i objektit të publikuar nga organi përgjegjës, që mund të përdoret nga aplikacionet e jashtme të referimit të objektit hapësinor. Identifikuesi është identifikues i objektit hapësinor, jo identifikues i dukurisë në botë.

[I detyrueshëm: PO]

- Lloji i Matjes: Vlerat e Llojit të Lartësisë së Matur
  Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --
Lloji i matjes

-- Përkufizimi --
Atribut që përcakton llojin e lartësisë që përfaqësohet nga rrjeti i mbulimit të lartësive.

-- Përkufizimi --
Shembull - Kuota, thellësia.

[I detyrueshëm: PO]

- Lloji i Sipërfaqes: Vlerat e Llojit të Sipërfaqes
  Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --
Lloji i sipërfaqes

-- Përkufizimi --
Atribut që tregon llojin e sipërfaqes së lartësisë që mbulimi përshkruan në lidhje me sipërfaqen e zhveshur të Tokës

[I detyrueshëm: PO]

- Përfundimi I Ciklit Jetësor: Datë-Orë
  Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --
Përfundimi i ciklit jetësor

-- Përkufizimi --
Data në të cilën ky version i objektit gjeohapësinor është përfunduar.

[I detyrueshëm: JO]

- Shtrirja e Domeinit: EX_Shtrirje
  Shumëllojshmëria: [1..*]

-- Emri --
Shtrirja e domeinit

-- Përkufizimi --
Shtrirja e domenit të përkohshëm gjeohapësinor të mbulimit.

-- Përshkrimi -
BURIMI [ISO 19123:2005].
SHËNIM 1 - Lloji i të dhënave EX_Shtrirje, përkufizohet në ISO 19103. Shtrirjet mund të specifikohen në hapësirë dhe në kohë.

[I detyrueshëm: JO]

LIDHJET
Klasa E Lidhjeve (Drejtimi: Destinacion -> Burim) **-- Emri --** Mbulimi shtesë i lartësive. **-- Përkufizimi --** Referenca e mbulimit të lartësive që përbëhet nga një mbulim shtesë. Burimi: Rrjeti i Mbulimit Shtesë i të Dhënave të Lartësive Rrjeti i Mbulimit i të Dhënave të Lartësive «featureType» Shumëllojshmëria: [0..*] Destinacioni: Rrjeti i Mbulimit i të Dhënave të Lartësive «featureType» Shumëllojshmëria: [0..*] **-- Emri --** Rrjeti i mbulimit të lartësive shtesë **-- Përkufizimi –** Referenca e rrjetit mbulimit të lartësive që përbëhet nga një rrjet mbulim shtesë. Lidhja ka karakteristika shtesë të cilat janë të përcaktuara në klasën e lidhje së Rrjetin e Mbulimit Shtesë të Lartësive.
Klasa E Lidhjes (Drejtimi: Destinacion -> Burim) -- Emri -- Mbulimi shtesë i lartësive. -- Përkufizimi -- Referenca e mbulimit të lartësive që përbëhet nga një mbulim shtesë. Burimi: Rrjeti i Mbulimit Shtesë i të Dhënave të Lartësive Rrjeti i Mbulimit i të Dhënave të Lartësive «featureType» Shumëllojshmëria: [0..*] Destinacioni: Rrjeti i Mbulimit i të Dhënave të Lartësive «featureType» Shumëllojshmëria: [0..*] **-- Emri --** Rrjeti i mbulimit të lartësive shtesë **-- Përkufizimi --** Referenca e rrjetit mbulimit të lartësive që përbëhet nga një rrjet mbulim shtesë. Lidhja ka karakteristika shtesë të cilat janë të përcaktuara në klasën e lidhje së Rrjetin e Mbulimit Shtesë të Lartësive.

3.1.2.2.2.RRJETI I MBULIMIT SHTESË I TË DHËNAVE TË LARTËSIVE

-- Emri --
Rrjeti i mbulimit shtesë i të dhënave të lartësive.

-- Përkufizimi --
Karakteristikat gjeometrike të shtesës së rrjetit të mbulimit të lartësisë.

Tipi i elementit - DataType

ATRIBUTET
Gjurma E Mbulimit Përbërës: GM_MultiSipërfaqe Shumëllojshmëria: [1] **-- Emri --** Gjurma e mbulimit përbërës **-- Përkufizimi --** Shumëkëndësh (poligon) që përshkruan zonën gjeografike të mbulimit të rrjetit të lartësisë që kontribon në mbulimin e shtesë të këtij rrjeti. [I detyrueshëm: PO]

3.1.3 PËRSHKRIMI I NËNTEMËS - ELEMENTET VEKTOR TË LARTËSIVE

Skema e aplikimit **Elementet Vektor të Lartësive** është e përqendruar në kategorinë e saj abstrakte, e cila vendos vlera të përbashkëta që ndahen nga të gjitha llojet e objekteve gjeohapësinore vektoriale që përkufizohen në këtë specifikim, si:

- **Lloji i Vlerave të Matura**, për identifikimin e llojit të vlerës së matur të lartësisë që përshkruan objekti i lartësisë (kuotë ose thellësi).

- Atributet **Fillimi Ciklit Jetës** dhe **Mbarimi Ciklit Jetës**, që kontrollojnë përfaqësimin e përkohshëm.

- **Datumi Lokal i Thellësive**, për përshkrimin e datumit lokal për referimin e thellësive të këtyre objekteve. Ky atribut zbatohet vetëm për objektet batimetrike.

SHËNIM: Të dhënat e lartësisë së tokës (kuotat) dhe të dhënat batimetrike (thellësitë) mund të kombinohen me të njëjtin grup të dhënash vektoriale referuar në CRS të ndryshme vertikale. Ky opsion nuk është i mundur kur dërgohen të dhëna të lartësisë në rrjetin e koordinatave ose te lloji i paraqitjes gjeohapësinor TIN, meqenëse si mbulimi i rrjetit ashtu edhe grupet e të dhënave TIN do t'i referohen vetëm një sistemi vertikal referues koordinativ.

- Objekti Vektor i Lartësisë është i kufizuar edhe më tej në disa lloje objektesh gjeohapësinore jo-abstrakte, ku secili ka role të ndryshme, kuptime shtesë dhe atribute tematike specifike.

Tipologjita e objekteve vektoriale përbëhet nga lartësitë e pikave (kuotat dhe thellësitë e pikave), izoipset dhe konturet e thellësisë, vijat e thyerjes që përshkruajnë morfologjinë e terrenit si dhe objekte të tjera (zona pa informacion, zona e kufizuara), që mund të ndihmojnë në llogaritjen e Modelit Digjital të Lartësisë nga të dhënat vektoriale.

3.1.3.1 DIAGRAMI UML

3.1.3.1.1 ELEMENTET VEKTOR TË LARTËSIVE - TË PËRGJITHSHME - DIAGRAMI



Figurë 6: Elementet vektor të lartësive - Të përgjithshme

3.1.3.1.2 ELEMENTET VEKTOR TË LARTËSIVE - DIAGRAMI



Figurë 7: Elementet vektor të lartësive

3.1.3.1.3 ELEMENTET VEKTOR TË LARTËSIVE: NUMËRTIMET DHE KODLISTAT - DIAGRAMI



Figurë 8: Elementet vektor të lartësive: numërtimet dhe kodlistat

3.1.3.2 KATALOGU I TIPOLOGJISË

3.1.3.2.1 DATUMI I PROJEKTUAR

-- Emri --

Datumi i projektuar

-- Përkufizimi --

sistemi koordinativ referencë vertikal lokal që përdoret për të referuar dhe paraqitur vlerat e matjeve të thellësive.

-- Përshkrimi--

SHËNIM - Ky lloj të dhënash synon të përshkruajë karakteristikat kryesore të një CRS-e vertikale për matjen e thellësive në raste ku ky informacion disponohet rrallë ose nuk disponohet përmes një regjistri CRS-e (p.sh. si EPSG)

SHEMBULL - Datumet lokale për referimin e thellësive në liqene dhe lumenj të lundrueshëm.
Tipi i elementit – Data Type

ATRIBUTET
Datumi I Nivelit Të Ujit: Vlerat E Nivelit Të Ujit Shumëllojshmëria: [0..1], **-- Emri --** Datumi i nivelit të ujit **-- Përkufizimi --** Niveli i ujit që përcakton origjinën e matjeve të thellësisë për datumin e projektuar. SHEMBULL Niveli më i lartë i ujit, niveli më i ulët i ujit, etj. SHËNIM 1 - Vlerat e kësaj liste mund të jenë të aplikueshme për ujërat tokësor ose detet. SHËNIM 2 - Kur realizohet përcaktimi i datumit për thellësitë në ujërat e brendshme tokësore rekomandohet të përdoret "Ujërat e Larta", "Ujërat e Ulëta" ose "Niveli Mesatar i Ujit" [I detyrueshëm: PO]
Pika Reference: GM_Pikë Shumëllojshmëria: [1..*], **-- Emri --** Pika referencë **-- Përkufizimi --** Pozicionimi gjeografik i: Rasti A: Një pike të vetme e cila është përdorur për të referuar vlerat e thellësive. Rasti B: Grup pikash ku matjet e nivelit të ujit përdoren për të definuar nivelin e ujit të datumit të projektuar. **-- Përkufizimi --** SHËNIM 1: Pozicioni naltimetrik i secilës prej pikave referencë duhet të jetë në të njëjtin CRS-vertikal sipas legjislacioneve në fuqi. SHËNIM 2: Pozicioni naltimetrik i pikës referencë mund të përdoret direkt si input për të llogaritur lartësitë e përafërta për objektet vektor për të cilat thellësitë janë referuar datumit të projektuar. SHËNIM 3: Pozicioni naltimetrik i pikës referencë mund të përdoret direkt si input për të llogaritur lartësitë e përafërta për objektet vektor për të cilat thellësitë janë referuar datumit të projektuar. [I detyrueshëm: PO]
Qëllimi: EX_Shtrije Shumëllojshmëria: [1] **-- Emri --** Qëllimi **-- Përkufizimi --** Qëllimi gjeografik në të cilin datumi lokal i thellësive është përdorur. **-- Përshkrimi --** SHËNIM - Datumi i projektuar duhet të përdoret vetëm për të referuar dhe për të përshkruar thellësitë në nivel lokal (relativ).

ATRIBUTET

SHEMBULLI 1 Liqeni ose pjesa e një liqeni në të cilin përdoret një nivel specifik i ujit si matje thellësie.
SHEMBULLI 2 Seksioni i lumit në të cilin përdoret një nivel specifik i ujit si matje e thellësisë.
SHEMBULLI 3 Shtrirja e zonës së detit në të cilën një nivel specifik i batice është përdorur si një datum thellësie.
[I detyrueshëm: PO]

Shmangia: Matje
Shumëllojshmëria: [0..*],

-- Emri --
Shmangie

-- Përkufizimi --
Distanca relative ndërmjet kuotës së pikave referencë të tokës dhe kuotës së nivelit të ujërave që përcaktojnë datumin e projektuar.

-- Përsjkrimi --
SHËNIM 1- Në mënyrë që të llogaritet parametri i shmangies, lastësitë e pikave referuar nivelit të ujit të datumit të projektuar duhet të jenë në të njëjtën CRS-vertikale.

SHËNIM 2- Në momentin që kemi vetëm një pikë reference, parametri i shmangies supozohet të jetë zero (vlera shabllon). Nëse ky kusht vazhdon atëherë nuk është e nevojshme të vendoset një vlerë shmangie.

SHËNIM 3- Në momentin që kemi një grup pikash, duhet të llogaritet një parametër për secilën prej këtyre pikave.

[I detyrueshëm: JO]

3.1.3.2.2 IZOIPSE

-- Emri --
Izoipse

-- Përkufizimi --
Objekti gjeohapësinor linear i përbërë prej një grupi pikash karakterizuar nga e njëjta vlerë e të matura e lartësisë. Së bashku me izohipse të tjera të pranishme në zonë, ai përshkruan morfologjinë vendase të sipërfaqes së Tokës.

-- Përshkrimi--
SHËNIM 1 - Atributi Lloji i Matjeve është i barabartë me "Kuotën" në rastin e izohipseve dhe me "hellësinë" në rastin e izobateve.
Tipi i elementit - FeatureType

KUFIZIMET

OCL. Dimensionimi i Vlerës së Matur Është1

/*Dimensionimi i vlerës së matur të koordinatës duhet të jetë 1*/

OCL. Vlera E Matur I Referohet CRSVertikal

/*Vlera e matur e izoipsit duhet të shprehet referuar Sistemit Koordinativ Referencë (CRS) Verttikale */

LIDHJE STRUKTURORE TË JASHTME

⇦ Gjeneralizim nga «featureType» Izoipse te «featureType» Objektet Vektor Të Lartësive
[Drejtimi: 'Burimi -> Destinacion'.]

ATRIBUTET

Gjeometria: GM_Curve
Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --
Gjeometria

-- Përkufizimi --
Përfaqëson karakteristikat gjeometrike të objektit gjeohapësinor.
[I detyrueshëm: PO]

Lloji i Izoipseve: Vlerat e Llojit të Izoipseve
Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --
Lloji i izoipseve

-- Përkufizimi --
Lloji i izoipsit lidhur me intervalin normal të izoipseve (nëse ka).

-- Përshkrimi --
SHËNIM - Shpesh ky atribut aplikohet për izoipset që përshkruajnë relievin e një zone me bazë tokën. Për izohipset e thellësisë që përshkruajnë tabanin e një trupi ujor nuk aplikohet gjithmonë.

[I detyrueshëm: PO

Poshtë Djathtas: Boolean
Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --
Izoipse

-- Përkufizimi --
Karakteristikë që tregon se objekti gjeohapësinor i izoipsit është i digjitalizuar në një mënyrë që gjatësia e sipërfaqes së lartësisë është më e ulët në krahun e djathtë të vijës.

SHËNIM 1 Në rastin e izohipseve, kur atributi PoshtëDjathtas është 'i vërtetë' kjo tregon se gjatësia e sipërfaqes është më e ulët në krahun e djathtë të vijës.

SHËNIM 2 Në rastin e izohipseve të thellësisë, kur atributi PoshtëDjathtas është 'i vërtetë' kjo tregon se thellësia e sipërfaqes është më e ulët në krahun e djathtë të vijës.
[I detyrueshëm: JO]

Vlera E Matjes: Pozicionimi Direkt
Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --
Vlera e matjes.

-- Përkufizimi --
Vlera e matjes së lartësisë së objektit gjeohapësinor referuar një sistemi referencë specifik të koordinatave vertikale
[I detyrueshëm: PO]

3.1.3.2.3 LARTËSIA E PIKËS

-- Emri --
Lartësia e pikës

-- Përkufizimi --
Objekt gjeohapësinor (një pike) që përshkruan lartësinë e sipërfaqes së Tokës për një pozicion të caktuar. Ai jep të dhëna për një vlerë të vetme të lartësisë.

-- Përshkrimi --
SHËNIM 1 Ai shpesh përfaqëson një pikë në morfologjinë e tokës ose në sipërfaqen e tabanit të trupit ujor.

SHËNIM 2 Atributi Lloji i Matjes është i barabartë me "Kuotën" në rastin e lartësisë së pikës. Ai është i barabartë me "thellësinë" në rastin e thellësive të pikës.
Tipi i elementit - FeatureType

KUFIZIMET
OCL. Dimensionimi i vlerës së matur është 1 /*Dimensionimi i vlerës së matur të koordinatës duhet të jetë 1*/
OCL. VleraEMaturIReferohetCRSVertikal /*Vlera e matur e kuotës së pikës duhet të shprehet referuar Sistemit Koordinativ Referencë (CRS) Verttikale */

LIDHJE STRUKTURORE TË JASHTME
Gjeneralizim nga «featureType» Lartësia e Pikës te «featureType» Objektet Vektor të Lartësive [Drejtimi: 'Burimi -> Destinacion'.]

ATRIBUTET
Emërtimi Gjeografik: Emërtimet Gjeografike Shumëllojshmëria: [0..*] **-- Emri --** Emërtimi gjeografik **-- Përkufizimi --** Një emërtim gjeografik që përdoret për të identifikuar një vend të emërtuar ose vendndodhjen e tabanit të trupit ujor në botën reale, që përfaqësohet nga objekti gjeohapësinor me lartësinë së pikës. [I detyrueshëm: PO]
Gjeometria: GM_Pikë Shumëllojshmëria: [1] **-- Emri --** Gjeometria **-- Përkufizimi --** Përfaqëson karakteristikat gjeometrike të objektit gjeohapësinor. [I detyrueshëm: PO]

ATRIBUTET
Klasifikimi: Vlerat E Klasifikimit Të Lartësisë Së Pikës Shumëllojshmëria: [1] **-- Emri --** Klasifikimi **-- Përkufizimi --** Kategoria e lartësisë së pikës në përputhje me specifikimin LAS të Shoqatës Amerikane për Fotogrametrinë dhe Zbulimin në Distancë (ASPRS). [I detyrueshëm: JO]
Lloji I Lartësisë Së Pikës: Vlerat E Llojeve Të Lartësisë Së Pikës Shumëllojshmëria: [1] **-- Emri --** Lloji i lartësisë së pikës **-- Përkufizimi --** Lloji i lartësisë së pikës. [I detyrueshëm: PO]
Vlera E Matjes: Pozicionimi Direkt Shumëllojshmëria: [1] **-- Emri --** Vlera e matjes. **-- Përkufizimi --** Vlera e matjes së lartësisë së objektit gjeohapësinor referuar një sistemi referencë specifik të koordinatave vertikale [I detyrueshëm: PO]

3.1.3.2.4 OBJEKTET VEKTOR TË LARTËSIVE

-- Emri --
Objektet vektor të lartësive

-- Përkufizimi --
Objekt gjeohapësinor i cili është pjesë të një grupi të dhënash vektoriale dhe merr pjesë në përshkrimin e karakteristikës së lartësisë të një sipërfaqeje të botës reale. Ai përbëhet nga një bazë identiteti për të gjitha objektet vektoriale që mund të përfshihen si pjesë e një grupi të dhënash të lartësisë.

-- Përshkrimi --
Është një tipologji abstrakte që përshkruan çdo lloj të mundshëm të objektit vektorial të lartësisë. Ajo përshkruan atribute të zakonshme, karakteristika dhe kufizime për objekte të tilla gjeohapësinore.
Tipi i elementit - FeatureType

INCOMING STRUCTURAL RELATIONSHIPS

Generalization from «featureType» Izoipse te «feature Type» Objektet Vektor Të Lartësive
[Drejtimi: 'Burimi -> Destinacion'.]

Generalization from «featureType» LartësiaEPikës te «featureType» Objektet Vektor Të Lartësive
[Drejtimi: 'Burimi -> Destinacion'.]

Generalization from «featureType» VijatEThyerjes te «featureType» ObjektetVektor Të Lartësive
[Drejtimi: 'Burimi -> Destinacion'.]

Generalization from «featureType» ZonatEKufizuara te «feature Type» Objektet Vektor Të Lartësive [Drejtimi: 'Burimi -> Destinacion'.]

Generalization from «featureType» ZonaPaInformacion te «featureType» Objektet Vektor Të Lartësive [Drejtimi: 'Burimi -> Destinacion'.]

ATRIBUTET

Datumi Lokal Për Thellësitë: Datumi i Projektuar
Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --
Datumi lokal për thellësinë

-- Përkufizimi --
Identifikimi i një sistemi koordinatav referencë vertikale lokale pa përfshirje në një regjistër, i cili përdoret si referencë për matje të thellësive.

-- Përshkrimi--
SHËNIM - Këto lloj të dhënash zbatohen vetëm ndaj objekteve vektoriale batimetrike.

SHEMBULL - Datumet lokale për referimin e thellësive në liqene dhe lumenj të lundrueshëm

[I detyrueshëm: PO]

Fillimi i Ciklit Jetësor: Datë-Orë
Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --
Fillimi i ciklit jetësor

-- Përkufizimi --
Data në të cilën ky version i objektit gjeohapësinor është krijuar ose ndryshuar në të dhënat gjeohapësinore

[I detyrueshëm: PO]

Lloji I Matjes: Vlerat E Llojit Të Lartësisë Së Matur
Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --
Lloji i matjes

-- Përkufizimi --
Atribut që kategorizon elementet vektoriale të lartësisë si një lartësi tokësore ose një objekt gjeohapësinor batimetrik. Përcakton vlerën e lartësisë të objekti.

ATRIBUTET
-- Përshkrimi-- SHEMBULL Kuota, thellësia. [I detyrueshëm: PO]
Përfundimi i Ciklit Jetësor: Datë-Orë Shumëllojshmëria: [1] **-- Emri --** Përfundimi i ciklit jetësor **-- Përkufizimi --** Data në të cilën ky version i objektit gjeohapësinor është përfunduar. [I detyrueshëm: JO]

3.1.3.2.5 VIJAT E THYERJES

-- Emri --
Vijat e thyerjes

-- Përkufizimi --
Një vijë e një natyre kritike, që përshkruan formën e sipërfaqes së terrenit dhe tregon mungesë vazhdimësie në pjerrësinë e sipërfaqes (d.m.th. një ndryshim i papritur në gradient). Trekëndëshat e përfshirë në një model TIN kurrë nuk duhet ta kapërcejnë atë.

-- Përkufizimi --
BURIMI - Përshtatur nga [*SSH EN ISO 19123:2007*].

SHEMBULL - Vijat e thyerjes përfaqësojnë kurrizet lokale ose luginat (rrymat ose vijat e kullimit) në sipërfaqe, struktura të krijuara nga njeriu (p.sh. rrugët) etj.

SHËNIM 1 Një vijë thyerjeje lidh pikët me lartësi të ndryshme dhe prandaj rekomandohet plotësisht përshkrimi i saj duke përdorur koordinatat 2.5-D (duke përdorur atributin 'gjeometri').

SHËNIM 2 Asnjë trekëndësh në një TIN nuk mund të kryqëzohet me një vijë thyerjeje (me fjalë të tjera, segmentet e vijave të thyerjes zbatohen si buzë trekëndëshi), edhe pse me këtë shkelet kriteri i rrjetit të trekëndëshave

SHËNIM 3 Të gjitha vijat e thyerjes gjenden në sipërfaqen e tokës ose në çdonjërën prej strukturave artificiale të ndërtuara në të.
Tipi i elementit - FeatureType

LIDHJE STRUKTURORE TË JASHTME

⇐ Gjeneralizim nga «feature Type» Vijat E Thyerjes te «feature Type» Objektet Vektor Të Lartësive
[Drejtimi: 'Burimi -> Destinacion'.]

ATRIBUTET

Gjeometria: GM_Linjë
Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --
Gjeometria

-- Përkufizimi --
Përfaqëson karakteristikat gjeometrike të objektit gjeohapësinor.
[I detyrueshëm: PO]

Lloji i Vijave të Thyrjes: Vlerat e Llojeve të Vijave të Thyerjes
Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --
Lloji i vijave të thyerjes

-- Përkufizimi --
Lloji i vijës së thyerjes lidhur me karakteristikat natyrale ose artificiale që përfaqëson, ose funksioni specifik që ka në llogaritjen e Modelit Digjital i të Lartësive (DEM).
[I detyrueshëm: PO]

ThyrjeArtificiale: Boolean
Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --
Thyerje artificiale

-- Përkufizimi --
Vija që përfaqëson një thyerje të lartësisë për shkak të një realizimi nga dora e njeriut ose artificiale
[I detyrueshëm: PO]

3.1.3.2.6 VLERAT E KLASIFIKIMIT TË LARTËSISË SË PIKËS

-- Emri --
Vlerat e klasifikimit të lartësisë së pikës.

-- Përkufizimi --
Klasifikim për vlerat e mundshme të lartësive të pikës bazuar në specifikimet LAS të mirëmbajtura nga Shoqëria Amerikane e Fotogrametrisë dhe Remote sensing "American Society for Photogrammetry and Remote Sensing (ASPRS)"
Tipi i elementit - Kodlistë

3.1.3.2.7 VLERAT E LLOJEVE TË LARTËSISË SË PIKËS
-- Emri --
Vlerat e llojeve të lartësisë së pikës

-- Përkufizimi --
Vlerat e mundshme për llojet e lartësive të pikave që përshkruajnë veçoritë e sipërfaqes.

Tipi i elementit - Kodlistë

ATRIBUTET
E përgjithshme **-- Përkufizimi --** Objekti gjeohapësinor i lartësisë së pikës që nuk përmbush përshkrimin e çdonjërës prej vlerave të tjera në kodlistën aktuale.
Gropa **-- Përkufizimi --** Pika që përfaqëson një pjesë të zbutjes së sipërfaqes së tokës ose sipërfaqes së fundit të trupit ujor, i cili është më i ulët në lartësi kur krahasohet me pikat rrethuese. **-- Përkufizimi --** Shembull: Gropë ose gji.
Kalim/Qafë **-- Përkufizimi --** Pika e poshtme e gropores brenda një rreshtimi të kurrizeve, përgjithësisht të hapura përgjatë vijës së kreshtës, e cila lejon kalimin nga njëra pjerrësi e sipërfaqes në tjetrën
Maja **-- Përkufizimi --** Pika më e lartë e një ngritjeje në sipërfaqen së tokës ose të fundit të një trupi ujor.

3.1.3.2.8 VLERAT E LLOJEVE TË VIJAVE TË THYERJES

-- Emri --

Vlerat e llojeve të vijave të thyerjeve

-- Përkufizimi --

Listë e mundshme me llojet e vijave të thyerjeve të terrenit bazuar në karakteristikat fizike të tyre.

Tipi i elementit - Kodlistë

ATRIBUTET
Kufiri I Zone E Sheshtë **-- Përkufizimi --** Vijë thyerje që kufizon një pjesë të izoluar të territorit aty ku modeli i lartësisë duhet të ndrydhet tek e njëjta vlerë lartësie. **-- Përkufizimi --** Shënim: Kufiri i zonës së sheshtë duhet të jetë i mbyllur. Shembull: Kufiri i një trupi ujor në brendësi të tokës (p.sh. liqeni)
Ndryshim Pjerrësie **-- Përkufizimi --** Vijë thyerje që përfaqëson një koleksion pikash të ngjitur aty ku terreni ka një ndryshim të papritur në pjerrësi.
Pjesa e Poshtme e Skarpate **-- Përkufizimi --** Vija e thyerjes që përfaqëson kufirin e poshtëm të një zone që ka një pjerrësi konstante në sipërfaqen e terrenit, me një ndryshim të përafërt mes 2% dhe 40%.
Pjesa e Sipërme e Skarpate **-- Përkufizimi --** Vija e thyerjes që përfaqëson kufirin e epërm të një zone që ka një pjerrësi konstante në sipërfaqen e terrenit, me një ndryshim të përafërt pjerrësie mes 2% dhe 40%.

ATRIBUTET

Vijë Formuese

-- Përkufizimi --
Vijë thyerje që përfaqëson një drejtim lokal në të cilën sipërfaqja e lartësisë që përshkruhet merr pjerrësinë më të madhe.

-- Përshkrimi --
Shënim 1: Vijat e formimit janë gjithmonë pingule me izoipset që përshkruajnë të njëjtën sipërfaqe të lartësisë.
Shënim 2: Ky rast i veçantë i vijës së thyerjes përdoret shpesh për të përshkruar gropa dhe kurrize të sipërfaqet e terrenit.

3.1.3.2.9 ZONA PA INFORMACION

-- Emri --
Zona pa informacion

-- Përkufizimi --
Zona në sipërfaqen e tokës ku modeli dixhital i lartësive është i panjohur për arsye të mungesës së të dhënave. Kjo sipërfaqe duhet të hiqet nga DEM.

-- Përkufizimi --
SHËNIM - Një Zonë Pa Informacion mund të përmbaje një numër të madh të Zonave Të Kufizuara më të dhëna për lartësitë.
Zonat pa informacion mund të jenë të dobishme për të llogaritur një DEM të përshtatshëm dhe më të saktë.
Tipi i elementit - FeatureType

LIDHJE STRUKTURORE TË JASHTME

Gjeneralizim nga «featureType» ZonaPaInformacion te «featureType» ObjektetVektor Të Lartësive
[Drejtimi: 'Burimi -> Destinacion'.]

ATRIBUTET

Gjeometria: GM_Sipërfaqe
Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --
Gjeometria

-- Përkufizimi --
Përfaqëson karakteristikat gjeometrike të objektit gjeohapësinor.
[I detyrueshëm: PO]

3.1.3.2.10 ZONAT E KUFIZUARA

-- Emri --
Zonat e kufizuara

-- Përkufizimi --
Caktimi i kufijve të një zone të sipërfaqes së tokës ku ekziston një pjesë e izoluar e modelit të lartësisë. Elementet rrethues të saj nuk kanë informacion mbi lartësinë.

-- Përshkrimi --
SHËNIM 1 - Ajo përfshin caktimin e kufijve të çdo ishulli të të dhënave të lartësisë, të cilat janë të izoluara nga DEM-i kryesor.

SHËNIM 2 Zonat e izoluara mund të jenë të dobishme kur llogaritet një DEM më të përshtatshëm ose të saktë.
Tipi i elementit - FeatureType

LIDHJE STRUKTURORE TË JASHTME
⇐ Gjeneralizim nga «featureType» Zonat e Kufizuara te «featureType» Objektet Vektor të Lartësive [Drejtimi: 'Burimi -> Destinacion'.]

ATRIBUTET
Gjeometria: GM_Sipërfaqe Shumëllojshmëria: [1] **-- Emri --** Gjeometria **-- Përkufizimi --** Përfaqëson karakteristikat gjeometrike të objektit gjeohapësinor. [I detyrueshëm: PO]

3.1.3.2.11 VLERAT E LLOJIT TË IZOIPSEVE

-- Emri --
Vlerat e llojit të izoipseve

-- Përkufizimi --
Lista e kategorive të mundshme të izoipseve bazuar në parametrat ekuidistancë të grupit të të dhënave.
Tipi i elementit - Numërtim

ATRIBUTET
Kryesore: **-- Emri --** Kryesore **-- Përkufizimi --** Izoipset kryesore sipas renditjes së vlerave. **-- Përshkrimi --** Izoipset kryesore në përgjithësi ndërtohen me një interval: 1 në 5 izoipse.
Ndihmëse: **-- Emri --** Ndihmëse **-- Përkufizimi --**

ATRIBUTET
Izoipset ndihmëse sipas renditjes së vlerave. **-- Përshkrimi --** Izoipset ndihmës në përgjithësi ndërtohen me një intervali: 4 në 5 izoipse.
Ndërmjetme: **-- Emri --** Ndërmjetme **-- Përkufizimi --** Izoipse të cilat nuk i korrespondojnë intervalit të zakonshëm të izoipseve por të ndërmjetme, në mënyrë që të ndihmojnë interpretimin e relievit. Përdoren në ato raste kur pjerrësia e terrenit nuk lejon interpretimin e relievit me intervalet e zakonshme të izoipseve.

3.1.4 PËRSHKRIMI I NËNTEMËS – LARTËSITË TIN
PARAQITJA E MBULIMIT TË LARTËSIVE

Lloji i objektit gjeohapësinor Lartësitë TIN përcakton një mozaik të hapësirës bazuar në një Rrjet të Parregullt Trekëndëshash sipas një lloji të ndërlikuar të gjeometrisë GM_Tin përkufizuar në *SSH EN ISO 19123:2007*. Ai konsiston në një koleksion gjeometrish vektoriale si pikat e kontrollit (vlerat vektoriale të të cilave njihen), vijat e thyerjes dhe vijat e kufizimit. Një GM_Tin përbëhet nga të paktën 3 kulme (1 trekëndësh). Modelimi i zonave të zbrazëta brenda një strukture TIN është i mundur duke përdorur një grup të përshtatshëm vijash kufizuese, duke penguar gjenerimin e trekëndëshave që përkojnë me atë zonë.

Kjo nëntemë nuk është një element i detyrueshëm për temën Modeli Dixhital i Lartësive. Është një element opsional. Mjafton që përfaqësimi hapësinor i të dhënave të jepet sipas një ndër formatet e përmendura në nëntemat më sipër.

3.1.4.1 DIAGRAMI UML
3.1.4.1.1 LARTËSITË-TIN: DIAGRAMI



Figurë 9: Lartësitë TIN

3.1.4.2 KATALOGU I TIPOLOGJISË
3.1.4.2.1 LARTËSITË TIN

-- Emri --
Lartësitë TIN

-- Përkufizimi --
Koleksioni i objekteve gjeohapësinore të lartësisë që formojnë një mozaik të veçantë gjeohapësinor bazuar në një Rrjet të Parregullt Trekëndor (TIN) në përputhje me gjeometrinë GM_TIN (përkufizuar në *SSH EN ISO 19123:2007*)..

-- Përshkrimi--
TIN mund të llogaritet duke përdorur çdo metodë trekëndëshash e cila përcakton marrëdhëniet gjeohapësinore mes objekteve gjeohapësinore në koleksion.
SHEMBULL 1: Një model TIN i lartësisë që llogaritet me anë të metodës trekëndore "Delauney".
Tipi i elementit – Feature Type

ATRIBUTET
Fillimi i Ciklit Jetësor: Datë_Orë Shumëllojshmëria: [1] **-- Emri --** Fillimi i ciklit jetësor **-- Përkufizimi --** Data në të cilën ky version i objektit gjeohapësinor është krijuar ose ndryshuar në të dhënat gjeohapësinore. [I detyrueshëm: PO]
Gjeometria: GM_TIN Shumëllojshmëria: [1] **-- Emri --** Gjeometria **-- Përkufizimi --** Përfaqëson karakteristikat gjeometrike të objektit gjeohapësinor. [I detyrueshëm: PO]
Inspire ID: Identifikues Shumëllojshmëria: [1] **-- Emri --** Inspire Id **-- Përkufizimi --** Identifikues i jashtëm i objektit hapësinor. **-- Përshkrimi --** Një objekt identifikues i jashtëm është një identifikues unik i objektit të publikuar nga organi përgjegjës, që mund të përdoret nga aplikacionet e jashtme të referimit të objektit hapësinor. Identifikuesi është identifikues i objektit hapësinor, jo identifikues i dukurisë në botë. [I detyrueshëm: PO]
Lloji i Lartësisë të Matur: Vlerat e Llojit të Lartësisë së Matur Shumëllojshmëria: [1]

ATRIBUTET
-- Emri -- Lloji i lartësisë së matur **-- Përkufizimi --** Lloji i lartësisë së matur. [I detyrueshëm: PO]
Lloji I Sipërfaqes: Vlerat e Llojit të Sipërfaqes Shumëllojshmëria: [1] **-- Emri --** Lloji i sipërfaqes **-- Përkufizimi --** Atribut që tregon llojin e sipërfaqes së lartësisë që TIN përshkruan në lidhje me sipërfaqen e zhveshur të Tokës [I detyrueshëm: PO]
Përfundimi i Ciklit Jetësor: Datë_Orë Shumëllojshmëria: [1] **-- Emri --** Përfundimi i ciklit jetësor **-- Përkufizimi --** Data në të cilën ky version i objektit gjeohapësinor është përfunduar [I detyrueshëm: JO]

3.1.5 METADATA

Përshtatja e elementeve të metadatës përcaktohet në rregulloren e miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1077, datë 23.12.2015 "Për krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e metadatave, strukturën e katalogimit dhe afatet e krijimit të metadatave specifike për çdo temë".

3.1.6 SISTEMI REFERENCË, NJËSITË E MATJES DHE RRJETAT GJEOGRAFIKE.

SISTEMET STANDARDE TË REFERIMIT, NJËSITË E MATJEVE DHE RRJETET

Sistemet e referencës, njësitë e matjeve dhe sistemet e rrjeteve gjeografike të përfshira në këtë nënseksion janë standardet që do të përdoren për të gjitha grupet e të dhënave INSPIRE, përveç kur ka përjashtime specifike të temës dhe/ose kërkesa të tjera të përcaktuara në seksionin 6.2.

A. Korniza referuese gjeodezike e Shqipërisë

Korniza Referuese Gjeodezike që do të përdoret në Republikën e Shqipërisë do të quhet:

"Korniza Referuese Gjeodezike Shqiptare" ose shkurt (KRGJSH – kodi EPSG: 6870[1]). KRGJSH do të përcaktohet duke u mbështetur në Kornizën Referuese Gjeodezike Europiane. KRGJSH do të përdoret në të gjitha aplikacionet që lidhen me përdorimin e koordinatave në territorin e vendit. Lidhja midis KRGJSH dhe sistemeve të tjera të përdorura në vendin tonë do të bëhet duke përdorur parametrat e transformimit të llogaritura për çdo rast.

KRGJSH përfshin:

a) Parametrat gjeodezikë bazë të përcaktuar në Sistemin Referues Gjeodezik 1980 (GRS-80) si më poshtë:

- Rrezja e ekuatorit të tokës: a = 6 378 137m;
- Konstantja gravitacionale gjeocentrike e tokës duke përfshirë edhe atmosferën: GM = 3 986 005 x 10-8 m3s-2;
- Faktori dinamik i figurës së tokës pa përfshirë baticën e qëndrueshme: J2 = 108 263 x 10-8;
- Këtij faktori i korrespondon shtypja në pole: 1/f = 298.257222100882711;
- Shpejtësia këndore e rrotullimit të tokës: ω = 7 292115.0 x 10-11rad.sek-1

b) Sistemin koordinativ gjeodezik ETRS 89;

[1] Shiko Aneks 4.3

c) Sistemin e lartësive që realizohet nëpërmjet reperave të rrjetit shtetëror të nivelimit të përfshirë në Rrjetin Unik Europian të Nivelacionit (UELN) dhe të përcaktuara në Sistemin Referues Vertikal Europian (EVRS) me ndihmën e të dhënave për forcën e rëndesës të unifikuara në sistemin International Gravity Standardization Network 1971 (IGSN 1971).

d) Sistemin e koordinatave në plan, i cili mundësohet nga dy projeksione hartografike:

- Projeksioni Tërthor Zonal i Merkatorit (TMzn) për harta në shkallë më të madhe se 1:500.000 me parametrat e mëposhtme:
- Elipsoidi referencë: GRS80
- Meridiani fillestar: Grinuiç
- Meridiani qendror (MQ): 200
- Shkalla e shformimit në meridianin qendror (k0): 1
- Falso e lindjes: 500 000 m
- Falso e veriut: 0 m
- Projeksioni Konik Konform i Lambertit (LCC) për harta në shkallë 1:500 000 dhe më të vogla.

B. Sistemet koordinative referencë sipas INSPIRE

I. Datumi

Datumi për sistemet koordinative referencë dydimensionale dhe tredimensionale

Për sistemet koordinative referencë dydimensionale dhe tredimensionale dhe komponentja horizontale e sistemeve koordinative referencë të kombinuara të përdorura për të bërë të disponueshme grupin e të dhënave gjeohapësinore, si datum do të jetë datumi i Sistemit Referencë Tokësor Europian 1989 (ETRS89) në zona brenda kufijve gjeografik të tij, ose datumi i Sistemit Referencë Tokësor Ndërkombëtar (ITRS) ose sisteme koordinative referencë gjeodezike të tjera të përputhura me ITRS, në zona që ndodhen jashtë kufijve gjeografik të ETRS89. Të përputhura me ITRS do të thotë që përkufizimi i sistemit bazohet në përkufizimin e ITRS dhe ka një marrëdhënie të mirë-dokumentuar mes dy sistemeve, sipas *SSHEN ISO 19111:2007*

II. Sistemet koordinative referencë

Sistemet koordinative referencë

Grupet e të dhënave gjeohapësinore do të bëhen të disponueshme duke përdorur të paktën një prej sistemeve koordinatave referencë të caktuara në seksionet 1.3.1, 1.3.2 dhe 1.3.3, përveç kur qëndron njëri prej kushteve të caktuara në seksionin 1.3.4.

1.3.1 Sistemet koordinative referencë tredimensionale

- Koordinatat karteziane tredimensionale bazohen në një datum të caktuar në seksionin 1.2 dhe përdorin parametrat e elipsoidit GRS80 (Sistemi Gjeodezik Referencë 1980).
- Koordinatat gjeodezike tredimensionale (gjerësia, gjatësia dhe lartësia elipsoidike) bazohen në një datum të caktuar në seksionin 1.2 dhe përdorin parametrat e elipsoidit GRS80.

1.3.2 Sistemet koordinative referencë dydimensionale

- Koordinatat gjeodezike dydimensionale (gjerësia dhe gjatësia) bazohen në një datum të caktuar në seksionin 1.2 dhe përdorin parametrat e elipsoidit GRS80.
- Koordinatat në plan përdorin sistemin koordinativ referencë ETRS89 me projeksion LAEA (Lambert Azimuthal Equal Area) për analiza gjeohapësinore dhe raportime, ku duhet të pasqyrohen sipërfaqet e vërteta.
- Koordinatat në plan përdorin sistemin koordinativ referencë ETRS89 me projeksion LCC (Lambert Conformal Conic) për hartografime konforme në territorin e Evropës në shkallë të barabarta ose më të vogla se 1:500 000.

- Koordinatat në plan përdorin sistemin koordinativ referencë ETRS89 me projeksion TM (Transverse Mercator) për hartografime konforme në territorin e Evropës në shkallë të barabarta ose më të mëdha se 1:500 000.

1.3.3 Sistemet koordinative referencë të kombinuara

1. Për komponenten horizontale të sistemit koordinativ referencë të kombinuar, një prej sistemeve koordinative referencë të caktuara në seksionin 1.3.2 do të përdoret.

2. Për komponenten vertikale, do të përdoret një prej sistemeve koordinative referencë të mëposhtme:

- Për komponenten vertikale në sipërfaqen tokësore, do të përdoret Sistemi Referencë Vertikal Europian (EVRS) për të shprehur lartësitë e lidhura me gravitetin brenda kufijve gjeografik të këtij sistemi. Në zona të cilat ndodhen jashtë kufijve gjeografik të EVRS, do të përdoren sisteme referencë vertikale të tjera të lidhura me fushën e gravitetit Tokësor për të shprehur lartësitë e lidhura me gravitetin.
- Për komponenten vertikale në atmosferen e lirë, presioni barometrik i konvertuar në lartësi duke përdour *SSHISO 2533:1975* Atmosferën Standarde Ndërkombëtare, ose do të përdoren sisteme referencë të tjera lineare ose parametrike. Aty ku janë përdorur sisteme referencë parametrike të tjera, ato do të përshkruhen në një referencë të kuptueshme duke përdorur *SSH EN ISO 19111-2:2012*.
- Për komponenten vertikale në zonat detare ku ka një rang të ndjeshëm batice (ujëra baticor), si sipërfaqe referencë do të përdoret Batica më e ulët Astronomike (LAT).
- Për komponenten vertikale në zonat detare ku nuk ka një rang të ndjeshëm batice, në oqeanet e hapura dhe efektivisht në ujëra me të thella se 200 metra, si sipërfaqe referencë do të përdoret niveli mesatar i detit (MSL) ose një nivel referencë i mirë-përcaktuar i afërt me MSL.

1.3.3 Sistemet koordinative referencë të tjera

Si përjashtime, ku mund të përdoren sisteme referencë të tjera nga ato të listuara në 1.3.1, 1.3.2 ose 1.3.3, janë:

1. Sisteme koordinative referencë të tjera mund të caktohen për temat e të dhënave gjeohapësinore specifike në këtë Aneks.

2. Për zonat (regjionet) që ndodhen jashtë kontinentit të Evropës, Shtetet Anëtare (MS) mund të përcaktojnë sisteme koordinative referencë të përshtatshme.

Kodet gjeodezike dhe parametrat e nevojshëm për përshkrimin e këtyre sistemeve koordinative referencë dhe të cilat lejojnë veprimet e konvertimit dhe transformimit duhet të dokumentohen dhe duhet të krijohet një identifikues, sipas *SSH EN ISO 19111: 19127* dhe *SSH EN ISO 19127:2019*.

III. Paraqitja

Sistemet koordinative referencë të përdorura në shërbimin e shikimit të rrjetit

Për shfaqjen e grupeve të të dhënave gjeohapësinore nëpërmjet shërbimit të shikimit të rrjetit siç specifikohet në rregulloren nr. 976/2009, së paku sistemet koordinative referencë për koordinatat gjeodezike dydimensionale (gjerësia, gjatësia) do të jenë të disponueshme.

IV. Identifikuesit për sistemet koordinative referencë

Identifikuesit e sistemeve koordinative referencë

1. Parametrat dhe identifikuesit e sistemit koordinativ referencë do të menaxhohen në një ose disa regjistra të përbashkët për sistemet koordinative referencë.

2. Vetëm identifikuesit që përmban një regjistër i përbashkët do të përdoren për referimin te sistemet koordinative referencë të listuara në këtë seksion.

3. Identifikuesit e listuar në tabelën 2 do të përdoren për referimin te sistemet koordinative referencë të përdorura në një grup të dhënash.

Këto udhëzuese teknike propozojnë përdorimin e http URl-të të ofruara nga Open Geospatial Consortium si identifikues të sistemit koordinativ referencë (shiko identifikuesit për CRS-të standard më poshtë). Këto janë të bazuara dhe të drejtojnë te përkufizimi në regjistrin e parametrave gjeodezik EPSG *(http://www.epsg-registry.org/)*.

Shënim: Identifikuesit e CRS mund të përdoren, p.sh., në:
- Kodimin e të dhënave,
- Metadatat e grupeve dhe shërbimeve të të dhënave, dhe
- Kërkesat për shërbimet e rrjetit të INSPIRE.

Tabela 2. http URl-të për sistemet koordinative referencë standard:

Sistemi koordinativ referencë	Shkurtimi	Identifikuesi http URl
Korniza Referuese Gjeodezike Shqiptare. ETRS89/ Abania	**KRGJSH**	***http://www.epsg-registry.org/export.htm?gml=urn:ogc:def:crs:EPSG::6870***
Kartezian 3D në ETRS89	ETRS89-XYZ	*http://www.opengis.net/def/crs/EPSG/0/4936*
Gjeodezike 3D në ETRS89 mbi GRS80	ETRS89-GRS80h	*http:// www.opengis.net/def/crs/EPSG/0/4937*
Gjeodezike 2D në ETRS89 mbi GRS80	ETRS89-GRS80	*http:// www.opengis.net/def/crs/EPSG/0/4258*
Projeksion LAEA 2D në ETRS89 mbi GRS80	ETRS89-LAEA	*http:// www.opengis.net/def/crs/EPSG/0/3035*
Projeksion LCC 2D në ETRS89 mbi GRS80	ETRS89-LCC	*http:// www.opengis.net/def/crs/EPSG/0/3034*
Projeksion TM 2D në ETRS89 mbi GRS80, zona 34N (18°Ë deri 24°Ë)	ETRS89-TM34N	*http:// www.opengis.net/def/crs/EPSG/0/3046*
Lartësi në EVRS	EVRS	*http:// www.opengis.net/def/crs/EPSG/0/5730*
3D të kombinuara: Gjeodezike 2D në ETRS89 mbi GRS80, dhe lartësitë EVRS	ETRS89-GRS80-EVRS	*http:// www.opengis.net/def/crs/EPSG/0/7409*

C. Sistemet e referencës kohore

Sistemet e referencës kohore

Sistemi standard i referencës kohore i cituar në pikën 5, kreu II të VKM-së nr. 1077, datë 23.12.2015 "Për krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e metadatave, strukturën e katalogimit dhe afatet e krijimit të metadatave specifike për çdo temë". do të përdoret, përveç rastit kur janë caktuar sisteme koordinative të referencës kohore të tjera për tema të të dhënave gjeohapësinore specifike në ligjin nr. 72/2012.

Shënim 1: Pika 5 e kreut II të VKM-së nr. 1077, datë 23.12.2015 "Për krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e metadatave, strukturën e katalogimit dhe afatet e krijimit të metadatave specifike për çdo temë" thekson që sistemi standard referencë do të jetë kalendari Gregorian, me datat e shprehura në përputhje me *SSHISO 8601-1, . 8601-2:2019*

Shënim 2: *SSHISO 8601-1, . 8601-2:2019* Elementet e të dhënave dhe formatet e shkëmbimit – Shkëmbimi i informacionit – Pasqyrimi i datës dhe orës është një standard ndërkombëtar që mbulon shkëmbimin e të dhënave të lidhura datën dhe orën. Qëllimi i këtij standardi është që të sigurojë një metodë të qartë dhe të mirë-përcaktuar për pasqyrimin e datës dhe orës, në mënyrë që të shmangen keqinterpretimet e pasqyrimeve numerike të datë dhe orës, veçanërisht kur të dhënat transmetohen ndërmjet shteteve me konventa të ndryshme për shkrimin numerik të datës dhe orës. Standardi organizon të dhënat në mënyrë që afati më i madh i kohor(viti) shfaqet fillimisht në të dhëna varg dhe vazhdon deri tek afati më i vogël kohor (sekondë). Ajo gjithashtu ofron një metodë të standardizuar për komunikimin informacionit të bazuar në kohë ndërmjet zonave kohore duke i

dhënë një spostim të Kohës Universale të Koordinuar (UTC).

Shembull: 1997 (viti 1997); 1997-07-16 (16 Korrik 1997); 1997-07-16T 19:20:30+01:00 (16 Korrik 1997, 19ore 20min 30sek, zona kohore UTC+1).

D. Njësitë e matjeve

Kërkesa dhe rregulla të tjera

Të gjitha vlerat e matjeve duhet të shprehen nëpërmjet njësive SI ose jo-SI të pranuara për përdorim me Sistemin Ndërkombëtar të Njësive, përveç kur specifikohet ndryshe për tema apo tipa specifikë të të dhënave gjeohapësinore.

3.1.7 CILËSIA E TË DHËNAVE

Ky kapitull përfshin një përshkrim mbi cilësinë e të dhënave të elementeve dhe nënelementeve, si dhe cilësinë e matjes së të dhënave, që duhen përdorur për të vlerësuar dhe dokumentuar cilësinë e të dhënave për grupet e të dhënave që lidhen me të dhënat gjeohapësinore të temës "Modeli Dixhital i Terrenit".

Cilësia e të dhënave të elementeve, nënelementeve dhe matjeve duhet të përdoret për të:

- Specifikuar kërkesat apo rekomandimet lidhur me cilësinë e të dhënave të rezultateve të aplikueshme për grupet e të dhënave që lidhen me të dhënat gjeohapësinore për temën "Emërtimet gjeografike";
- Vlerësuar dhe dokumentuar cilësinë e elementeve të metadatave të të dhënave të grupeve të të dhënave.

Tabela 3. Elementet e cilësisë të të dhënave të përdorura në temën e të dhënave gjeohapësinore

Pjesa	Elementi i cilësisë së të dhënave / Nënelementi	Përkufizimi	Sfera e vlerësimit	Aplikimi për llojet e paraqitjes gjeohapësinore		
				Vektor	Rrjet i rregullt	Rrjet trekëndëshash i parregullt
3.1.15.1	Kompletimi / Autorizimi	Të dhënat të pranishme nga grupi i të dhënave, siç përshkruhen nga objekti i fushëveprimit.	Grup të dhënash / seritë e grupit të të dhënave	■		■
3.1.15.2	Kompletimi / Përjashtimi	Të dhënat e përjashtuara nga grupi i të dhënave, siç përshkruhen nga objekti i fushëveprimit.	Grup të dhënash /seritë e grupit të të dhënave/tipi objektit gjeohapësinor	■	■	■
3.1.15.3	Përputhja logjike / Përputhja konceptuale	Zbatimi i rregullave të skemës konceptuale	Objekt gjeohapësinor/ tipi objektit gjeohapësinor	■	■	■
3.1.15.4	Përputhja logjike / Përputhja e domain-it	Zbatimi i vlerave të fushave të domain-it	Objekt gjeohapësinor/ tipi objektit gjeohapësinor	■		■
3.1.15.5	Përputhja logjike / Përputhja e formatit	Shkalla në të cilën të dhënat ruhen në përputhje me strukturën fizike të grupit të të dhënave, siç	Grup të dhënash/ seritë e grupit të të dhënave	■	■	■

		përshkruhen nga sfera				
3.1.15.6	Përputhja logjike/ Përputhja e topologjike	Korrektësia e karakteristikave të koduara topologjike në mënyrë të qartë të grupit të të dhënave, siç përshkruhet nga sfera	lloji objektit gjeohapësinor/ Grup të dhënash/ seritë e grupit të të dhënave	■		■
3.1.15.7	Saktësia pozicionale/ Saktësi absolute ose e jashtme	Afrimi me vlerat e koordinatave të raportuara të pranuara si të vërteta ose të vërteta	Objekt gjeohapësinor/ tipi objektit gjeohapësinor/ seritë e grupit të të dhënave/ Grup të dhënash	Komponent horizontal ■		Komponent horizontal ■
				Komponent vertikal ■	Komponent vertikal ■	Komponent horizontal ■
3.1.15.8	Saktësia tematike/ Korrektësia e klasifikimit	Krahasim i kategorive të caktuara veçorive ose atributeve të tyre në gjithësinë e diskursit	Objekt gjeohapësinor/ tipi objektit gjeohapësinor/ seritë e grupit të të dhënave/ Grup të dhënash		Komponent horizontal ■	

Rekomandim 1

Kur është e pamundur të shprehet vlerësimi i elementit të cilësisë së të dhënave në një mënyrë sasiore, vlerësimi i elementit duhet të shprehet me një deklaratë tekstuale si një rezultat përshkrues i cilësisë së të dhënave.

3.1.7.1 KOMPLETIMI - AUTORIZIMI (COMPLETNESS-COMMISSION)

Rekomandim 21

Autorizimi duhet të vlerësohet dhe dokumentohet duke përdorur shkallën e artikujve të tepërt dhe numrin e shembujve të veçorisë të dublikuar siç specifikohet në tabelat më poshtë.

Emri	**Norma e artikujve të tepërt**
Emri alternativ	-
Cilësia e të dhënave të elementeve	Kompletimi
Cilësia e të dhënave të nënelementeve	Autorizimi
Cilësia e të dhënave të matjeve themelore	Shkalla e gabimit
Përkufizim	Numri i artikujve të tepërt në grupin e të dhënave në lidhje me numrin e artikujve që duhet të ishin të pranishëm.
Përshkrim	-
Fusha vlerësimit	Grupi i të dhënave / seritë e grupit të të dhënave
Fusha raportimit	Grupi i të dhënave/ seritë e grupit të të dhënave
Parametër	-
Cilësia e të dhënave të llojeve të vlerave	Reale, përqindja, raporti
Cilësia e të dhënave të strukturës së vlerave	Vlera e vetme
Burimi referencë	*SSH EN ISO 19157:2013* Informacioni gjeografik - Cilësia e të dhënave
Shembull	2% (Grupi i të dhënave ka 2% të izoipseve më shumë se ato të ato të nevojshme për të modeluar universin e ligjëratës)
Masa identifikuese	3 (*SSH EN ISO 19157:2013*)

3.1.7.2 KOMPLETIMI - PËRJASHTIMI. (COMPLETNESS– OMISSION)

Rekomandim 22

Përjashtimi duhet të vlerësohet dhe të dokumentohet duke përdorur normën e artikujve të tepërt të përcaktuara në tabelat e mëposhtme. Vlerësimi i tipit të objektit gjeohapësinor dhe shtrirja rekomandohet sidomos për izoipset vektor të objektit gjeohapësinore për rrjetin e mbulimit të lartësisë.

Emri	**Norma e artikujve të tepërt**
Emri alternativ	-
Cilësia e të dhënave të elementeve	Kompletimi
Cilësia e të dhënave të nënelementeve	Përjashtimi
Cilësia e të dhënave të matjeve themelore	Shkalla e gabimit
Përkufizim	Numri i artikujve të hequr në grupin e të dhënave në lidhje me numrin e artikujve që duhet të ishin të pranishëm.
Përshkrim	-
Fusha vlerësimit	Grupi i të dhënave
Fusha raportimit	Grupi i të dhënave/tipi objektit gjeohapësinore
Parametër	-
Cilësia e të dhënave të llojeve të vlerave	Reale, përqindja, raporti
Cilësia e të dhënave të strukturës së vlerave	-
Burimi referencë	-
Shembull	
Masa identifikuese	5

3.1.7.3 PËRPUTHJA LIGJORE – PËRPUTHJA KONCEPTUALE. (LOGICAL CONSISTENCY – CONCEPTUAL CONSISTENCY)

Rekomandim 23

Për testimet mbi përputhjen konceptuale, rekomandohet përdorimi i nënelementit të cilësisë së të dhënave të 'Përputhja logjike– Përputhja konceptuale' dhe matjet e 'Shkalla e mospajtueshmërisë në përputhje me rregullat e skemës konceptuale', të përcaktuara në tabelat e më poshtme:

Emri	**Norma e artikujve jo në përputhje me rregullat e skemës konceptuale**
Emri alternativ	-
Cilësia e të dhënave të elementeve	Përputhja logjike
Cilësia e të dhënave të nënelementeve	Përputhja konceptuale
Cilësia e të dhënave të matjeve themelore	Numri i gabimit
Përkufizim	Numërimin e të gjithë artikujve në grupet e të dhënave të cilat nuk janë në përputhje me rregullat e skemës konceptuale në lidhje me numrin total të gjithë këtyre artikujve që supozohen të jenë në grupin e të dhënave
Përshkrim	Nëse skema konceptuale në mënyrë të qartë përshkruan rregullat, këto rregulla do të ndiqen.
Fusha vlerësimit	Objektet gjeohapësinor / tipat e objekteve gjeohapësinor
Fusha raportimit	Grupet e të dhënave/ seritë e grupeve të të dhënave
Parametër	-
Cilësia e të dhënave të llojeve të vlerave	Reale, përqindja, raporti
Cilësia e të dhënave të strukturës së vlerave	-
Burimi referencë	*SSH EN ISO 19157:2013* Informacioni Gjeografik – Cilësia e të dhënave
Shembull	-
Masa identifikuese	12(*SSH EN ISO 19157:2013*)

3.1.7.4 PËRPUTHJA LIGJORE – PËRPUTHJA ME DOMAIN-IN (LOGICAL CONSISTENCY – DOMAIN CONSISTENCY)

Rekomandim 24

Për testimet mbi përputhjen me domain, rekomandohet përdorimi i nënelementit të cilësisë të të dhënave të Përputhjes Logjike – Përputhjes me domain dhe matjes së shkallës së vlerës së mospërputhshmërisë së domen-it siç është specifikuar më poshtë:

Emri	**Norma e artikujve jo në përputhje me domain-in e vlerës së tyre**
Emri alternativ	-
Cilësia e të dhënave të elementeve	Përputhja logjike
Cilësia e të dhënave të nënelementeve	Përputhja me domain
Cilësia e të dhënave të matjeve themelore	Shkalla e gabimit
Përkufizim	Numërimin e të gjithë artikujve në grupet e të dhënave të cilat nuk janë në përputhje me fushën e vlerës së tyre në lidhje me numrin e përgjithshëm të artikujve
Përshkrim	-
Fusha vlerësimit	Objektet gjeohapësinor / tipat e objekteve gjeohapësinor
Fusha raportimit	Grupet e të dhënave/seritë e grupeve të të dhënave
Parametër	-
Cilësia e të dhënave të llojeve të vlerave	Reale, përqindja, raporti
Struktura e të dhënave të llojeve të vlerave	Vlerë e vetme
Burimi referencë	*SSH EN ISO 19157:2013* Informacioni gjeografik - Cilësia e të dhënave
Shembull	-
Masa identifikuese	18 (*SSH EN ISO 19157:2013*)

3.1.7.5 PËRPUTHJA LOGJIKE – PËRPUTHJA E FORMATIT. (LOGICAL CONSISTENCY – FORMAT CONSISTENCY)

Rekomandim 25

Përputhja me formatin duhet të vlerësohet dhe dokumentohet duke përdorur Shkallën e përplasjes me strukturën fizike siç specifikohet në tabelën më poshtë:

Emri	**Norma e konfliktit të strukturës fizike**
Emri alternativ	-
Cilësia e të dhënave të elementeve	Përputhja logjike
Cilësia e të dhënave të nënelementeve	Përputhja e formatit
Cilësia e të dhënave të matjeve themelore	Numri i gabimit
Përkufizim	Numri i artikujve në grupin e të dhënave që janë të ruajtura në konflikt me strukturën fizike të grupit të të dhënave pjesëtuar me numrin e përgjithshëm të artikujve
Përshkrim	-
Fusha vlerësimit	Grupet e të dhënave/seritë e grupeve të të dhënave
Fusha raportimit	Grupet e të dhënave/ seritë e grupeve të të dhënave
Parametër	-
Cilësia e të dhënave të llojeve të vlerave	Reale, përqindja, raporti

Cilësia e të dhënave të strukturës së vlerave	Vler të e vetme
Burimi referencë	*SSH EN ISO 19157:2013* Informacioni gjeografik - Cilësia e të dhënave
Shembull	-
Masa identifikuese	20 (*SSH EN ISO 19157:2013*)

3.1.7.6 PËRPUTHJA LOGJIKE - PËRPUTHJA TOPOLOGJIKE. (LOGICAL CONSISTENCY-TOPOLOGICAL CONSISTENCY)

Rekomandim 26

Përputhja topologjike e vijave vektore të objekteve gjeohapësinorë të cilat do të lidhen duhet të vlerësohet dhe të dokumentohet duke përdorur Numrin e mbivendosjeve të pavlefshme të sipërfaqeve, Numri i lidhjeve të humbura për shkak të mungesës së lidhjeve, Numri i lidhjeve të humbura për shkak të tejkalimit të lidhjes, Numri i pjesëve të pavlefshme, Numri i pavlefshëm i gabimeve vetëndërprerjes, Numri i pavlefshëm i vetëmbivendosjes së gabimeve të përcaktuara në tabelat më poshtë.

Emri	**Numri i lidhjeve të që mungojnë për shkak të mungeses**
Emri alternativ	Shkalla e humbjeve
Cilësia e të dhënave të elementeve	Përputhja logjike
Cilësia e të dhënave të nënelementeve	Përputhja topologjike
Cilësia e të dhënave të matjeve themelore	Shkalla e gabimit
Përkufizim	Numri total i artikujve në grupin e të dhënave, brenda tolerancës së parametrit, që kanë mospërputhje për shkak të nënndarjeve të ndara nga numri i përgjithshëm i elementeve në grupin e të dhënave.
Përshkrim	Mungesat e lidhjeve që tejkalojnë tolerancën e parametrave konsiderohen si gabim (nënndarje) nëse tiparet e vërteta të lartësisë lineare duhet të lidhen.
Fusha vlerësimit	tipi i objektit gjeohapësinore: *Izoipse, Vija thyerje* grupet e të dhënave/ seritë e grupeve të të dhënave
Fusha raportimit	tipi i objektit gjeohapësinor: *Izoipse, vija thyerje* grupet e të dhënave/ seritë e grupeve të të dhënave
Parametër	Emri: *Toleranca e lidhjes* Përkufizimi Distanca e kërkimit nga fundi i linjës së varjes. Përshkrimi Ky parametër është i veçantë për secilin grup të dhënash të ofrueseve të të dhënave dhe që duhet të raportohen si metadata për vlerësimin e cilësisë të dhënave të matura. Toleranca duhet të specifikohet nga ofruesi i të dhënave duke përdorur elementet e mëposhtëm të Përputhjes Topologjike _DQ për matjen aktuale: - 102. Përshkrimi matjes (lloji: tekst i lirë): Përkufizuar si "Përshkrimi i matjes". - 107. Rezultati (lloji DQ_Result): Përkufizuar si *"Vlera (ose grup vlerash) përftuar nga aplikimi i matjes së cilësisë së të dhënave ose përfundimi i vlerësimit të vlerës së përftuar (ose grup vlerash) përkundrejt një niveli cilësie të një pajtimi të specifikuar e të pranueshëm".* Në mënyrë specifike, toleranca duhet të përkufizohet brenda dy elementeve: - 130. specification - 131. explanation nga kategoria DQ_Result.

	Shënim: Elementet e metadatave përkufizuar në *SSH EN ISO 19115-1:2014*
Cilësia e të dhënave të llojeve të vlerave	Reale, përqindja, raporti
Cilësia e të dhënave të strukturës së vlerave	Vlerë e vetme
Burimi referencë	*SSH EN ISO 19157:2013* Informacioni gjeografik - Cilësia e të dhënave
Shembull	Shembull - Lidhja midis dy izoipseve të njëpasnjëshme Raste me të njëjtën lartësi që duhet të lidhen  Çelësi 1 Toleranca e lidhjes = 3 m (Moslidhja)
Masa identifikuese	Kjo matje është përcaktuar qartë në këtë specifikim të dhënash. Rrjedh nga matja DQ 23 (*SSH EN ISO 19157:2013*

Emri	**Numri i lidhjeve që mungojnë për shkak të tejkalimit**
Emri alternativ	Shkalla e tejkalimit
Cilësia e të dhënave të elementeve	Përputhja logjike
Cilësia e të dhënave të nënelementeve	Përputhja topologjike
Cilësia e të dhënave të matjeve themelore	Shkalla e gabimit
Përkufizim	Numri total i artikujve në grupin e të dhënave, brenda tolerancës së parametrit, që kanë mospërputhje për shkak të nënndarjeve të ndara nga numri i përgjithshëm i elementeve në grupin e të dhënave.
Përshkrim	Mungesat e lidhjeve që tejkalojnë tolerancën e parametrave konsiderohen si gabim (nënndarje) nëse tiparet e vërteta të lartësisë lineare duhet të lidhen.
Fusha vlerësimit	tipi i objektit gjeohapësinore: *Izoipse, Vija thyerje* grupet e të dhënave/ seritë e grupeve të të dhënave
Fusha raportimit	tipi i objektit gjeohapësinore: *Izoipse, Vija thyerje* grupet e të dhënave/ seritë e grupeve të të dhënave
Parametër	Emri *Toleranca e lidhjes* Përkufizimi Distanca e kërkimit nga fundi i linjës së varjes. Përshkrimi Ky parametër është i veçantë për secilin grup të dhënash të ofrueseve të të dhënave dhe që duhet të raportohen si metadata për vlerësimin e cilësisë të dhënave të matura. Toleranca duhet të specifikohet nga ofruesi i të dhënave duke përdorur elementet e mëposhtëm të Pëputhjes Topologjike _DQ për matjen aktuale: - 102. Përshkrimi matjes (lloji: tekst i lirë): Përkufizuar si "Përshkrimi i matjes". - 107. Rezultati (lloji DQ_Result): Përkufizuar si "Vlera (ose grup vlerash) përftuar nga aplikimi i matjes së cilësisë së të dhënave ose përfundimi i vlerësimit të vlerës së përftuar (ose grup vlerash) përkundrejt një niveli cilësie të një pajtimi të specifikuar e të pranueshëm". Në mënyrë specifike, toleranca duhet të përkufizohet brenda dy

	elementeve: - 130. specification - 131. explanation nga kategoria DQ_Result. Shënim: Elementet e metadatave përkufizuar në ISO 19115.. Ky parametër është i veçantë për secilin grup të dhënash të ofrueseve të të dhënave dhe duhet të raportohen si metadata për vlerësimin e cilësisë të dhënave të matura. Toleranca duhet të specifikohet nga ofruesi i të dhënave duke përdorur elementet e mëposhtëm të Përputhjes Topologjike _DQ për matjen aktuale: - 102. Përshkrimi matjes (lloji: tekst i lirë): Përkufizuar si "Përshkrimi i matjes". - 107. Rezultati (lloji DQ_Result): Përkufizuar si *"Vlera (ose grup vlerash) përftuar nga aplikimi i matjes së cilësisë së të dhënave ose përfundimi i vlerësimit të vlerës së përftuar (ose grup vlerash) përkundrejt një niveli cilësie të një pajtimi të specifikuar e të pranueshëm".* Në mënyrë specifike, toleranca duhet të përkufizohet brenda dy elementeve: - 130. specification - 131. explanation nga kategoria DQ_Result. Shënim: Elementet e metadatave përkufizuar në *SSH EN ISO 19115-1:2014*
Cilësia e të dhënave të llojeve të vlerave	Reale, përqindja, raporti
Cilësia e të dhënave të strukturës së vlerave	Vlerë e vetme
Burimi referencë	*SSH EN ISO 19157:2013* Informacioni gjeografik - Cilësia e të dhënave
Shembull	Shembull - Lidhja midis dy izoipseve të njëpasnjëshme Raste me të njëjtën lartësi që duhet të lidhen **Çelësi** 1 Toleranca e lidhjes = 3 m (Moslidhja)
Masa identifikuese	Kjo matje është përcaktuar qartë në këtë specifikim të dhënash. Rrjedh nga matja DQ 26 (*SSH EN ISO 19157:2013*).

Rekomandim 27

Përputhja topologjike e vijave vektorë të objekteve gjeohapësinorë dhe kufijve të objekteve gjeohapësinore duhet të vlerësohet dhe dokumentohet duke përdorur Numrin e vetëndërprerjeve të pavlefshme dhe Numrin e mbivendosjeve të pavlefshme siç janë specifikuar në tabelën më poshtë:

Emri	**Numri i gabimeve të pavlefshme me vetëmbivendosje**
Emri alternativ	Lëvizje të pakontrolluara
Cilësia e të dhënave të elementeve	Përputhja logjike
Cilësia e të dhënave të nënelementeve	Përputhja topologjike

Cilësia e të dhënave të matjeve themelore	Shkalla e gabimit
Përkufizim	Numërimi artikujve në grupin e të dhënave, që vetëndërpriten në mënyrë të palejuar të ndarë nga numri total i artikujve në grupin e të dhënave.
Përshkrim	-
Fusha vlerësimit	tipi i objektit gjeohapësinor: *Izoipse, Vija thyerje, Zona pa info, Zona të kufizuara* grupet e të dhënave/ seritë e grupeve të të dhënave
Fusha raportimit	tipi i objektit gjeohapësinor: *Izoipse, Vija thyerje, Zona pa info, Zona të kufizuara* grupet e të dhënave/ seritë e grupeve të të dhënave
Parametër	-
Cilësia e të dhënave të llojeve të vlerave	Reale, përqindja, raporti
Cilësia e të dhënave të strukturës së vlerave	Vlerë e vetme
Burimi referencë	*SSH EN ISO 19157:2013* Informacioni gjeografik - Cilësia e të dhënave
Shembull	Shembull-Mbivendosje e në rastin e izoipseve Çelësi **Çelësi** 1.Ndërprerje e palejueshme
Masa identifikuese	Kjo matje është përcaktuar qartë në këtë specifikim të të dhënave. Rjedh nga matja DQ 26 (*SSH EN ISO 19157:2013*).

3.1.7.7 SAKTËSIA E POZICIONIMIT – SAKTËSIA ABSOLUTE APO E JASHTME. POSITIONAL ACCURACY - ABSOLUTE OR EXTERNAL ACCURACY)

Rekomandim 28

Saktësia absolute ose e jashtme e komponentit horizontal të objekteve vektoriale brenda grupeve të të dhënave vektoriale dhe brenda strukturave TIN duhet të vlerësohet dhe dokumentohet duke përdorur gabimin mesatar kuadratik të planimetrisë siç është specifikuar në tabelën e mëposhtme.

Emri	**Vlera mesatare e gabimit pozicional**
Emri alternativ	Vlera mesatare e gabimit pozicional
Cilësia e të dhënave të elementeve	Saktësia e pozicionimit
Cilësia e të dhënave të nënelementeve	Saktësia e jashtme apo absolute
Cilësia e të dhënave të matjeve themelore	Jo e aplikueshme
Përkufizim	Vlera mesatare e gabimit pozicional për një grup të pozicioneve ku paqartësitë pozicionale janë përcaktuar si distanca midis një pozicioni të matur dhe asaj çfarë është konsideruar si pozicioni i vërtetë përkatës.

Përshkrim[2]	Saktësia horizontale $$GMK_X = \sqrt[2]{\sum (x_{Edhënë,i} - x_{Ekontrolluar,i})^2/n}$$ $$GMK_Y = \sqrt[2]{\sum (y_{Edhënë,i} - y_{Ekontrolluar,i})^2/n}$$ ku: $x_{Edhënë,i}$, $y_{Edhënë,i}$ – janë koordinatat horizontale e pikave të kontrolluara në grupin e të dhënave. $x_{Ekontrolluar,i}$, $y_{Ekontrolluar,i}$ – janë koordinatat e pikave të kontrolluara nga burime të pa varuara të një saktësie më të lartë n – është numri i pikave të testuara i - është numri përkatës i pikes. Gabimi horizontal i pikës përcaktohet nga: $$GMK_r = \sqrt[2]{\sum ((x_{Edhënë,i} - x_{Ekontrolluar,i})^2 + (y_{Edhënë,i} - y_{Ekontrolluar,i})^2)/n}$$ $$GMK_r = \sqrt{GMK_x{}^2 + GMK_y{}^2}$$ Nëse nga llogaritjet kemi $GMK_X = GMK_Y$, $$GMK_r = \sqrt{2 * GMK_x{}^2} = \sqrt{2 * GMK_y{}^2}$$ $$GMK_r = 1{,}4142 * GMK_x \quad = 1{,}4142 * GMK_y$$ Supozohet sikur gabimet sistematike janë eliminuar në mënyrën më të mirë të mundshme. Nëse gabimet janë të shpërndara në mënyrë normale dhe të pavarura në secilin komponent (x, z) një koeficient (faktor) 2,4477 përdoret për të llogaritur saktësinë horizontale me nivel besimi 95% (Greenwalt and Schultz 1968). Kur zbatohen kushtet e mësipërme, $GMK_X = GMK_Y$, vlera e saktësisë horizontale referuar NSSDA duhet të llogaritet nga formula: $$Saktësia_r = 2{,}4477 * GMK_X = 2{,}4477 * GMK_Y$$ $$Saktësia_r = 2{,}4477 * GMK_r/1{,}4142$$ $$Saktësia_r = 1{,}7308 * GMK_r$$
Fusha vlerësimit	tipi objektit gjeohapësinor/ seritë e grupit të të dhënave
Fusha raportimit	grupi i të dhënave / tipi i objekteve gjeohapësinor
Parametër	-
Cilësia e të dhënave të llojeve të vlerave	Matje
Cilësia e të dhënave të strukturës të vlerave	-
Burimi referencë	-

[2] Referuar Standardit Kombëtar për Raportimin e Saktësisë së të dhënave gjeohapësinore.

Shembull	-
Masa identifikuese	28

Rekomandim 29

Saktësia e jashtme apo absolute e komponentëve vertikal të objekteve vektor brenda grupeve të të dhënave vektor dhe brenda strukturës TIN dhe vlerave përbërëse të rangut të rrjetit të mbulimit të lartësive, duhet të vlerësohet dhe dokumentohet duke përdorur gabimin mesatar kuadratik siç specifikohet në tabelën më poshtë:

Emri	**Vlera mesatare e gabimit pozicional**
Emri alternativ	GMK
Cilësia e të dhënave të elementeve	Saktësia e pozicionimit
Cilësia e të dhënave të nënelementeve	Saktësia e jashtme apo absolute
Cilësia e të dhënave të matjeve themelore	Jo e aplikueshme
Përkufizim	Rrezja e rrethit rreth pikës së dhënë, në të cilën vlera e vërtetë gjendet me probabilitetin P
Përshkrim	Vlera e vërtetë e Z së matur njihet si z_t. Nga kjo, gmk: $GMK_z = \sqrt[2]{1/N \sum_{i=1}^{N} (Z_{mi} - z_t)^2)}$
Fusha vlerësimit	tipi i objektit gjeohapësinor: *Lartësia pikës, Izoipse, Vija thyerje, Zona pa info, Zona të kufizuara* grupi i të dhënave/ seritë e grupit të të dhënave
Fusha raportimit	tipi i objektit gjeohapësinor: *Lartësia pikës, Izoipse, Vija thyerje, Zona pa info, Zona të kufizuara* grupi i të dhënave/ seritë e grupit të të dhënave
Parametër	-
Cilësia e të dhënave të llojeve të vlerave	Matje
Cilësia e të dhënave të strukturës të vlerave	Vlerë e vetme
Burimi referencë	Cilësia e të dhënave- Informacioni gjeografik *SSH EN ISO 19157:2013*
Shembull	-
Masa identifikuese	39 (*SSH EN ISO 19157:2013)*

3.1.7.8 SAKTËSIA E POZICIONIMIT - SAKTËSIA E POZICIONIMIT TË TË DHËNAVE TË RRJETIT TË RREGULLT (GRIDDED DATA POSITION ACCURACY)

Ky specifikim përdor cilësinë e të dhënave të saktësisë së pozicionimit të të dhënave të rrjetit të rregullt, cilësinë e të dhënave të nën elementeve për të vlerësuar afërsinë e pozicionimit planimetrik të rrjetit të mbulimit të lartësisë (pozicionet direkte që përbëjnë domein-in e mbulimit) ndaj vlerave të pranuara ose që janë të vërteta.

Rekomandim 30

Saktësia e pozicionimit të të dhënave të rrjetit të mbulimit duhet të vlerësohet dhe dokumentohet duke përdorur Gabimin mesatar kuadratik të pozicionimit siç është specifikuar më poshtë:

Emri	**Vlera mesatare e gabimit pozicional**
Emri alternativ	RMSEP
Cilësia e të dhënave të elementeve	Saktësia e pozicionimit
Cilësia e të dhënave të nënelementeve	Saktësia e jashtme apo absolute
Cilësia e të dhënave të matjeve themelore	Jo e aplikueshme

Përkufizim	Rrezja e rrethit rreth pikës së dhënë, në të cilën vlera e vërtetë gjendet me probabilitetin P
Përshkrim	Saktësia horizontale $$GMK_X = \sqrt[2]{\sum (x_{Edhënë,i} - x_{Ekontrolluar,i})^2/n}$$ $$GMK_Y = \sqrt[2]{\sum (y_{Edhënë,i} - y_{Ekontrolluar,i})^2/n}$$ ku: $x_{Edhënë,i}$, $y_{Edhënë,i}$ – janë koordinatat horizontale e pikave të kontrolluara në grupin e të dhënave. $x_{Ekontrolluar,i}$, $y_{Ekontrolluar,i}$ – janë koordinatat e pikave të kontrolluara nga burime të pa varuara të një saktësie më të lartë n – është numri i pikave të testuara i - është numri përkatës i pikes. Gabimi horizontal i pikës përcaktohet nga: $GMK_r = \sqrt[2]{\sum ((x_{Edhënë,i} - x_{Ekontrolluar,i})^2 + (y_{Edhënë,i} - y_{Ekontrolluar,i})^2)/n}$ $$GMK_r = \sqrt{{GMK_x}^2 + {GMK_y}^2}$$ Nëse nga llogaritjet kemi $GMK_X = GMK_Y$, $$GMK_r = \sqrt{2 * {GMK_x}^2} = \sqrt{2 * {GMK_y}^2}$$ $$GMK_r = 1{,}4142 * GMK_x \quad = 1{,}4142 * GMK_y$$ Supozohet sikur gabimet sistematike janë eliminuar në mënyrën më të mirë të mundshme. Nëse gabimet janë të shpërndara në mënyrë normale dhe të pavarura në secilin komponent (x, z) një koeficient (faktor) 2,4477 përdoret për të llogaritur saktësinë horizontale me nivel besimi 95% (Greenwalt and Schultz 1968). Kur zbatohen kushtet e mësipërme, $GMK_X = GMK_Y$, vlera e saktësisë horizontale referuar NSSDA duhet të llogaritet nga formula: $$Saktësia_r = 2{,}4477 * GMK_X = 2{,}4477 * GMK_Y$$ $$Saktësia_r = 2{,}4477 * GMK_r/1{,}4142$$ $$Saktësia_r = 1{,}7308 * GMK_r$$
Fusha vlerësimit	objekti gjeohapësinor: *Rrjeti i mbulimit të lartësisë/* tipi i objektit gjeohapësinore: *Rrjeti i mbulimit të lartësisë* / grupi i të dhënave/ seritë e grupit të të dhënave
Fusha raportimit	objekti gjeohapësinor: *Rrjeti i mbulimit të lartësisë/* tipi i objektit gjeohapësinore: *Rrjeti i mbulimit të lartësisë* / grupi i të dhënave/ seritë e grupit të të dhënave
Parametër	-
Cilësia e të dhënave të llojeve të vlerave	Matje

Cilësia e të dhënave të strukturës të vlerave	Vlerë e vetme
Burimi referencë	Cilësia e të dhënave – Informacioni gjeografik *SSH EN ISO 19157:2013*
Shembull	-
Masa identifikuese	47 (*SSH EN ISO 19157:2013*)

4. ANEKSE

4.1 KATALOGU I TIPOLOGJIVE

Nr.	Emri i elementit Anglisht	Emri i elementit Shqip	Nëntema	Tipi
MODELI DIXHITAL I TERRENIT				
3.1.3.1	*Surface Type Value*	Vlerat e llojit të sipërfaqeve	Lartësitë Tipi Bazë	*Enumeration*
3.1.3.2	*Elevation PropertyTypeValue*	Vlerat e llojit të lartësisë së matur	Modeli dixhital i terrenit	*Enumeration*
3.1.6.1	*Elevation Grid Coverage*	Rrjeti i mbulimit i të dhënave të lartësive	Elementet Vektor të Lartësive	*FeatureType*
3.1.6.2	*Elevation Grid Coverage Aggregation*	Rrjeti i mbulimit shtesë i të dhënave të lartësive	Elementet vektor të lartësive	*DataType*
3.1.9.1	*Chart Datum*	Datumi i projektuar	Elementet Vektor të Lartësive	*DataType*
3.1.9.2	*Countur Line*	Izoipse	Elementet Vektor të Lartësive	*FeatureType*
3.1.9.3	*Spot Elevation*	Lartësia e pikës	Elementet Vektor të Lartësive	*FeatureType*
3.1.9.4	*Elevation Vector Objects*	Objektet vektor të lartësive	Elementet Vektor të Lartësive	*FeatureType*
3.1.9.5	*Break Line*	Vijat e thyerjes	Elementet Vektor të Lartësive	*FeatureType*
3.1.9.6	*Spot Elevation Class Value*	Vlerat e klasifikimit të lartësisë së pikës	Elementet Vektor të Lartësive	*Kodlistë*
3.1.9.7	*Spot Elevation Type Value*	Vlerat e llojeve të lartësisë së pikave	Elementet Vektor të Lartësive	*Kodlistë*
3.1.9.8	*Break Line Type Value*	Vlerat e llojeve të vijave të thyerjes	Elementet Vektor të Lartësive	*Kodlistë*
3.1.9.9	*VoidArea*	Zona pa informacion	Elementet Vektor të Lartësive	*FeatureType*
3.1.9.10	*Isolated Area*	Zonat e kufizuara	Elementet Vektor Të Lartësive	*FeatureType*
3.1.9.11	*Counturline Type Value*	Vlerat e llojit të izoipseve	Elementet Vektor Të Lartësive	*Enumeration*
3.1.12.1	*Elevation TIN*	Lartësitë Tin	ElevationTIN	*FeatureType*

4.2 MBLEDHJA E TË DHËNAVE – (DATA CAPTURE)

Në këtë aneks theksohen rastet të cilat kërkojnë një vëmendje të veçantë gjatë mbledhjes së të dhënave të formateve të ndryshme të kësaj teme. Referuar modelit të të dhënave të temës Modeli Dixhital i Terrenit, ky specifikim është i fokusuar më shumë në të dhënat: Rrjeti i Mbulimit, Elementet vektor dhe Formati TIN.

3.1.1 Mbulimi (Rrjeti i Rregullt)

Hapësira e Rrjetit të rregullt

Hapësira lineare (distanca) e rrjetit të një Modeli Dixhital të Terrenit (DEM) duhet të jetë në

përputhje me saktësinë vertikale të tij, e shprehur me GMKv (gabimi mesatar kuadratik të pozicionimit vertikal – RMSEv)

Lidhjet e rekomanduara ndërmjet hapësirës së rrjetit të DEM dhe GMK vertikal duhet të jenë si më poshtë:

- Hapësira e rrjetit jo më e madhe se (afërsisht) 20*GMKv dhe jo më e vogël se 3*GMKv, për terrene të sheshta dhe pak të pjerrëta.
- Hapësira e rrjetit jo më e madhe se (afërsisht) 10*GMKv dhe jo më e vogël se 3*GMKv, për të pjerrëta dhe malore.

Në mënyrë tabelore paraqiten:

Hapësira e rekomanduar e Rrjetit (Grid)	Lloji i terrenit
3*GMKv ≤ Hapësira e rrjetit ≤ 20*GMKv	Terren të sheshta dhe pak të pjerrëta
3*GMKv ≤ Hapësira e rrjetit ≤10*GMKv	Terrene të pjerrëta dhe malore

3.1.2 ELEMENTET VEKTOR

Rregullat e përgjithshme të dendësisë

Rekomandim 1

Përdorimi i Vijave të thyerjeve rekomandohet të bëhet sipas modelimit 2.5D për të pashkruar më mirë relievin. Nëse ky kusht nuk plotësohet, këto të dhëna mund të sigurohen edhe pa informacionin e lartësisë (Modeli 2D), meqë kjo është e lejuar në këtë specifikim.

Rekomandim 2

Izohipset nuk duhet të mbivendosen apo të kenë vetëndërprerje.

Rekomandim 3

- Të dhënat gjeohapësinore që përbëjnë izoipset duhet të kenë të njëjtën vlerë të lartësisë nëse janë referuar të njëjtit sisitem koordinativ referencë vertikal.
- Nëse vlera e lartësisë së vijave të thyerjes është e dhënë, atëherë vlera e lartësisë në pikën e ndërprerjes së dy vijave theyerjeje duhet të jetë e njëjtë.
- Nëse një vijë thyerje dhe një izoips janë mbështetur në të njëjtin sistem koordinativ referencë vertikal, atëherë pika e ndërprerjes duhet të ketë të njëjtën vlerë të lartësisë.
- Izoipset që kanë vlera të ndryshme lartësie duhet të mos ndërpriten me njëra tjetrën
- Vija kufitare e një zonë të kufizuar nuk duhet të prekë vijën kufitare të një zone pa informacion nëse ato janë i referuar të njëjtit sistemi koordinativ referencë vertikal.

Dendësia e të dhënave gjeohapësinore të lartësive

Lidhja ndërmjet izoipseve dhe shkallës së hartës duhet të mbahet në konsideratë për lloje të ndryshme terrenesh (sheshtë, pjerrët dhe malor). Në vijim baraslartësia e izoipseve, niveli i detajimit të të dhënave (Shkalla e hartës) dhe saktësia vertikave e të dhënave duhet të merret në konsideratë sipas tabelave të mëposhtme:

Për shkallën e Hartës 1:10 000 (1:5 000)	
1 m	Terrene të sheshta (me pjerrësi <2°) dhe pak të pjerrëta (2-6°)
2.5 m	Terrene të pjerrëta (6-12°)
5 m	Terrene malore (>12°)
Për shkallën e Hartës 1:25 000	
1 m	Terrene të sheshta (me pjerrësi <2°)
2.5 m	Terrene pak të pjerrëta (2-6°)
5 m	Terrene të pjerrëta (6-12°)
10 m	Terrene malore (>12°)
Për shkallën e Hartës 1:50 000	
2.5 m	Terrene të sheshta (me pjerrësi <2°)
5 m	Terrene pak të pjerrëta (2-6°)
10 m	Terrene të pjerrëta (6-12°)

20 m	Terrene malore (>12°)
Për shkallën e Hartës 1:100 000	
10 m	Terrene të sheshta (me pjerrësi <2°)
20 m	Terrene pak të pjerrëta (2-6°)
20 m	Terrene të pjerrëta (6-12°)
40 m	Terrene malore (>12°)
Për shkallën e Hartës 1:200 000	
20 m	Terrene të sheshta (me pjerrësi <2°)
20 m	Terrene pak të pjerrëta (2-6°)
40 m	Terrene të pjerrëta (6-12°)
40 m	Terrene malore (>12°)
Për shkallën e Hartës 1:500 000	
20 m	Terrene të sheshta (me pjerrësi <2°)
50 m	Terrene pak të pjerrëta (2-6°)
100 m	Terrene të pjerrëta (6-12°)
100 m	Terrene malore (>12°)

Saktësia vertikave GMKv	Lloji i terrenit
1/3 e baraslartësisë	Terrene të sheshta (<2°)
2/3 e baraslartësisë	Terrene pak të pjerrëta (2-6°)
Sa vlera e baraslartësisë	Terrene të pjerrëta (6-12°) dhe malore (mbi 12°)

3.1.3 LARTËSITË – TIN

Të dhënat vektor që formojnë modelet e formatit TIN duhet të përmbajnë rregullat dhe rekomandimet e të dhënave vektor.

4.3 KODI EPSG PËR KRGJSH

International Association of Oil and Gas Producers
EPSG geodetic parameters
data set version 8.5.4

Detailed Report on Projected Coordinate Reference Systems

Search Criteria: 6870

1 *Code:* 6870 *Name:* ETRS89 / Albania 2010

Albania alternative identifier: KRGJSH-2010

Base GeogCRS: ETRS89

Geodetic Datum: European Terrestrial Reference System 1989

Ellipsoid: GRS 1980

Semi-major axis (a) = 6378137 metre

Inverse flattening (1/f) = 298.257222101

Prime Meridian: Greenwich

Datum origin: Fixed to the stable part of the Eurasian continental plate and consistent with ITRS at the epoch 1989.0.

Datum remarks: The distinction in usage between ETRF89 and ETRS89 is confused: although in principle conceptually different in practice both are used for the realisation.

CRS scope: Large and medium scale topographic mapping, cadastral and engineering survey.

CRS remarks: Planimetric component of Albanian Geodetic Reference Framework (KRGJSH) 2010.

CS axes:

Order	Axis Name	Abbr	Axis Units	Orientation
1	Northing	X	metre	north
2	Easting	Y	metre	east

CS remarks: Used in projected and engineering coordinate reference systems.

Map Projection: Albania 2010

Projection Method: Transverse Mercator

Parameter Name	Parameter Value	Unit of Measure
Latitude of natural origin	0 ° 0 ' 0 " N	
Longitude of natural origin	20 ° 0 ' 0 " E	
Scale factor at natural origin	1	unity
False easting	500000	metre
False northing	0	metre

Projection remarks: Planimetric component of Albanian Geodetic Reference Framework (KRGJSH) 2010.

CRS info. source: State Authority for Geospatial Information (ASIG). *Data source:* OGP *Revision date:* 18-Sep-14 *Change id:* 2014.008 2014.065

CRS area of use: 3212 Albania - onshore.

EPSG geodesy parameters. Version: 8.5.4 of 18 September 2014 **Projected Coordinate Reference Systems (detailed)** Printed on: 28-Oct-14 Page 1 of 1

VENDIM
Nr. 400, datë 19.6.2019

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR MIGRACIONIN DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT 2019–2022

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe të planit të veprimit 2019–2022, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen të gjitha ministritë e linjës dhe institucionet qendrore, për të cilat në Strategji dhe në planin e veprimit janë përcaktuar detyra të veçanta, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

STRATEGJIA KOMBËTARE PËR MIGRACIONIN DHE PLANI I VEPRIMIT 2019–2022

TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e shkurtimeve
PJESA I. KONTEKSTI STRATEGJIK
1.1 Hyrja dhe qëllimi i strategjisë
1.2 Kuadri i politikave, kuadri ligjor dhe institucional, arritjet, sfidat dhe mësimet e nxjerra
PJESA II. VIZIONI, OBJEKTIVAT E POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË TË STRATEGJISË
PJESA III. OBJEKTIVAT SPECIFIKË TË STRATEGJISË DHE PRODUKTET KRYESORE
PJESA IV. BURIMET FINANCIARE
PJESA V. LLOGARIDHËNIA DHE MONITORIMI

Lista e shkurtimeve

ADISA	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara
AIDA	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve
AKD	Agjencia Kombëtare e Diasporës
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
AFP	Arsimi dhe Formimi Profesional
BSH	Banka e Shqipërisë
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DKM	Departamenti i Kufirit dhe i Migracionit
GNP	Grupi Ndërinstitucional i Punës
ISSH	Instituti i Sigurimeve Shoqërore
INSTAT	Instituti i Statistikave
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
IPMG	Grupi për Menaxhimin e Integruar të Politikave
KBR	Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal
KVA	Kthim vullnetar i asistuar
MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
MB	Ministria e Brendshme
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë

MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MFE	Ministria e Financave dhe e Ekonomisë
MGJSH	Matrica e IOM-it për Gjurmimin e Shpërnguljes (DTM)
MSHD	Ministri i Shtetit për Diasporën
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
MiGoF	Kuadri i Qeverisjes së Migracionit
MIK	Menaxhimi i Integruar i Kufirit
REH	Regjistri Elektronik i të Huajve
RCC	Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal i Evropës Juglindore (EJL)
SDG	Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SM	Sportel Migracioni
SHKP	Shërbimi Kombëtar i Punësimit
SHVT	Shtetas të Vendeve të Treta
UNHCR	Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët
VT	Viktima të Trafikimit

PJESA I
KONTEKSTI STRATEGJIK

1.1 Hyrje dhe qëllimi i strategjisë[3]

- Emigracioni nga Shqipëria

Shqipëria mbetet më së shumti vend emigracioni. Në vitin 2017, rreth 1.5 milionë shtetas shqiptarë ishin jashtë territorit të vendit, ose afro gjysma e popullsisë.[4] Një pjesë e madhe e komuniteteve të migrantëve ndodhen në vendet fqinje, në Itali (448 407) dhe në Greqi (356 848)[5], megjithatë me një tendencë në rritje në vendet e tjera të Bashkimit Evropian, si edhe në Amerikën e Veriut dhe në Kanada. Projeksionet e popullsisë tregojnë një tendencë afatgjatë drejt arritjes së bilancit neutral të migracionit.[6]

Emigracioni nga Shqipëria nxitet kryesisht nga arsye ekonomike (papunësia dhe përpjekja për kushte më të mira jetese), edhe pse në pah kanë dalë edhe konsiderata të tjera.[7] Dy kategori të popullatës, të rinjtë dhe gratë, e gjejnë veçanërisht të vështirë situatën në tregun e punës në vend. Në vitin 2017, të rinjtë e moshës 15–29 vjeç, të cilët nuk ishin të punësuar dhe nuk ndiqnin shkollën, arsimin e lartë apo formimin profesional, përbënin 29.7% të të gjithë të rinjve të vendit, ndërkohë që vetëm 50.3% e grave ishin të punësuara, krahasuar kjo me 64.3% të meshkujve.[8]

Emigracioni i shtetasve shqiptarë, në veçanti drejt vendeve të Bashkimit Evropian, vijon pavarësisht përmirësimit të vazhdueshëm të kushteve të jetesës në vend, të rritjes të qëndrueshme të ekonomisë shqiptare dhe të përmirësimit të vazhdueshëm të sigurisë publike.[9]

[3] Për një analizë të mëtejshme të tendencave migratore nga Shqipëria, përmes dhe drejt saj, mund t'i referoheni Profilit të Migracionit për Shqipërinë, 2017, një publikim i Ministrisë së Brendshme.

[4] Sipas INSTAT-it, popullsia mesatare në vitin 2017 ishte 2 873 457 banorë. Ndryshimi ndërmjet të dhënave të regjistruara në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile dhe popullsisë mesatare në vitin 2017 mund të vlerësohet indirekt si një tregues i numrit të shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit.

[5] Sipas UNDESA-s, numri i shtetasve shqiptarë në Greqi dhe Itali në vitin 2017 ishte përkatësisht 429 428 dhe 455 468.

[6] Në vitin 2021, numri i emigrantëve duhet të tejkalojë me 5 000 deri në 16 000 numrin e imigrantëve. Kjo duhet të ndiqet nga një ulje e shpejtë e numrit të emigrantëve, që çon në një bilanc pothuajse neutral të migracionit në vitin 2030. http://www.instat.gov.al/media/3075/projeksionet_e_populls is__2011-2031.pdf

[7] Përveç migrantëve për punë, kategoritë kryesore të emigrantëve nga Shqipëria përfshijnë anëtarët e familjes së migrantëve, ose personat që emigrojnë për t'u bashkuar me familjet e tyre jashtë vendit, studentët dhe azilkërkuesit e refugjatët.

[8] Të dhëna të marra nga Anketa e Forcave të Punës, INSTAT – Tregu i Punës 2017, faqe 2. http://www.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-pun%C3%ABs-dhe-arsimi/pun%C3%ABsimi-dhe-papun%C3%ABsia/publikimet/2018/njoftim-p%C3%ABr-media-tregu-i-pun%C3%ABs-2017/

[9] Sipas informacionit që jepet në Profilin e Migracionit të Shqipërisë, 2017, shkalla zyrtare e papunësisë për popullsinë 15 vjeç e lart ishte 13.7% dhe shënonte një ulje me 1.5 pikë përqindjeje krahasuar me vitin 2016.

Sipas INSTAT-it[10], katër janë faktorët kryesorë që aktualisht ndikojnë në emigracionin drejt BE-së: mundësia për të punuar jashtë vendit (84%), bashkimi familjar (4.6%), papunësia (4.2%) dhe mundësia për të studiuar jashtë vendit (3.5%). Faktorë të tjerë tërheqës janë gjithashtu, cilësia më e mirë e trajnimeve dhe mundësive për t'u arsimuar jashtë vendit. Nga ana tjetër, mangësitë e shërbimeve publike kanë shërbyer si "faktorë nxitës", duke ndikuar negativisht në përpjekjen dhe perspektivën e migrantëve për t'u kthyer dhe për t'u vendosur në Shqipëri.

Një kategori tjetër e shtetasve shqiptarë jashtë vendit janë personat të cilëve u është refuzuar kërkesa për azil ose që kanë qenë me qëndrim të parregullt në vendet e BE-së. Si një tendencë e kohëve të fundit vërehen kthime të konsiderueshme të këtyre personave në Shqipëri. Është vështirë të regjistrohen kthimet vullnetare në Shqipëri për shkak të natyrës së tyre. Statistikat në lidhje me kthimet jovullnetare tregojnë një rënie të kthimeve nga vendet e BE-së[11]. Shumica e kthimeve jovullnetare nga vendet e BE-së dhe vendet fqinje janë kryer përmes operacioneve të riatdhesimit (nga toka dhe ajri).[12] Për vitin 2017 vihet re një rritje e konsiderueshme e kthimit të të miturve të pashoqëruar. 452 të mitur janë ripranuar nga autoritetet kufitare në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror (SHSSH).

Tabela 1. Shtetas shqiptarë të kthyer sipas grup-moshës (2016-2017)

VITI	TOTAL	Meshkuj		Femra	
		mbi 18 vjeç	nën 18 vjeç	mbi 18 vjeç	nën 18 vjeç
2016	21681	18443	978	2259	222
2017	20632	18596	382	1620	34

Burimi: Profili i Migracionit 2017, Ministria e Brendshme, Republika e Shqipërisë

Ndikimi i lëvizjeve migratore të popullsisë shqiptare në zhvillimin socio-ekonomik të vendit ka qenë domethënës. Dërgesat "në para" të emigrantëve, të njohura ndryshe si remitanca, kanë ndihmuar për të kapërcyer varfërinë që shoqëroi për shumë vite rënien e regjimit komunist në Shqipëri dhe vazhdojnë të japin një kontribut të rëndësishëm në ekonominë e vendit. Edhe pse Shqipëria vazhdon të jetë shumë e varur nga remitancat, flukset hyrëse gradualisht kanë pësuar rënie gjatë krizës ekonomike në Evropën jugore nga 952 milionë euro në vitin 2007, në 547 milionë euro në vitin 2013. Që atëherë, nivelet e remitancave janë rikuperuar duke arritur 637 milionë euro në vitin 2017. Pritet që ato të pësojnë rritje të mëtejshme me kthimin e rritjes ekonomike në vendet pritëse, duke iu dhënë familjeve migrante dhe ekonomive lokale një burim financiar të jashtëzakonshëm dhe të pazëvendësueshëm.

[10] Të dhëna të marra nga Anketa e Fuqisë Punëtore, INSTAT, 2017

[11] Profili i Migracionit i Shqipërisë, 2017, Ministria e Brendshme

[12] Gjatë 2017, janë kryer 2243 operacione, nëpërmjet të cilave u kthyen 13497 shtetas shqiptarë, ndërsa në vitin 2016 u kryen 2253 operacione dhe u kthyen 16601 shtetas shqiptarë.

Figura 1. Dinamika e remitancave (2013-2017)



Burimi: Profili i Migracionit 2017, Ministria e Brendshme, Republika e Shqipërisë

- Imigracioni drejt dhe përmes Shqipërisë

Shqipëria po bëhet gjithnjë e më tepër një vend destinacioni për një sërë kategorish të huajsh, përfshirë migrantët në kërkim të punësimit, studentët, azilkërkuesit dhe refugjatët, megjithëse shifrat janë relativisht të ulëta.[13] Gjatë vitit 2017, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit ka dhënë gjithsej 1,705 leje pune për të huajt. Numri më i madh i lejeve të punës është lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Punësimit në Tiranë (651 leje pune). Vendet e origjinës në krye të listës me marrës të lejeve të punës në vitin 2017 përfshinin Turqinë (582 ose 34% të totalit të lejeve të punës të lëshuara), pasuar nga Kina (208 leje pune ose 12% e totalit) dhe Kolumbia (85 leje pune ose 6% e shifrës totale).[14] Nga 1,705 leje pune që u lëshuan gjithsej për vitin 2017, 245 ose 14% e tyre u janë dhënë grave dhe 1,142 kanë qenë aplikime që janë bërë për herë të parë.

Ashtu si vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, Shqipëria është prekur edhe nga flukset e përziera të popullatave, për arsye jo vetëm të kushteve socio-ekonomike, por edhe të konflikteve të ndryshme. Kategoritë e të huajve që mbërrijnë në Shqipëri, përfshijnë ndër të tjera refugjatë dhe azilkërkues, migrantë, viktima të trafikimit, të mitur të pashoqëruar dhe të ndarë, si edhe persona pa shtetësi. Disa prej tyre janë pjesë e më shumë se një kategorie të vetme. Ata janë me shtetësi të ndryshme. Shumica janë sirianë dhe afganë dhe shpesh hyjnë në vend në mënyrë të parregullt. Në shumicën e rasteve, këta individë janë në një situatë të veçantë vulnerabiliteti për shkak të situatës në vendet e tyre të origjinës prej të cilave janë larguar, për shkak të kushteve të vështira, ose të shfrytëzimit dhe abuzimit të pësuar gjatë udhëtimit[15]. Këto flukse kalojnë kryesisht transit në Shqipëri, përpara se të hyjnë në vendet e Bashkimit Evropian.

[13] Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani i saj i Veprimit (2019-2022) kanë në fokus kryesisht migrantët e rregullt dhe ata të parregullt, megjithatë ato marrin në konsideratë, aty ku është e mundur, edhe pozicionin e azilkërkuesve dhe refugjatëve.

[14] Shtetasit turq më së shumti janë punësuar në sektorin e ndërtimit, edukimit dhe shëndetësisë. Shtetasit kinezë janë punësuar në industrinë e nxjerrjes (miniera dhe gurore), ndërsa shtetasit kolumbianë në sektorin e ndërtimit në profesione si saldatorë, mekanikë, elektricistë dhe drejtues të makinerive të rënda për ndërtimin e tubacionit të gazit.

[15] Programi i Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm 2017-2021

Figura 2. Migrantë të parregullt të kapur në territorin e Shqipërisë (2009–2017)



Burimi: Profili i Migracionit 2017, Ministria e Brendshme, Republika e Shqipërisë

Një vlerësim i shpejtë[16] i kryer nga Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Shqipëri në vitin 2018, tregon një rritje të mprehtë të numrit të personave të ndaluar në zonat kufitare. 3,088 persona janë ndaluar në gjashtë muajt e parë të vitit 2018, krahasuar me 1049 në të 12 muajt e vitit 2017. Kjo rritje shoqërohet edhe me një rritje të numrit të kërkesave për azil, të cilat arritën shifrën 1,901 në gjysmën e parë të vitit 2018, nga 309 në vitin 2017.[17] Këto shifra janë në fakt më të larta se ato të regjistruara në vitin 2015 gjatë pikut të fluksit të migrantëve në mbarë Evropën. Bazuar në të dhënat e grumbulluara nga IOM-i për periudhën dhjetor 2015 deri në shkurt 2018, 297 persona janë përpjekur të kalojnë kufijtë shqiptarë më shumë se një herë (përsëritës). Rritja e kërkesave për azil ka të ngjarë të vazhdojë. Skenari më optimist i ndërtuar nga ky studim në bazë të analizës së rritjes së hyrjeve dhe larmishmërisë së origjinës të këtyre hyrjeve, parashikon se numri i kërkesave për azil do të arrijë në 3,000 në vitin 2019 për 6,000 hyrje gjithsej, ndërsa skenari pesimist parashikon 7,500 kërkesa për azil për 13,000 hyrje gjithsej.

Lidhur me vendet e origjinës, në periudhën janar–nëntor 2018, 45.3% e të ndaluarve deklarojnë se janë nga Siria (24561 prej të cilëve 2037 kërkesa për azil) të ndjekur nga shtetas nga Pakistani (824, prej të cilave 623 kërkesa për azil), Iraku (533 prej të cilave 407 kërkesa për azil), Algjeria, Libia, Maroku, Afganistani, Jemeni dhe Irani në numra më të pakët. Këto shifra tregojnë se fluksi i personave që arrijnë në Shqipëri në mënyrë të parregullt konsiston kryesisht në persona, të cilët mund të konsiderohen nga vende që "prodhojnë" refugjatë dhe azilkërkues.

Një grup veçanërisht vulnerabël janë të miturit e pashoqëruar. 322 fëmijë janë ndaluar në gjysmën e parë të vitit 2018[18]. Ndërsa, gratë dhe fëmijët përbëjnë pakicën, por është vënë re një rritje në këtë kategori sidomos nga marsi deri në maj 2018 (figura 3). Shumica e grave dhe fëmijëve kanë qenë shtetas sirianë që kanë kërkuar azil.

[16] Vlerësim i përbashkët për azilin dhe migracionin e përzierë, Situata në Shqipëri 2018: Vlerësim i Shpejtë Fillestar, korrik 2018

[17] Këto janë të dhënat e UNHCR-së për azilin në migracion të përzierë; janar–qershor 2018.

[18] Prej të cilëve 272 fëmijë u referuan për azil.

Figura 3



Ndalimet për herë të parë janë përqendruar gjeografikisht. Nga janari deri në prill 2018, 74% e ndalimeve[19] për herë të parë (në vijim ndalime) janë raportuar në kufirin jugor, më saktësisht në pikën kufitare të Kakavijës. Përveç kësaj, 305 persona janë kapur duke dalë nga vendi (në drejtim të Malit të Zi, në zonën e Shkodrës) në periudhën tremujore nga marsi deri në maj 2018.[20] Kjo mund të lidhet me krijimin e një rrugë të re për kontrabandimin e qenieve njerëzore nga Greqia nëpërmjet Shqipërisë, Malit të Zi dhe Bosnjës në Kroaci dhe në Evropën perëndimore.[21] Për më tepër, ndalimet në territor janë rritur gjatë vitit 2018. Pavarësisht skenarëve të lartpërmendur, aktorët e përfshirë në ofrimin e ndihmës, shërbimeve dhe mbrojtjes do të duhet të rivlerësojnë nevojat, prioritetet dhe procedurat ekzistuese. Një ndryshim i tillë do të ketë pasojat e veta në parashikimet buxhetore të strukturave shtetërore, të agjencive të OKB-së dhe të OJQ-ve të përfshira në ofrimin e asistencës.

- Domosdoshmëria e strategjisë ndërsektoriale për migracionin

Maksimizimi i përfitimeve të migracionit për migrantët dhe shoqëritë, kërkon një qasje ndërsektoriale ndaj qeverisjes së migracionit për të trajtuar sfidat që lidhen me lëvizjet e përziera (migracioni i parregullt, azilkërkuesit dhe refugjatët, të miturit e pashoqëruar etj.) dhe për të rritur sa më shumë që të jetë e mundur ndikimin e migracionit në zhvillimin e vendit përmes investimeve, zhvillimit njerëzor, inovacionit etj. Axhenda 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm e ka konfirmuar migracionin si një prioritet të rëndësishëm global, i cili, nëse qeveriset siç duhet, mund të sjellë përfitime pozitive për migrantët dhe familjet e tyre, shoqëritë pritëse dhe dërguese dhe vendet në përgjithësi.

Për më tepër, formulimi i një Marrëveshjeje Globale mbi Migracionin (GCM) në korrik 2018 ishte një tregues i qartë i qasjes gjithëpërfshirëse dhe përpjekjeve të përbashkëta në nivel global për të qeverisur më mirë migracionin.[22] Ajo që pritet nga GCM-ja është që të sigurojë një kornizë unifikuese të parimeve të përbashkëta, të angazhimeve dhe të mirëkuptimeve midis Shteteve Anëtare për të gjitha aspektet e migracionit ndërkombëtar, duke përfshirë dimensionet humanitare, të zhvillimit dhe të të drejtave të njeriut dhe duke përmirësuar gjithashtu bashkëpunimin ndërkombëtar për migracionin. Shqipëria është një nga vendet që ka vendosur Axhendën 2030 si pjesë të prioriteteve të veta kombëtare, si edhe ka mirëpritur Marrëveshjen Globale mbi Migracionin dhe objektivat e saj. Vendimi i Qeverisë Shqiptare për të rinovuar strategjinë ndërsektoriale për migracionin paraqet një hap të rëndësishëm në realizimin e angazhimeve ndërkombëtare të Shqipërisë në fushën e migracionit. Për më tepër, Strategjia kontribuon në realizimin me sukses të nëntë prej Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.[23]

[19] Shifrat e raportuara në këtë dokument për ndalimet janë ndalime për herë të parë. Kështu personat që janë ndaluar një herë në Shqipëri dhe më pas janë ndaluar në një pikë tjetër të kalimit kufitar, numërohen vetëm një herë.

[20] Matrica e IOM-it për Gjurmimin e Shpërnguljes (DTM), përmbledhje e të dhënave dhe informacionit në dispozicion, maj 2018

[21] http://bih.iom.int/pbn/bosnian-police-prevent-hundreds-migrants-entering-croatia-reuters

[22] Shqipëria adoptoi Marrëveshjen Globale për Migracionin gjatë Konferencës Ndërqeveritare të mbajtur në Marakesh, Marok në datat 10 dhe 11 dhjetor 2018.

[23] Këta objektiva përfshijnë: Objektivi 1 – Kundër varfërisë, meqenëse një sërë masash do të kontribuojnë në reduktimin e varfërisë në rajonet e origjinës të migrantëve;

Një stimul tjetër drejt miratimit të një qasjeje të integruar për menaxhimin e migracionit është procesi i integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Për të përfunduar me sukses negociatat për kapitullin 24 (Drejtësia, liria dhe siguria) të *Acquis* të BE-së, i cili përcakton qeverisjen e migracionit si një çështje thelbësore, Shqipëria duhet të formulojë një strategji ndërsektoriale të migracionit. Kjo kërkesë është theksuar gjithashtu në Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2018.[24]

Avantazhet e zhvillimit të politikës koherente të qeverisjes së migracionit që do të udhëheqë të gjitha masat programuese në fushën e migracionit janë pranuar tashmë nga Qeveria e Shqipërisë. Aktualisht vërehet ekzistenca e një larmie dokumentesh strategjike, që përfshijnë disa aspekte kryesore të qeverisjes së migracionit. Që prej vitit 2004 janë miratuar disa dokumente strategjike të politikave për migracionin, duke filluar me miratimin e Strategjisë së parë Kombëtare për Migracionin dhe Planin e Veprimit (2005–2010), e cila u pasua nga Plani i Veprimit për Dërgesat në Para të Emigrantëve (2007–2010)[25], Strategjia për Kthimin dhe Riintegrimin e Shtetasve Shqiptarë (2010–2015), si edhe Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe të Fëmijëve (2014–2017). Dokumentet më të fundit strategjikë përfshijnë Strategjinë për Punësimin dhe Aftësitë (2014–2020), Strategjinë për Menaxhimin e Integruar të Kufirit Shtetëror (2016–2020), Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale dhe Përfshirjen Sociale (2015–2020), Strategjinë për Bujqësisë dhe Zhvillimin Rural (2014–2020), Strategjinë për Biznesin dhe Investimet (2014–2020), Strategjinë për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (2014–2017) dhe së fundmi Strategjia Kombëtare për Diasporën (2018–2024) dhe Plani i saj i Veprimit. Një hap i rëndësishëm drejt arritjes së një politike gjithëpërfshirëse të qeverisjes së migracionit ishte miratimi i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2016–2020. Në përputhje me vizionin strategjik të SKZHI-së, "*për të krijuar një sistem efektiv të qeverisjes të migracionit në Shqipëri*", Kryeministri ngriti një Grup Pune Ndërinstitucional.[26] Ky grup ka draftuar Strategjinë e re për Migracionin për Shqipërinë 2019–2022, e cila paraqitet në këtë dokument strategjik dhe planin e saj të veprimit.

Procesi i hartimit të strategjisë u mbështet nga Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM). Strategjia dhe Plani i Veprimit udhëhiqen nga Kuadri Ndërkombëtar për Qeverisjen e Migracionit (ndryshe i njohur si MiGoF), i cili u prezantua dhe u mirëprit nga të gjitha Shtetet Anëtare të IOM-it, përfshirë Shqipërinë, në nëntor 2015. Ky kuadër përcakton elementet thelbësore për të mbështetur migracionin e planifikuar dhe të mirëmenaxhuar. Si i tillë, është dokumenti i parë dhe i vetëm ndërkombëtar i dakordësuar, i cili përshkruan se si mirëqeveriset migracioni në mënyrë koherente dhe gjithëpërfshirëse. Me rëndësi është që MiGoF vepron si pikë referimi për qeveritë në zhvillimin dhe vlerësimin e "politikave të mirëmenaxhuara

Objektivi 3 – Shëndeti i Mirë dhe Mirëqenia, meqenëse strategjia merr në konsideratë shëndetin dhe mirëqenien e migrantëve, si një parakusht për zhvillimin social dhe ekonomik; Objektivi 4 – Edukimi Cilësor, meqenëse strategjia inkurajon edukimin e fëmijëve të migrantëve si një masë për të nxitur integrimin e tyre socio-ekonomik dhe për të përmirësuar mundësitë e jetesës si të rritur; Objektivi 5 – Barazia Gjinore, meqenëse strategjia e konsideron migracionin burim fuqizimi për migrantët (përfshirë këtu edhe gratë dhe vajzat), duke trajtuar po ashtu edhe çështjet e vulnerabilitetit për shkak të dhunës dhe të shfrytëzimit; Objektivi 8 – Puna e Denjë dhe Rritja Ekonomike, meqenëse strategjia promovon punësimin e denjë dhe ambientin e sigurt për migrantët; Objektivi 9 - Industria, Novacioni dhe Infrastruktura, meqenëse strategjia promovon transferimin e njohurive dhe të aftësive të migrantëve për të mbështetur novacionin dhe rritjen ekonomike të vendit; Objektivi 10 – Zvogëlimi i pabarazive, meqenëse objektivi kryesor i strategjisë është të qeverisë migracionin për të siguruar një migracion të sigurt dhe të rregullt; Objektivi 16 - Paqe, Drejtësi dhe Institucione të Forta, meqenëse strategjia promovon aksesin e migrantëve në drejtësi dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre; Objektivi 17 – Partneritete për objektivat, meqenëse strategjia i kushton vëmendje të veçantë mbledhjes, analizimit dhe ndarjes së të dhënave të sigurta të migracionit që ndihmojnë politikëbërësit në hartimin e politikave dhe planeve që bazohen në fakte dhe që trajtojnë aspektet migratore të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

[24] Seksioni "Migracioni i rregullt dhe i parregullt" f. 37.

[25] Në vitin 2017, Banka e Shqipërisë dhe Ministri i Shtetit për Diasporën nënshkruan një marrëveshje mirëkuptimi për bashkëpunim dhe bashkërendim institucional në fushën e remitancave dhe për përdorimin e tyre produktiv.

[26] Urdhër nr. 54, datë 1.3.2018

të migracionit", sipas treguesit 10.7.2 të Objektivit të Zhvillimit të Qëndrueshëm Global (SDG). Për të lehtësuar procesin e formulimit të strategjisë të re për migracionin në vend, Qeveria e Shqipërisë në fillim të vitit 2018 mori pjesë në procesin e vlerësimit të Treguesve të Qeverisjes së Migracionit (MGI), të realizuar nga IOM-i në bashkëpunim me Njësinë e Inteligjencës Ekonomike (EIU), proces i cili ofroi njohuri për fushat e politikave ku Shqipëria mund të veprojë për të forcuar qeverisjen e migracionit.[27] Strategjia nuk mbulon në mënyrë të plotë çështjet e refugjatëve, viktimave të trafikimit, menaxhimin e integruar të kufirit, diasporës etj., për shkak se këto të fundit mbulohen nga dokumente të tjera politike specifike, duke shmangur në këtë mënyrë mbivendosjet.

Draft Strategjia dhe Plani i Veprimit u ndanë dhe ishin objekt diskutimi intensiv me aktorë të ndryshëm të përfshirë në çështjet migratore, përfshirë përfaqësuesit e shoqërisë civile, sektorit privat, të akademisë dhe partnerët ndërkombëtarë përpara finalizimit të tyre.

Të dy dokumentet bazohen në përkufizimet ligjore të përcaktuara në legjislacionin shqiptar, si p.sh. në ligjin për të huajt, ligjin për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi, ligjin për azilin, ligjin për mbrojtjen e fëmijëve etj., dhe në dokumente të tjera politike.

Ky dokument organizohet në pesë kapituj. Kapitulli I prezanton kontekstin dhe qëllimin e strategjisë si edhe kuadrin politik, ligjor dhe atë administrativ së bashku me mësimet e nxjerra. Kapitulli II prezanton vizionin, synimet dhe objektivat specifikë të Strategjisë, kurse kapitulli III paraqet produktet kryesore për secilin objektiv strategjik. Kapitulli IV ofron informacion mbi burimet financiare të vëna në dispozicion për zbatimin e masave të planit të veprimit, si edhe burimet e tjera financiare që kërkohen. Dokumenti mbyllet me kapitullin V, i cili parashikon mekanizmin e koordinimit institucional dhe atë të monitorimit për zbatimin e strategjisë dhe të planit të veprimit.

1.2 Kuadri i politikave, kuadri ligjor dhe institucional, arritjet, sfidat dhe mësimet e nxjerra

Nga institucionet e Qeverisë Shqiptare janë identifikuar katër sfera si komponentë të një politike gjithëpërfshirëse të qeverisjes së migracionit bazuar në MiGoF:

- Qeverisja strategjike e migracionit nga institucionet shqiptare;
- Migracioni i sigurt dhe i rregullt nga, përmes dhe drejt Shqipërisë;
- Politikat e efektshme të migracionit për motive punësimi dhe ndikimi i migracionit në zhvillimin lokal;
- Integrimi i migrantëve dhe mbrojtja e të drejtave të tyre.

SFERA 1. Qeverisja strategjike e migracionit nga institucionet shqiptare

Fushat e mëposhtme janë çelësi për të siguruar qeverisjen strategjike të migracionit:

[27] Që nga prezantimi i saj, 29 shtete kanë përdorur MGI-në për të vlerësuar strukturat e tyre të qeverisjes së migracionit dhe për të informuar në lidhje me hartimin dhe zhvillimin e politikave të tyre të migracionit. Gjithashtu, qëllimi i MGI-së është që të ndihmojë në avancimin e dialogut për qeverisjen e migracionit në nivel shtetëror, rajonal dhe global duke nënvizuar veçoritë e "migracionit të mirëqeverisur" në kuadër të zbatimit të objektivit 10.7 të SDG. Shqipëria i është përgjigjur pozitivisht kërkesës duke u bërë pjesë e procesit të vlerësimit MGI. Për këtë arsye, ajo ka marrë angazhimin që të realizojë objektivat në lidhje me migracionin sipas Axhendës 2030.



- Kuadër gjithëpërfshirës ligjor dhe institucional për qeverisjen e migracionit

- Përafrimi i kuadrit ligjor kombëtar me atë të BE-së dhe standardet ndërkombëtare

Shtysa drejt përmirësimit të vazhdueshëm të kuadrit të politikave migratore në vend përgjatë dekadës e fundit është dhënë nga procesi i integrimit në BE dhe miratimi paralelisht i normave ndërkombëtare në këtë fushë. Mekanizmat e përafrimit ligjor dhe monitorimit të zbatimit të legjislacionit kanë qenë të efektshme, sepse kanë sjellë nivele më të larta të kohezionit në kuadrin ligjor dhe institucional kombëtar në fushën e migracionit. Ndryshimet kryesore legjislative paraqesin disa nga momentet kryesore në këtë drejtim, ku ia vlen të përmenden: miratimi i ligjit nr. 9668/2006 (i ndryshuar) për Emigrimin e Shtetasve Shqiptarë për Motive Punësimi, si edhe dy urdhrat e ministrit të Punës, Mirëqenies Sociale dhe Shanseve të Barabarta, urdhri nr. 1772/2007 për formatin, përmbajtjen dhe procedurën e marrjes së statusit të emigrantit dhe urdhri nr. 2086/2007 për formatin dhe përmbajtjen e Regjistrit të Emigrantëve dhe procedurat e regjistrimit; udhëzimi i Ministrisë së Arsimit Sporteve dhe Rinisë nr. 44, datë 21.8.2013 për përcaktimin e kritereve dhe procedurave të njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit, i ndryshuar me udhëzimin nr. 14, datë 10.5.2017; miratimi i ligjit nr. 108/2013 për të huajt (i ndryshuar), ligji nr. 121/2014 për Azilin në Republikën e Shqipërisë; udhëzimi nr. 293/2015 i ministrit të Brendshëm për procedurat e trajtimit të të huajve me qëndrim të parregullt në Shqipëri; urdhri nr. 1146/2014 i Ministrit të Brendshëm për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin nr. 851/2009 për miratimin e Procedurave Standarde të Punës për Kufirin dhe Migracionin; miratimi i ligjit nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", fusha e zbatimit të të cilit përshin fëmijët me shtetësi shqiptare, por edhe ata pa shtetësi ose me shtetësi të huaj, të cilët ndodhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë; miratimi i ligjit nr. 14/2016 "Për identifikimin dhe regjistrimin e adresave të shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë" dhe ligjit nr. 16/2018 "Për diasporën".

Legjislacioni i lartpërmendur ofron një kornizë të qëndrueshme ligjore që siguron jo vetëm mbrojtjen e shtetasve shqiptarë jashtë vendit, por edhe mbrojtjen e imigrantëve në Shqipëri. Megjithatë, një mësim i nxjerrë në procesin e përmirësimit të kuadrit ligjor është që rishikimi i rregullt i ndikimit të akteve kryesore ligjore në qeverisjen e migracionit është shumë i rëndësishëm për të identifikuar nevojën për të ndërmarrë ndryshime ligjore që do të rrisnin efektivitetin e masave ligjore. Për më tepër, duhet të ndërmerret një analizë e marrëveshjeve ndërshtetërore për t'u siguruar që në kuadër të këtyre marrëveshjeve nuk kthehen në Shqipëri të mitur të pashoqëruar dhe viktima të mundshme të trafikimit.

Përafrimi i legjislacionit të migracionit me *Acquis* të BE-së dhe konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria vazhdon. Ndërkohë që, Shqipëria ka një nivel shumë të lartë të ratifikimit të konventave ndërkombëtare[28] në fushën e

[28] Kjo ishte një nga gjetjet e analizës vlerësuese bazuar mbi treguesit e qeverisjes së migracionit, të cilën Shqipëria e ndërmori në pranverën e vitit 2018. Shqipëria ka ratifikuar Konventat e mëposhtme në fushën e migracionit: Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të të gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjes së Tyre (ICRMË)- 2007; Konventa në lidhje me statusin e refugjatit, 1992; Konventa për të drejtat e fëmijës (CRC), 1992; Konventa e ILO-s për Migracionin për Punësim (e rishikuar), 1949 (nr.97), 2005; Konventa e ILO-s për Punëtorët Migrantë (Dispozita Plotësuese), 1975 (nr.143), 2006; Konventa për Pashtetësinë, 2003; Konventa Evropiane për Statusin Ligjor të Punëtorëve Migrantë, 2007; Konventa Evropiane për Pjesëmarrjen e të Huajve në Jetën Publike në Nivel Vendor, 2005

migracionit, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet shkallës së tyre të zbatimit dhe ndikimit që ato kanë në të drejtat e migrantëve. Për më tepër, në disa raste vërehet mungesë koherence në terminologjinë e migracionit si në legjislacionin shqiptar, ashtu edhe në dokumentet e politikave.

- Kapacitete të forta institucionale dhe koordinim për qeverisjen e migracionit

Dokumentet strategjike për qeverisjen e migracionit të miratuara deri më tani kanë treguar rëndësinë që ka forcimi i kapaciteteve institucionale për menaxhimin efektiv të migracionit. Disa nga arritjet më thelbësore ndër vite në këtë aspekt përfshijnë riorganizimin institucional, reformën e plotë të policisë kufitare dhe të migracionit, si edhe krijimin e Sporteleve të Migracionit në zyrat rajonale dhe lokale të punësimit që ofrojnë shërbime për tri kategori migrantësh (migrantët e ardhshëm, të kthyerit, dhe imigrantët). Një sërë zhvillimesh të tjera përfshijnë përgatitjen e marrëveshjeve dhe procedurave standarde si Procedurat për Trajtimin e Migrantëve të Parregullt (në kufi dhe në brendësi të territorit), Marrëveshjen për Funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit për Viktimat e Trafikimit dhe Viktimat e mundshme të trafikimit (2012), Procedurat Standarde për Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit dhe Viktimat e mundshme të Trafikimit (2018), si edhe hartimin e një vendimi të Këshillit të Ministrave për rregullat dhe procedurat e kthimit dhe të riatdhesimit të fëmijës së pashoqëruar në zbatim të ligjit nr. 18/2017 për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, i cili pritet të miratohet së shpejti.

Mësimet e nxjerra nga përpjekjet e kaluara tregojnë nevojën për forcimin e mëtejshëm të angazhimit institucional në qeverisjen e migracionit, e cila mund të arrihet përmes të mësuarit në vazhdimësi, ndarjes së praktikave më të mira, përfshirjes aktive në hartimin dhe zbatimin e politikave të migracionit dhe programeve zbatuese, masave programuese, përmirësimit të kuadrit ligjor në fushën e migracionit, pjesëmarrjes të rregullt në forumet ndërkombëtare në fushën e migracionit dhe monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm të progresit të arritur. Një faktor kyç në rritjen e pronësinë institucionale mbi qeverisjen e migracionit është përcaktimi i qartë i roleve dhe i përgjegjësive të institucioneve për qeverisjen e migracionit në nivel qendror po aq sa edhe në nivel vendor.

Ndër arritjet e deritanishme në këtë fushë përmenden ndarja e qartë e kompetencave mes një sërë Ministrish përgjegjëse për menaxhimin e aspekteve të ndryshme të qeverisjes së migracionit (si Ministria e Brendshme, ministri i Shtetit për Diasporën, Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, si edhe institucionet e varësisë).[29] Sidoqoftë, lipset të sqarohet mënyra se si do të zbatohen politikat dhe masat për migracionin pas ndryshimeve institucionale të bëra në shtator 2017, të cilat rezultuan në shkrirjen e disa ministrive dhe zgjerimit të portofolit për disa ministri të tjera.[30] Për shembull, është e nevojshme të qartësohen rolet, përgjegjësitë dhe pritshmëritë midis qeverisjes qendrore dhe vendore në lidhje me ndihmën për të miturit e pashoqëruar. Për më tepër, për migracionin duhet të formalizohen detyrat e agjencive vartëse në ministri specifike (siç janë Sportelet e Migracionit pranë Shërbimit Kombëtar të

[29] Ministria e Brendshme përmes disa strukturave si Drejtoria e Antitrafikimit dhe Migracionit, Policia e Shtetit (Departamenti i Kufirit dhe Migracionit), Drejtoria për Azilin, etj. është autoriteti kryesor përgjegjës për mbikëqyrjen e kontrollit kufitar, menaxhimin e imigracionit, integrimin e të huajve, si edhe për koordinimin e përpjekjeve kundër trafikimit të qenieve njerëzore në nivel kombëtar dhe lokal dhe me të gjitha palët e interesuara. Ministri i Shtetit për Diasporën është përgjegjës për hartimin dhe monitorimin e zbatimit të politikës për Diasporën në koordinim me ministritë e tjera të linjës; Ministria e Financave dhe e Ekonomisë është përgjegjëse për qeverisjen e migracionit për motive punësimi në vend në bashkëpunim me ministri të tjera (si krijimin dhe zbatimin e skemave të migracionit për motive punësimi, apo negocimin dhe zbatimin e marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe për punësim). Ajo gjithashtu monitoron funksionimin e agjencive të rekrutimit për të siguruar rekrutimin etik të punëtorëve migrantë, mbikëqyr punën e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, si edhe të Sporteleve të Migracionit. Ministria e Shëndetit dhe e Mbrojtjes Sociale mbikëqyr punën e Shërbimit Social Shtetëror që ofron shërbime thelbësore për kategoritë vulnerabël të popullsisë, përfshirë migrantët, si Viktimat e Trafikimit dhe të miturit e pashoqëruar. Instituti i Statistikave është përgjegjës për mbledhjen, analizimin dhe ndarjen e të dhënave administrative, si edhe për të dhënat kërkimore për migracionin.

[30] Raporti Vjetor i Komisionit Evropian për Shqipërinë, 2018.

Punësimit), si dhe për forcimin e kapaciteteve institucionale për të kryer detyrat që lidhen me migracionin (adresimin e lëvizjes së stafit, mungesën e fondeve, nevojën për njohuri dhe trajnimin në vendin e punës).

Një faktor tjetër kyç për rritjen e pronësisë institucionale është koordinimi ose bashkërendimi i mirë institucional në nivel qendror dhe vendor për zbatimin e politikave të migracionit. Si pjesë e zbatimit të Strategjisë së parë për Migracionin, u ngrit një Komitet Ndërministror për Migracionin, si një organ këshillimor i Këshillit të Ministrave, i kryesuar nga Zëvendës Kryeministri[31] megjithatë, ky Komitet u mblodh vetëm një herë. Në vitin 2007 u krijua një organ tjetër për të lehtësuar koordinimin ndërministror, i njohur si Komiteti Teknik për Migracionin.[32] Kryesuar nga ish Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, ky Komiteti ishte përgjegjës për koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare mbi Migracionin dhe Planin përkatës të Veprimit (2004–2008). Ai përbëhej nga përfaqësues të të gjitha Ministrive dhe institucioneve të përfshira në zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Migracionin. Komiteti u ndihmua nga Drejtoria e Migracionit në ish Ministrinë e Punës që veproi si sekretariat. Krijimi i këtij organi koordinues përshpejtoi zbatimin e dokumenteve të politikave dhe raportimin. Mund të arrihet në përfundimin se mungesa e një mekanizmi koordinimi të nivelit të lartë për qeverisjen e migracionit ka kufizuar aftësinë e qeverisë shqiptare për të trajtuar çështjet e lidhura me migracionin nga një qasje gjithëpërfshirëse dhe për të dhënë orientime strategjike në të gjitha sfidat e ardhshme në lidhje me migracionin. Sidoqoftë, në nivelet e larta vendimmarrëse të qeverisë shqiptare, sot është duke vijuar puna për krijimin e një grupi pune tematik mbi migracionin, i cili do të koordinojë punën e të gjitha Ministrive në këtë fushë në nivelin strategjik dhe atë teknik, duke lehtësuar kështu raportimin dhe monitorimin e progresit në përmbushje të kërkesave për anëtarësim në BE.

Gjithashtu, nevojitet një njohje më e thelluar e rolit të strukturave të pushtetit vendor për zbatimin e politikave dhe të legjislacionit migrator, si edhe në ofrimin e shërbimeve ndaj kategorive të ndryshme të migrantëve, për të përcaktuar më pas mekanizma më të efektshme koordinimi mes pushtetit vendor dhe atij qendror për çështje që lidhen me menaxhimin e migracionit.

Një tjetër parakusht themelor për zbatimin e parashikimeve të një dokumenti strategjik është sigurimi i fondeve të mjaftueshme që përputhen me prioritetet e tij. Ky aspekt ka qenë një sfidë në lidhje me zbatimin e Planit të parë të Veprimit për Migracionin dhe Strategjinë e Riintegrimit. Megjithatë, zbatimi i këtyre dokumenteve strategjike të politikave (si edhe të tjerave) tregoi potencialin e madh të partneritetit me sektorin privat dhe organizatat e shoqërisë civile për të mbështetur zbatimin e politikave, si dhe për të siguruar financim nga donatorët.

- Mbledhja, analizimi dhe ndarja e efektshme e të dhënave për migracionin

Mbledhja, analizimi dhe shpërndarja e të dhënave për migracionin ka qenë në qendër të hartimit dhe monitorimit të politikave efektive mbi migracionin. Sidoqoftë, edhe në këtë drejtim janë hasur sfida, në veçanti me cilësinë e dobët të të dhënave. Kjo ka ardhur si pasojë e mungesës së standardizimit në mbledhjen e të dhënave administrative, si edhe nga numri i vogël i studimeve kërkimore për migracionin, të cilat do t'ua bënin të mundur vendimmarrësve vlerësimin e ndikimit të flukseve migratore dhe arritjen në parashikime të besueshme. Mësimet e nxjerra nga zbatimi i strategjive të mëparshme dhe aktuale të migracionit theksojnë nevojën për përmirësimin e mbledhjes së të dhënave administrative, si edhe zgjerimin e qëllimit të mbledhjes së të dhënave. Për më tepër, është e nevojshme ndërmarrja e hulumtimeve dhe e analizave të thella mbi ndikimin e migracionit në veçanti në tregun e punës të Shqipërisë si edhe në rritjen apo zvogëlimin e popullsisë.

Gjenerimi, analizimi dhe ndarja e të dhënave është vështirësuar edhe për shkak të fondeve të pamjaftueshme dhe kapaciteteve të kufizuara të institucioneve qendrore dhe vendore përgjegjëse në këtë drejtim. Këto mangësi janë trajtuar pjesërisht përmes përmirësimit të bashkëpunimit ndërinstitucional për mbledhjen dhe analizimin e

[31] Urdhër i Kryeministrit nr. 115, 11 maj 2006

[32] Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 425, 11.7.2007

të dhënave me krijimin e një Grupi Pune Ndërinstitucional, i cili prej disa vitesh përgatit Profilin Vjetor të Migracionit për Shqipërinë, sipas parashikimeve të ligjit për të huajt. Sidoqoftë, ka nevojë për përpjekje të vazhduara në përmirësimin e kapaciteteve të institucioneve shqiptare për ndërmarrjen e shkëmbimit të rregullt të të dhënave me autoritetet përkatëse në vendet e destinacionit, që përfshijnë por nuk kufizohen në institucione të tilla si Zyra e Statistikës, autoritetet e kufirit etj.

Aktorët e shoqërisë civile dhe të botës akademike mund të kontribuojnë më tej në përpjekjet për të përmirësuar mbledhjen e të dhënave, analizën dhe ndarjen e tyre dhe kështu të ndihmojnë në përmirësimin e shërbimeve publike që u ofrohen migrantëve duke i informuar vazhdimisht të gjithë aktorët e përfshirë për rezultatet e kërkimeve apo studimeve të kryera në fushën e migracionit dhe për profilin e kategorive të ndryshme të migrantëve të asistuar prej tyre, në ato raste kur kjo gjë është e mundur.

- Partneritete të forta për qeverisjen e migracionit

Politikat e duhura dhe të qëndrueshme për migracionin zhvillohen në partneritet me një larmi palësh të interesuara, si në nivel kombëtar, ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Në nivel kombëtar, bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet institucioneve qeveritare dhe aktorëve të shoqërisë civile ka qenë vendimtar për hartimin e politikave gjithëpërfshirëse mbi aspekte të ndryshme të migracionit, si Strategjia Kombëtare kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Plani i Veprimit 2018-2020, përmes Koalicionit Kombëtar të Strehëve Antitrafik, organizatë jofitimprurëse dhe Strategjia Kombëtare për Diasporën 2018–2024, si edhe plani i veprimit përkatës. Roli i aktorëve joshtetërorë, OJQ-ve dhe sektorit privat, në zbatimin e politikave, ka qenë i kufizuar dhe ka pasur karakter *ad hoc*[33]. Vetë migrantët janë konsultuar gjatë gjithë procesit të hartimit të Strategjisë së Migracionit të vitit 2005, Planit të Veprimit për Remitancat, Strategjisë për Diasporën etj. Një mësim i nxjerrë nga përpjekjet e përbashkëta në të shkuarën qëndron në faktin se është thelbësore që institucionet e qeverisë të identifikojnë mënyra për të forcuar dhe për të formalizuar bashkëpunimin me komunitetet e migrantëve, me sektorin privat dhe shoqërinë civile gjatë hartimit dhe në veçanti gjatë zbatimit të politikave të migracionit për të maksimizuar ndikimin e politikave migratore te popullsia, përfshirë migrantët. Nga ky këndvështrim del i nevojshëm organizimi periodik i takimeve ndërmjet institucioneve qeveritare përgjegjëse për zbatimin e politikave migratore me aktorët joqeveritarë që punojnë në fushën e migracionit, si edhe përfshirja e këtyre të fundit në monitorimin dhe rishikimin e vazhdueshëm të politikave migratore në vend.

Në lidhje me partneritetet ndërkombëtare, Shqipëria merr pjesë aktive në disa procese konsultative rajonale dhe ndërkombëtare të migracionit, si Procesi i Budapestit dhe Procesi i Pragës. Është, gjithashtu, pjesë e nismave të ndryshme që promovojnë lëvizshmërinë për punë, menaxhimin më të efektshëm të flukseve migratore në rajon, sigurinë kufitare, tregtinë e lirë dhe zhvillimin, si edhe sigurinë. Këtu përfshihen nisma rajonale, si Nisma Rajonale për Migracionin, Azilin dhe Refugjatët[34], Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal[35], Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore[36], Qendra për Zbatimin e Ligjit në Evropën Juglindore, Nisma e Bashkëpunimit të Evropës Juglindore, Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Evropës Qendrore,[37] Nisma e Evropës Qendrore dhe Nisma Adriatiko-Joniane.[38] Shqipëria është gjithashtu, palë në marrëveshjet e mirëkuptimit (MM) dhe marrëveshjet për migracionin me vendet e tjera, për shembull për migracionin e paligjshëm, për luftën kundër terrorizmit, kundër krimit të organizuar, trafikimit të paligjshëm të

[33] Për shembull, sektori privat ka vepruar si sponsor për shërbimet ndaj migrantëve, sidomos për shërbimet ndaj viktimave të trafikimit, si për shembull për ngritjen e bizneseve.

[34] Shqipëria ka mbajtur kryesinë e kësaj nisme që prej prillit 2010 deri në prill 2011.

[35] Shqipëria është anëtare e bordit.

[36] Shqipëria ka mbajtur kryesinë që prej qershorit 2014 deri në qershor 2015.

[37] Shqipëria e ka kryesuar gjatë vitit 2012.

[38] Shqipëria ka mbajtur kryesinë që prej qershorit 2013 deri në maj 2014.

narkotikëve, për shkëmbimin e informacionit mbi çështjet e migracionit dhe kontrollit, si edhe për çështjet e azilit. Përveç kësaj, Shqipëria është angazhuar në bashkëpunimin dypalësh me vendet kryesore të destinacionit për shtetasit shqiptarë. Aktualisht, po zhvillohen negociata me Gjermaninë dhe Francën për shkëmbimin e informacionit rreth azilit dhe migracionit. Bashkëpunimi me vende të tilla si Mbretëria e Bashkuar, Italia dhe Greqia po vazhdon edhe në lidhje me shkëmbimin e të dhënave dhe informacionit, për procedurat e kthimit, kontrollin e kufirit dhe ndihmën për viktimat e trafikimit. Bashkëpunimi në rritje në fushën e migracionit kërkon që të bëhet një rishikim i plotë i marrëveshjeve dhe angazhimeve ekzistuese për të vlerësuar nivelin e tyre të zbatimit dhe për të hartuar rekomandime të rëndësishme që mund të orientojnë zbatimin edhe në të ardhmen, po aq sa edhe proceset e ardhshme të bashkëpunimit.

- SFERA 2. Migracioni i sigurt dhe i rregullt

Pesë fushat e mëposhtme janë çelësi për të siguruar migracion të sigurt dhe të rregullt:

- Kontrolli i efektshëm i lëvizjeve të parregullta në kufijtë e vendit dhe në territor

Arritje të mëdha kanë rezultuar në këtë fushë gjatë dekadës së fundit për shkak të përmirësimeve të vazhdueshme të infrastrukturës kufitare, rritjes së kapaciteteve të policisë kufitare për të zbuluar, kapur dhe kontrolluar emigrantët në kufi dhe në territor, si edhe për t'i referuar ata te shërbimet e duhura. Sistemi i informacionit për menaxhimin e kufijve në Shqipëri, i quajtur "Sistemi i Menaxhimit Total të Informacionit" (TIMS), si dhe Regjistri Elektronik për të Huajt, i njohur si FER[39], mundëson monitorimin e hyrjeve në Shqipëri dhe daljeve nga vendi, si edhe qëndrimet përtej afatit të vizave. Ligji për të huajt, si dhe ligji për azilin dhe aktet e tyre nënligjore janë aktet kryesore ligjore që rregullojnë procedurën e përzgjedhjes së të huajve, e cila synon të diferencojë midis kategorive të të huajve në lëvizje, siç janë azilkërkuesit, të miturit e pashoqëruar, viktimat ose viktimat e mundshme të trafikimit dhe migrantët pa dokumente, në mënyrë që atyre t'u ofrohet ndihma e nevojshme. Përveç bazës ligjore të fokusuar tek azili dhe migracioni, dy akte ligjore, përkatësisht ligji për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës nr. 18/2017 dhe ligji për shërbimet sociale nr. 121 / 2016 parashikojnë masa specifike mbrojtëse për fëmijët dhe personat në nevojë për mbrojtje apo kategoritë vulnerabël. Në mënyrë që Shqipëria të arrijë nivelet e BE-së në lidhje me kontrollin kufitar, parandalimin dhe kontrollin e migracionit të parregullt, duke mbrojtur të drejtat e migrantëve, drejtimet e mëposhtme kanë nevojë për përmirësime të mëtejshme:

- Infrastruktura e kufirit

Shqipëria duhet të vazhdojë të modernizojë pajisjet dhe infrastrukturën për të forcuar mbikëqyrjen e kufijve, përfshirë kufijtë e gjelbër dhe blu. Një infrastrukturë e përmirësuar dhe organizim më i mirë i shërbimit në pikat e kalimit të kufirit, si për shembull korsi të dedikuara apo akses në informacion, do të sillte shkurtimin e kohës së pritjes dhe do të përmbushte nevojat specifike të migrantëve me nevoja të veçanta si fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara. Për më tepër, përveç informacion për të drejtat e njeriut, duhet të sigurohet e drejta për informacion mbi fazat e vetë procesit të përzgjedhjes për të huajt pa dokumente, si dhe për kategoritë vulnerabël siç janë të miturit e pashoqëruar, viktimat e trafikimit dhe azilkërkuesit. Informacioni mund të vihet në dispozicion përmes materialeve të printuara dhe shërbimeve të përkthimit jo vetëm në kufi, por edhe në territorin e vendit. Këto të fundit kanë nevojë për përmirësime të mëtejshme, pasi mund të pengojnë ofrimin e mbrojtjes së nevojshme, në veçanti për të miturit, qofshin ata të pashoqëruar apo të ndarë, dhe për femrat, si e vetmja mënyrë për të kuptuar nëse ekziston një rast viktime apo i një viktime të mundshme të trafikimit. Vënia në dispozicion e buxhetit të mjaftueshëm për shërbimet e përkthimit së bashku me bashkëpunimin e zgjeruar me partnerët ndërkombëtarë në fushën e migracionit dhe të azilit, si IOM-i, UNHCR-ja etj., mund të adresojë mangësitë që ekzistojnë në ofrimin e shërbimeve të përkthimit.[40]

- Përmirësimi i organizimit të policisë kufitare, trajnimi dhe vendosja e tyre

Forcimi i kapaciteteve kombëtare dhe vendore dhe përcaktimi i burimeve të duhura për procesin e përzgjedhjes të personave në lëvizje janë çështje thelbësore për të siguruar trajtimin e duhur të qenieve njerëzore dhe respektimin e të drejtave të njeriut, përfshirë parimin e "*non refoulement",* si edhe identifikimin dhe referimin e rasteve vulnerabël te shërbimet e mbrojtjes të vëna në dispozicion në Shqipëri. Ndërkohë, që në këtë drejtim vazhdon të ketë ecuri, ende ekziston nevoja për rritjen e burimeve njerëzore në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin (DKM) pranë Policisë së Shtetit, në përputhje me analizën e tendencave në ndryshim për hyrjet e parregullta dhe transitin, si edhe për monitorimin e nevojave të mëtejshme duke u

[39] Portali FER-TIMS përbëhet nga disa module si "E-Leje Qëndrimi", "E-Viza", "Të huaj të parregullt në territor", në të cilat ruhet infomacioni mbi të huajt që trajtohen me vizë, të huajt që trajtohen me leje qëndrimi, të huajt që evidentohen të parregullt në territorin e Shqipërisë, përfshirë të dhënat e tyre biometrike. Sistemet FER-TIMS replikojnë ndërmjet tyre dhe shkëmbejnë të dhëna.

[40] Vlerësimi i nevojave të oficerëve të linjës së parë të përfshirë në procesin e përzgjedhjes, OSBE, 2018 (i pabotuar).

bazuar tek analiza e riskut. Gjithashtu, është rritur nevoja për të emëruar zyrtarisht specialistë zëvendësues për përzgjedhjen, të cilët të mund të përfshihen në ato raste kur do të ketë flukse të të huajve pa dokumente. Si rezultat, është e domosdoshme që aktet nënligjore për përzgjedhjen të parashikojnë shprehimisht që në rastet e flukseve, punonjësit e tjerë të kufirit dhe migracionit, të trajnuar për procesin e përzgjedhjes, të kenë mandatin e duhur për t'u përfshirë në procedurat e përzgjedhjes. Përveç kësaj, nevojitet të vazhdohen përpjekjet për të konsideruar çështjet gjinore në policinë kufitare duke inkurajuar pjesëmarrjen e grave në policinë kufitare dhe duke siguruar trajnime përkatëse për të gjithë personelin.

Rritja e flukseve të popullatave të përziera dhe në lëvizje, ka nxjerrë në pah nevojën jo vetëm për trajnimin e vazhdueshëm të policisë kufitare dhe të stafit drejtues nga Departamenti i Trajnimit Policor në Policinë e Shtetit[41], po edhe për t'u siguruar që trajnimi bazohet në praktikat e mira dhe standardet evropiane, të tilla si Kurrikula e Përbashkët Bërthamë e Agjencisë Evropiane të Kufirit dhe Rojës Bregdetare (Frontex). Trajnimi bazë duhet të përfshijë procedurat e përzgjedhjes, të drejtat dhe garancitë procedurale të kategorive vulnerabël, si të miturit, viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit dhe azilkërkuesit dhe të zhvillohet për të gjithë punonjësit e Kufirit dhe Migracionit që shërbejnë si zëvendësues në procesin e përzgjedhjes.

- Politika të efektshme të hyrjes dhe qëndrimit

Politika e vizave luan një rol të rëndësishëm në uljen e rasteve të migracionit të parregullt drejt Shqipërisë. Tashmë Shqipëria ka një sistem të vizave elektronike (*e-viza*), i cili përdoret për të regjistruar të gjithë shtetasit e huaj që aplikojnë për vizë përpara hyrjes në Shqipëri. Sistemi është funksional brenda sistemit TIMS dhe lejon që i gjithë procesi i aplikimit të kryhet me anën e internetit, pra *on line*. Raporti Vjetor i Komisionit Evropian për vitin 2018 rekomandon që Shqipëria të harmonizojë gradualisht politikën e saj të vizave me atë të BE-së, gjë e cila kërkon përputhshmëri me listat e BE-së për vendet, shtetasit e të cilave kërkojnë vizë apo përjashtohen nga kërkesa për vizë.[42] Për këtë qëllim, Shqipëria mund të përfitojë gjithashtu nga prezantimi i një mekanizmi të aksesit të drejtpërdrejtë te të dhënat elektronike të aplikimit të mëparshëm për vizë dhe të historisë së migracionit të aplikantit, e cila mund të përdoret për të shqyrtuar rastet e refuzimeve të mëparshme për vizë ose të shkeljes së kushteve të vizës nëpërmjet përdorimit të njoftimeve automatike.

Një instrument tjetër që ndihmon në minimizimin e rasteve të qëndrimit të parregullt dhe të transitit është zbatimi i vazhdueshëm i kontrolleve të synuara dhe përdorimi efektiv i masave lidhur me qëndrimin e parregullt. Shqipëria duhet të kryejë kontrolle për migracionin në përputhje të plotë me praktikën e BE-së, nëpërmjet respektimit të kritereve dhe procedurave për zbatimin e një sërë masash standarde në rastet e shkeljes së provuar të ligjshmërisë së qëndrimit nga shtetasit e huaj: ndërprerjen e një vize/leje qëndrimi, kthimin vullnetar me ndalim të përkohshëm të rihyrjes, urdhër largimi dhe dëbimi. Në veçanti, ajo duhet të standardizojë rregullat e provave, kohëzgjatjen e procedurës dhe mekanizmat për bashkëpunimin ndërinstitucional. SKZHI-ja ka vendosur disa objektiva kyç në lidhje me parandalimin dhe reduktimin e rasteve të migracionit të parregullt dhe shtetasve të huaj të kapur në territorin e Shqipërisë me dokumente të parregullta përmes kryerjes së analizave të sakta të riskut, vendosjes së forcave në zonat më të prekura dhe ofrimit të pajisjeve moderne për të parandaluar migracionin e parregullt. Këto masa synojnë të ulin nivelet e migracionit të parregullt në mënyrë të tillë që të arrihet:

- Rritje në shkallën e zbulimit dhe të

[41] Kjo është një strukturë administrative dhe menaxhimi, e cila u krijua për të drejtuar të gjitha aspektet e trajnimit. Ajo filloi të funksionontë në korrik 2007. Ky departament fokusohet në trajnimin fillestar dhe në zhvillimin e vazhdueshëm të aftësive të punonjësve të Policisë së Shtetit, duke u bazuar në standardet dhe në përvojën e vendeve të zhvilluara. Trajnimet bëhen në përputhje me rolin, gradën, funksionin dhe përgjegjësitë e punonjësve të Policisë së Shtetit. Ato përfshijnë aspekte etike, njohuri të së drejtës, kërkesa gjuhësore etj.

[42] Për shembull pritet të përfundojnë përjashtimet për vizë të përkohshme, si ato që aplikohen gjatë muajve të verës drejt disa vendeve që nuk janë shtete anëtare të BE-së.

eliminimit të migracionit të parregullt në 87% deri më 2020 (nga 70% më 2014);

- Ulje e rasteve të migracionit të parregullt dhe shtetasve të huaj të kapur në territorin e Shqipërisë me dokumente të parregullta me 27% më shumë në vitin 2020, krahasuar me vitin 2014; dhe

- Monitorimi i flukseve migratore me anën e analizave mujore dhe vjetore të riskut në përputhje me standardet e FRONTEX-it[43].

Për të arritur këto objektiva, autoritetet e kufirit dhe migracionit do të duhet të kryejnë analiza periodike risku, duke marrë parasysh ndryshimin e vendeve të përqendrimit të migrantëve të parregullt si dhe të *modus operandi* të lehtësuesve që ndryshojnë gjithnjë. Këto masa janë thelbësore për planifikimin efektiv dhe monitorimin e efektivitetit të inspektimeve të ligjshmërisë së qëndrimit. Për më tepër, është e rëndësishme që të gjithë punonjësit e policisë të kenë akses në kohë reale te të dhënat për statusin aktual të qëndrimit të të huajve, me qëllim zbulimin e rasteve të qëndrimit përtej afatit ose të shkeljes së kushteve të qëndrimit.

- Mekanizma të efektshme të kthimit për imigrantët e parregullt

Ripranimi është një nga mekanizmat e përdorura nga autoritetet shqiptare për kthimin në vendin e origjinës të shtetasve shqiptarë me qëndrim të parregullt në vendet e destinacionit, po aq sa edhe imigrantët me qëndrim të parregullt në vend. Shqipëria ka nënshkruar marrëveshje dypalëshe ripranimi me disa vende, si edhe me Bashkimin Evropian, e cila përfshin gjithashtu një klauzolë për shtetasit e vendeve të treta (SHVT). Marrëveshja e ripranimit me BE-në po zbatohet në mënyrë të kënaqshme, ndërkohë që Shqipëria po shqyrton me shpejtësi kërkesat e ripranimit nga shtetet anëtare. Për sa i përket kthimit dhe ripranimit të shtetasve të vendeve të treta, çështja kryesore është identifikimi i shpejtë dhe efektiv. Procedura përfshin fillimisht kontrollin e të dhënave biometrike, mbledhjen e gjurmëve të gishtërinjve dhe fotografive[44], pasuar nga intervista për arsyet e mbërritjes në Shqipëri dhe rrethanat në të cilat ata janë larguar nga vendet e tyre. Personat më pas drejtohen në sistemin e azilit, kthehen në vendin e transitit ose i referohen qendrës së mbyllur të pritjes për imigrantët e parregullt. Në të ardhmen do të nevojitet bashkëpunimi i shpejtë dhe efikas me ambasadat dhe shërbimet e kufirit dhe migracionit në vendet e origjinës për identifikimin e shpejtë të shtetasve të huaj dhe procedurat përkatëse të kthimit.

Një fushë shqetësuese është organizimi i kthimit të shtetasve të vendeve të treta në Greqi. Mungesa e një Protokolli për zbatimin e Marrëveshjes së Ripranimit BE-Shqipëri me Greqinë është identifikuar si nevojë në disa vlerësime dhe raporte institucionale.[45] Negociata për marrëveshjet e ripranimit janë duke u zhvilluar tashmë me një sërë vendesh të origjinës, duke përfshirë Rusinë, Marokun, Afganistanin, Irakun dhe Iranin. Sfidat e tjera të identifikuara nga autoritetet në lidhje me ripranimin e shtetasve të vendeve të treta deri më tani kanë të bëjnë me kapacitetet e kufizuara të pritjes në pikat kufitare, ambientet e kufizuara të pritjes për të miturit e pashoqëruar, trajnimet e pamjaftueshme të personelit, fondet e kufizuara për kthim në vendin e origjinës si edhe sfidat e përkthimit.

Kthimi vullnetar është një tjetër mekanizëm për kthimin e imigrantëve me qëndrim të parregullt, i cili përdoret nga autoritetet shqiptare, pasi siguron kthim të denjë dhe të asistuar për migrantin në vendin e origjinës. Megjithatë, numri i kthimeve vullnetare të asistuara nga Shqipëria gjatë 5 viteve të fundit ka qenë i papërfillshëm.[46] Shumica e atyre që janë kapur gjatë 5 viteve të fundit, kanë hyrë në mënyrë të parregullt përmes Greqisë si vend transit. Sipas DKM-së, të huajt kanë shprehur dëshirën për t'u kthyer vullnetarisht në Greqi, si

[43] Frontex promovon, koordinon dhe zhvillon menaxhimin e kufirit evropian në përputhje me kartën e BE-së për të drejtat themelore, duke aplikuar konceptin e Menaxhimit të Integruar të Kufirit.

[44] Shenjat e gishtërinjve dhe fotografitë merren vetëm për migrantët mbi 18 vjeç.

[45] Raporti për vlerësimin e qeverisjes së migracionit, 2016, IOM; Vlerësim i Përbashkët i Shpejtë për Migracionin dhe Azilin, UNCT, 2018; Raporti Vjetor i Komisionit Evropian për Shqipërinë, 2018

[46] Legjislacioni shqiptar dhe praktika për kthim vullnetar të asistuar, IOM, 2018

vendi ku kanë kërkuar azil dhe jo në vendin e tyre të origjinës. Rrjedhimisht, numri i atyre që u kanë kërkuar autoriteteve ndihmë për t'u kthyer në vendin e origjinës ka qenë i kufizuar. Kjo mund të ketë qenë edhe për shkak të mungesës së informacionit në lidhje me skemën e kthimit vullnetar të asistuar për migrantët pa dokumente.

Shqipëria nuk ka ende procedura standarde lidhur me procesin e kthimit vullnetar të asistuar (KVA) nga Shqipëria drejt vendeve të origjinës, sipas të cilave migrantët e parregullt dhe kategori të tjera të këshillohen për KVA-në. Këtu përfshihen azilkërkuesit të cilëve u është refuzuar kërkesa për azil dhe azilkërkuesit dhe refugjatët që dëshirojnë të kthehen në vendin e tyre të origjinës. Në mungesë të procedurave standarde, ose të një protokolli mbi kthimet vullnetare të asistuara, procesi fillon vetëm me një deklaratë nga individi. Përveç kësaj, në rastet kur i huaji i nënshtrohet urdhrit të largimit me forcë, ka pasur dhe ende ka vështirësi operacionale[47] për të bërë urdhrin për kthimin vullnetar të asistuar dhe për të përfshirë partnerë të tjerë, si IOM-i[48]. Kthimi vullnetar i asistuar i të miturve të pashoqëruar është veçanërisht i vështirë dhe sfidë më vete. Kjo për disa arsye, përfshirë mungesën e strehimit të duhur, përcaktimin e interesit më të mirë të fëmijës për shkak të vështirësive për të kontaktuar autoritetet, familjet, apo kujdestarët në vendet e origjinës në rastet kur këto të fundit janë në zona lufte. Në kohën e hartimit të këtij dokumenti, ishte ende në proces hartimi i vendimit të Këshillit të Ministrave në lidhje me kthimin dhe riintegrimin e të miturve. Vendim, i cili do të rregullojë në detaje procedurën e trajtimit të të miturve të pashoqëruar, strehimin e tyre dhe kthimin në vendin e origjinës, vetëm në ato raste kur kthimi është në interesin më të mirë të të miturit, dhe përmes asistencës së autoriteteve shqiptare.

Është identifikuar gjithashtu nevoja për rritjen e burimeve njerëzore që do të duhet të merren me kthimin vullnetar. Procesi i kthimit vullnetar të asistuar përfshin procedura operacionale dhe procedura prokurimi, të cilat për momentin i kryejnë punonjësit që janë përgjegjës për ripranimin. Rritja e numri të KVA-ve do të kërkojë rritjen e numrit të burimeve njerëzore. Për këtë arsye, mund të konsiderohet e domosdoshme caktimi i punonjësve të veçantë për kthimin vullnetar dhe kthimin vullnetar të asistuar, pasi kjo do të vendoste dhe do të tregonte vëmendjen e duhur te procesi i KVA-së.

- Reagimi efikas ndaj migracionit të parregullt të shtetasve shqiptarë në BE

Qeveria shqiptare ka përmbushur standardet e regjimit pa viza, që kur filloi procesi i liberalizimit të vizave. Këto përpjekje kanë ndihmuar në uljen e shkallës së kërkesave të pabazuara për azil të depozituara nga shtetasit shqiptarë në vendet anëtare të BE-së dhe në vendet e zonës Shengen. Numri është ulur me 20% nga 31,737 aplikime në vitin 2016 në 25,528 aplikime në vitin 2017. Në janar 2018, Franca regjistroi 720 kërkesa për azil dhe Gjermania 300, përkatësisht 30% dhe 52.7% më pak krahasuar me janarin e vitit 2017. Në përputhje me angazhimet e marra me BE-në, pritet përmirësim i mëtejshëm në këtë fushë për të trajtuar shkaqet burimore të migracionit të parregullt. Shqipëria ka intensifikuar dialogun me vendet anëtare më të prekura dhe në qershor 2017 qeveria miratoi një plan veprimi për të parandaluar keqpërdorimin e azilit në vendet e BE-së dhe ato të zonës Shengen. Paralelisht u nënshkruan marrëveshje dypalëshe me vendet e destinacionit. Në dhjetor të vitit 2017, Shqipëria nënshkroi një marrëveshje me Francën për forcimin e bashkëpunimit policor dhe për dërgimin në Francë të katër policëve frëngjishtfolës shqiptarë, të cilët aktualisht po mbështesin goditjen e organizatave kriminale me origjinë shqiptare, si edhe identifikimin e ndërmjetësve që organizojnë udhëtimin e azilkërkuesve drejt Francës.

Për të ulur rrezikun e kërkesave të pabazuara për azil, janë marrë edhe masa të tjera të përkohshme operacionale. Këto përfshijnë kontrolle më të rrepta në pikat e kalimit kufitar, intervista më të hollësishme në dalje dhe fushata

[47] Për të ndryshuar urdhrin nevojitet prania e specialistit të përzgjedhjes, i cili mund të jetë nga drejtoritë e qarkut për kufirin dhe migracionin. Prania e tyre në kohë nuk është gjithmonë e mundur, sepse në drejtoritë rajonale është vetëm një specialist përzgjedhjeje, që duhet të kryejë një sërë detyrash dhe nuk mund të udhëtojë te qendra e ndalimit, ku mbahet i huaji. Nisur nga kjo vështirësi teknike, në praktikë, autoritetet e kufirit dhe të migracionit nuk e ndryshojnë urdhrin e dëbimit dhe nuk e heqin ndalimin e hyrjes që e shoqëron atë.

[48] IOM-i nuk mund të përfshihet në kthim vullnetar të asistuar, në rast se i huaji është subjekt i një urdhri largimi.

informimi për udhëtarët. Kontrollet më të rrepta pas largimit kanë rezultuar në një rritje të refuzimit të qytetarëve në dalje nga vendi. Kështu, në vitin 2017, 12,403 shtetasve shqiptarë iu refuzua leja për të dalë nga territori shqiptar në vendkalimet kufitare (10,796 të rritur dhe 1,607 të mitur), ndërsa vetëm në dy muajt e parë të vitit 2018, 3,307 persona (3,061 të rritur dhe 246 të mitur) nuk janë lejuar të largohen nga vendi.

Mësimet e nxjerra nga zbatimi i regjimit të liberalizimit të vizave diktojnë nevojën për forcimin e përpjekjeve institucionale për të trajtuar fenomenin e kërkesave të pabazuara për azil, si edhe faktorët shtytës. Është e nevojshme të intensifikohet më tej bashkëpunimi i ngushtë me vendet e destinacionit, duke përfshirë ofrimin e mbështetjes për ndërgjegjësim dhe mbështetjes socio-ekonomike për migrantët e ardhshëm dhe të kthyerit, duke u bazuar në një analizë të saktë të nevojave dhe të zonave gjeografike të prekura nga ky fenomen. Fushatat e ndërgjegjësimit duhet të kenë më shumë në fokus azilkërkuesit e mundshëm. Sportelet e Migracionit të krijuara në të gjithë vendin vazhdojnë të ofrojnë mbështetje për ata që kthehen në Shqipëri, si dhe për migrantët e ardhshëm, por kapacitetet e tyre për ofrimin e informacionit duhet të forcohen më tej. Përveç kësaj, rekomandohet që bashkëpunimi mes DKM-ve dhe bashkive për ofrimin e ndihmës për të miturit e pashoqëruar të ripranuar shqiptarë të formalizohet në veçanti në zonat kufitare. Duke pasur parasysh që mungesa e mundësive më të mira për jetën dhe arsimin janë ndër arsyet kryesore për emigracionin e të miturve të pashoqëruar nga Shqipëria, krijimi i programeve të veçanta për të rinjtë mund të trajtojë faktorët specifikë shtytës për emigracionin dhe të kontribuojë në zhvillimin e komunitetit lokal në rajonet e origjinës të të miturve të pashoqëruar.

- Menaxhimi i flukseve të përziera[49]

Analiza e tendencave të ndryshueshme të lëvizjeve të popullatës nga vendet fqinje të Shqipërisë dikton nevojën për të forcuar kapacitetin e vendit për pritjen e një numri më të madh mbërritjesh në territorin e vendit. Në këtë kontekst, mbetet thelbësore ndjekja nga afër jo vetëm e dinamikave të lëvizjeve migratore për motive të ndryshme, por edhe të shenjave paralajmëruese të hershme për rritje të numrit. Azilkërkuesit që vijnë nga Greqia dhe të intervistuar në Shqipëri, si shkak për lëvizjen e mëtejshme konfirmojnë procedurat e zgjatura të azilit në Greqi, kushtet e papërshtatshme të pritjes në brendësi dhe në ishuj, si edhe dëshirën për t'u bashkuar me anëtarët e tyre të familjes në shtetet anëtare të BE-së. Prandaj, nëse këta faktorë nuk përmirësohen, sidomos kushtet e pritjes dhe procedurat e azilit, refugjatët dhe migrantët gjithnjë e më shumë do të kërkojnë alternativa. Opsionet janë ose kalimi në mënyrë të parregullt i kufijve tokësorë në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe në Shqipëri, siç ka qenë rasti që nga viti 2015, ose përpjekja me rrugë alternative detare që deri më tani nuk ka qenë opsion. Prandaj është e nevojshme të vazhdohet sigurimi i efektivitetit të kontrolleve kufitare në pikat e kalimit kufitar të autorizuara, kontrolli përgjatë kufirit të gjelbër, si edhe të përditësohet periodikisht profili i refugjatëve dhe i imigrantëve që vijnë në Shqipëri, veçanërisht arsyet për të cilat ata synojnë të kalojnë përmes Shqipërisë. Për më tepër, rekomandohet rritja e alternativave për migracion të rregullt dhe rritja e bashkëpunimit dhe partneriteteve ndërkombëtare për migrim të sigurt e të rregullt, për të adresuar kështu shkaqet e migracionit të parregullt.

Në vitin 2015, Shqipëria hartoi Planin e parë të Kontingjencës për Reagim ndaj Flukseve të Përziera Migratore, i cili ka nevojë të zëvendësohet me një plan të ri, i cili duhet të marrë parasysh rritjen e numrit të mbërritjeve/ndalimeve të migrantëve dhe veçanërisht numrin e kërkesave për azil në Shqipëri.[50] Të gjithë aktorët e përfshirë në ofrimin e ndihmës, shërbimeve dhe mbrojtjes do të duhet të rivlerësojnë nevojat, prioritetet dhe procedurat ekzistuese. Një ndryshim i tillë ka ndikimin e vet edhe në parashikimet buxhetore të strukturave shtetërore, agjencive të OKB-së dhe OJQ-ve të përfshira. Sfidat dhe nevojat e

[49] Ky term reflekton perspektivën e qeverisjes së migracionit që është në fokus të kësaj strategjie, por duke mos nënvlerësuar faktin që azilkërkuesit dhe refugjatët janë kategori shumë të veçanta të personave që përfitojnë mbrojtje specifike.

[50] Përqindja e shtetasve të huaj që bënë kërkesë për azil me të mbërritur, u dyfishua nga 33% në vitin 2017 dhe vitet e mëparshme në 66% në gjysmën e parë të vitit 2018.

mëposhtme[51] duhet të merren parasysh dhe të trajtohen në Planin e ri të Kontingjencës:

- E drejta për strehim të sigurt dhe të denjë

Rritja e numrit të refugjatëve dhe të imigrantëve ka nxitur nevojën për rritjen e kapacitetit të pritjes së azilkërkuesve dhe migrantëve në Tiranë dhe në kufij. Kapaciteti i përgjithshëm pritës në vend është 400 dhe deri tani ka qenë i mjaftueshëm duke pasur parasysh natyrën e përkohshme të lëvizjes, por do të ishte i pamjaftueshëm nëse rritet numri i personave që qëndrojnë në vend.[52] Nuk ka streha të specializuara për gratë dhe fëmijët në rrezik, ndërkohë që referimet në qendrat rezidenciale të kujdesit të menaxhuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale kanë rezultuar të vështira për shtetasit e huaj. Në këtë drejtim, në kufi mund të krijohet një rrjet qendrash pritëse të përkohshme apo emergjente në koordinim me bashkitë kryesore, agjencitë e OKB-së dhe OJQ-të për të siguruar ofrimin e shërbimeve të specializuara për ata që kanë më shumë nevojë. Përveç kësaj, rekomandohet që të rritet koordinimi ndërmjet Qendrës Kombëtare për Azikërkuesit, Qendrës së Mbyllur Pritëse në Kareç, strehëve emergjente për të mbijetuarit e dhunës në familje, fëmijët në rrezik dhe viktimat e trafikimit.

- Mbrojtja e fëmijëve

Të miturit e pashoqëruar dhe të ndarë zakonisht referohen dhe vendosen në Qendrën Kombëtare të Pritjes në Tiranë së bashku me të rriturit me të cilët ata udhëtojnë. I njëjti raport e Ekipit të OKB-së vë në dukje se intervistat individuale të fëmijëve në kufi nuk kryhen, përveç se në ato raste kur fëmijët identifikohen menjëherë si të pashoqëruar. Intervistat me të mitur të shoqëruar raportohen të kryera në prani të familjes dhe si pjesë e të gjithë familjes ose grupit të të rriturve, edhe atëherë kur marrëdhënia e tyre nuk është e vërtetuar, e cila në fakt e kufizon kapacitetin e intervistës përzgjedhëse për të identifikuar si duhet të miturit e pashoqëruar që nuk e deklarojnë veten si të tillë. Mungesa e vlerësimeve gjithëpërfshirëse, mungesa e mekanizmit të menaxhimit të rasteve dhe të referimit gjithashtu tregojnë se fëmijët nuk kanë pasur të drejtë të merrnin shërbime për të cilat mund të kenë pasur nevojë, siç është mbështetja psiko-sociale. Miratimi i vendimit të Këshillit të Ministrave për rregullat dhe procedurat e kthimit dhe të riatdhesimit të fëmijës së pashoqëruar në zbatim të ligjit nr. 18/2017 për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës pritet të përcaktojë mekanizma të qarta për menaxhimin e rasteve të të miturve të pashoqëruar, qofshin këta shqiptarë apo të huaj. Pritet që vendimi të përcaktojë detyrimin që do të ketë policia e kufirit dhe e migracionit për ta dorëzuar të miturit e pashoqëruar te Njësia Rajonale për Mbrojtjen e të Miturve, e cila ka përgjegjësinë për të ofruar strehim për të miturin e pashoqëruar, për të plotësuar nevojat bazë të të miturit, si edhe për të caktuar një psikolog dhe një kujdestar ligjor. Në përgjithësi, Plani i Kontigjencës duhet të trajtojë me kujdes aspekte të tjera të situatës së të miturve, që nuk mund të mbuloheshin nga kjo strategji, e cila parashikon veprime të fokusuara.

- Gratë në rrezik

Procedura për identifikimin, referimin dhe menaxhimin e rasteve të viktimave të trafikimit është e konsoliduar mjaft mirë. Megjithatë, ajo është testuar vetëm për shtetasit e huaj një herë në dy vitet e fundit. Mes personave në lëvizje, vetëm viktimat e trafikimit kanë të drejtën ligjore për shërbime të kujdesit rezidencial të ofruara nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale. Nga ana tjetër, për të trajtuar siç duhet çështjen e dhunës seksuale dhe atë me bazë gjinore (DHSBGJ), në dispozicion të (grave) imigranteve, azilkërkuesve ose refugjate duhet të vihen shërbime të dedikuara për ta. Aftësia për të identifikuar viktimat e dhunës me bazë gjinore është identifikuar si një çështje urgjente, pasi për momentin kjo gjë nuk është e mundur, sepse intervistat për përzgjedhje nuk japin informacion të mjaftueshëm për identifikimin e rasteve. Një

[51] Sipas Vlerësimit të Përbashkët për azilin dhe migracionin e përzierë; Situata në Shqipëri, 2018, të kryer nga Ekipi i OKB-së në Shqipëri

[52] Qendra Kombëtare Pritëse e Azilkërkuesve në Tiranë mund të strehojë maksimumi 180 persona. Gjithashtu, në kufirin jugor, 75 persona gjithsej mund të akomodohen përkohësisht në qendrën bashkiake (15 vetë) dhe në Qendrën për Regjistrim dhe Akomodim të Përkohshëm të migrantëve të parregullt që menaxhohet nga PKM (60 vetë). Caritas Albania ka vënë në dispozicion të Ministrisë së Brendshme një ambient që mund të mbaje deri në 120 vetë. Ky ambient gjendet në afërsi të kufirit me Malin e Zi.

sfidë tjetër është aftësia e kufizuar teknike për të identifikuar të mbijetuarit e dhunës me bazë gjinore ose viktimat e trafikimit nga autoriteti që strehon gratë dhe vajzat që kanë aplikuar për azil në kufi. Identifikimi është ndërlikuar më tej nga periudha e pamjaftueshme e qëndrimit të grave dhe vajzave në qendër (7–10 ditë) për shkak të rrethanave të lëvizjes transitore.

- Kategori të tjera vulnerabël

Gjithashtu, Plani i Kontigjencës duhet të përpiqet të trajtojë çështjet që lidhen me mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara dhe të moshuarve.

- *Shëndeti*

Drejtoritë rajonale të DKM-së, shërbimet sociale dhe OJQ-të që merren me të huajt koordinojnë veprimet rast pas rasti, por bashkëpunimi i tyre nuk është i formalizuar. Përveç kësaj, mungojnë planet e emergjencës për menaxhimin e situatës emergjente në lidhje me refugjatët dhe emigrantët.

- *Menaxhimi i të dhënave*

Matrica e IOM-it për Gjurmimin e Shpërnguljes (MGJSH/DTM)[53] është përdorur gjerësisht nga autoritetet shtetërore në shumë vende, përfshirë Shqipërinë, për gjurmimin dhe monitorimin e shpërnguljes dhe lëvizshmërisë së popullsisë. Ajo është projektuar për të kapur, përpunuar dhe për të shpërndarë rregullisht dhe sistematikisht informacionin për të kuptuar më mirë lëvizjet dhe nevojat në zhvillim të popullatave të shpërngulura, qoftë në vend ose gjatë itinerarit të lëvizjes. Përveç përdorimit sistematik në operacione të reagimit humanitar në shkallë të mesme dhe të gjerë, DTM-ja gjithashtu ka qenë shumë efektive jo vetëm si mjet i gatishmërisë, por edhe për të mbështetur fazën e rikuperimit dhe tranzicionit. Përfshirja e DTM-së në aktivitetet për forcimin e kapaciteteve, për përcaktimin e vendeve të mundshme të evakuimit dhe të shpërnguljes dhe për përgatitjen përpara se të ndodhë një katastrofë janë vetëm disa shembuj se si mund të përdoret DTM-ja si një masë efektive e gatishmërisë. Gjurmimi i duhur i popullatave të përziera, si migrantë, azilkërkues, refugjatë etj., kërkon që të gjitha institucionet përkatëse (Drejtoria për Azilin, Policia Kufitare dhe e Migracionit, Qendra Kombëtare për Azilkërkuesit dhe Qendra e Mbyllur Pritëse në Kareç) të kenë akses në një sistem të përbashkët të menaxhimit të informacionit. Kjo aktualisht është e kufizuar, pasi Drejtoria nuk mund të modifikojë të dhënat në Regjistrin Elektronik të të Huajve (REH). Për momentin, kjo kompetencë i përket vetëm Policisë Kufitare dhe të Migracionit. Nga ana tjetër, punonjësit e kufirit që merren me përzgjedhjen mund të hyjnë në sistemin REH të regjistrojnë raste të reja, por nuk mund të modifikojnë të dhënat ekzistuese, edhe nëse përputhen shenjat e gishtërinjve të individit. Kjo çon në proceset të gjata të pastrimit të të dhënave, mospërputhje midis drejtorive të ndryshme brenda Ministrisë së Brendshme dhe numërim të dyfishtë.

- SFERA 3. Politika të efektshme të migracionit për motive punësimi dhe ndikimi i rritur pozitiv i migracionit te zhvillimi kombëtar/lokal

Katër elementët e mëposhtme janë çelësi për të siguruar politika të efektshme të migracionit për motive punësimi për Shqipërinë dhe për të rritur ndikimin pozitiv të migracionit te zhvillimi ekonomik në nivel kombëtar dhe vendor:

[53] DTM-ja përbëhet nga katër komponentë të ndryshëm:

- Gjurmimi i lëvizshmërisë: gjurmon rregullisht nevojat ndër sektoriale dhe lëvizjen e popullsisë për të përcaktuar asistencën në vendndodhje të shpërnguljes ose në vendndodhjen e origjinës ose vende të mundshme të rivendosjes për të mbështetur zgjidhje të qëndrueshme ndaj shpërnguljes;

- Monitorimi i fluksit: gjurmon lëvizjen e popullatave të zhvendosura në pika kryesore transiti kur vendet e origjinës nuk janë të aksesueshme dhe shpërngulja është graduale;

- Regjistrimi: informacion për individin dhe familjen i cili përdoret nga menaxherët në terren për përzgjedhjen e përfituesit, përcaktimin e vulnerabilitetit dhe programimin;

- Anketime: mbledh informacion specifik përmes kampionimit të popullsisë, në lidhje me synimin për t'u kthyer, zgjidhjet për shpërngulje, perceptimin e komunitetit dhe informacion tjetër tematik në lidhje me shpërnguljen.



- Kuadri i politikave të efektshme të migracionit për motive punësimi

Në kuadrin ekzistues politik, migracioni për motive punësimi konsiderohet pjesë e *menaxhimit të burimeve për punësim*. Strategjia Kombëtare për Punësimin ka integruar migracionin në të gjitha objektivat e saj strategjikë, të cilat janë të orientuara drejt promovimit të *mundësive për vende pune dhe aftësive për të gjithë, si gratë, ashtu edhe burrat shqiptarë*. Strategjia si një nga objektivat e saj strategjikë ka vendosur nxitjen e mundësive të mira të punësimit dhe për të arritur këtë duhet të merren parasysh nevojat specifike të të kthyerve dhe emigrantëve gjatë hartimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave kombëtare të punësimit. Tre vjet nga zbatimi i kësaj strategjie është evidentuar nevoja për kryerjen e një vlerësimi për të matur shkallën e arritjes së këtij objektivi.

Në planifikimin, hartimin dhe monitorimin e politikave të ardhshme të punësimit është e nevojshme të analizohet ndikimi i migracionit të shtetasve shqiptarë (përfshirë emigracionin dhe kthimin) dhe të të huajve në tregun kombëtar të punës, qofshin këta punëtorë migrantë ose azilkërkues dhe refugjatë. Parashikimi i nevojave të ardhshme të tregut të punës është thelbësor për të trajtuar sfidat që lidhen me rënien e shpejtë të popullsisë për shkak të shkallës së ulët të lindshmërisë, e shoqëruar kjo edhe me flukse të qëndrueshme emigratore nga Shqipëria. Kjo analizë do të bëjë të mundur që tregu kombëtar i punës të mos pësojë sfida të mëdha, por edhe të ruajë një sistem të mirë të sigurimeve shoqërore.

Objektiv strategjik i Qeverisë mbetet forcimi i *qeverisjes së tregut të punës dhe sistemeve të kualifikimit*. Vërehet se detyrat apo përgjegjësitë e migracionit për motive punësimi ndahen mes ministrive dhe agjencive të varësisë, që janë prekur nga riorganizimi i qeverisë në vitin 2017, si edhe nga ndryshimet brenda strukturave të brendshme të ministrive, siç janë për shembull ndryshimet në strukturën e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë. Kjo e bën të domosdoshme kryerjen e një vlerësimi të burimeve të disponueshme njerëzore, financiare dhe të informacionit në institucionet përgjegjëse për realizimin e detyrave të migracionit për motive punësimi të përcaktuara në legjislacionin aktual, për të identifikuar boshllëqet dhe nevojat për investim. Për më tepër, nevojitet të përcaktohet roli dhe kapacitetet operacionale të Sporteleve të Migracionit brenda fushëveprimit dhe përgjegjësive të Shërbimit Kombëtar të Punësimit për të përmirësuar zbatimin e politikave të migracionit.

Gjatë katër viteve të fundit, Ministria e Financave ka kryer me sukses analiza vjetore të nevojave për aftësi në tregun shqiptar për të planifikuar shpërndarjen e arsimit dhe trajnimit profesional dhe për të përgatitur specialistë që kërkohen jo vetëm në Shqipëri, por edhe në rang ndërkombëtar.[54] Një tjetër masë kryesore e politikave ka qenë zhvillimi i kapaciteteve për politikëbërësit që të njohin boshllëqet e aftësive dhe pabarazisë gjinore në tregun kombëtar të punës dhe që të marrin masat përkatëse për të promovuar transferimin e aftësive nga tregjet e tjera të punës.

Për më tepër, Strategjia e Punësimit ka parashikuar hartimin dhe zbatimin e Programeve të Transferimit të Aftësive në bazë të parashikimeve për nevojën për aftësi në sektorë të ndryshëm, dhe në bazë të marrëveshjeve të bashkëpunimit me vendet e tjera të EJL. Raporti[55] më i fundit i vlerësimit të nevojave të aftësive për Shqipërinë tregon se një e treta (39.9%) e ndërmarrjeve deklaruan se personelit të tyre ekzistues u mungonin aftësitë përkatëse, një shifër dy herë më e lartë se ajo e raportuar në vitin 2014. Furnizimi me ujë, kanalizimet dhe mbetjet, minierat dhe guroret janë sektorët që vuajnë më shumë nga

[54] Këto janë masa specifike në Planin e Veprimit për Punësimin.

[55] Nevoja për Aftësi në Shqipëri, 2017, Bashkëpunimi Zviceran për Zhvillim (faqe 115)

mungesa e aftësive mes punonjësve aktualë. Arsyeja mbizotëruese e raportuar nga bizneset që përballen me mungesën e aftësive, është sepse tregu i punës nuk është në gjendje të ofrojë kandidatë me njohuri dhe aftësi të mjaftueshme.

Në realizimin e objektivave kombëtarë nevojitet të analizohet më tej potenciali i komuniteteve të migrantëve shqiptarë jashtë vendit, përfshirë ata me qëndrim të përhershëm në vendet e destinacionit, si edhe i shqiptarëve të kthyer me aftësi dhe kualifikime në sektorët në nevojë. Kjo kërkon identifikimin, përmes anketimeve për aftësitë dhe kualifikimet, të disa prej barrierave dhe mundësive për integrimin e migrantëve të mundshëm dhe të të kthyerve në tregun e punës në Shqipëri. Kjo kërkon gjithashtu një rol më aktiv të zyrave të përfaqësive shqiptare jashtë vendit për të shpërndarë listën e profesioneve dhe të kualifikimeve që kanë nevojë për aftësi, si edhe kushtet për të filluar punë në Shqipëri. Kushte të lehtësuara, të tilla si heqja e taksave të përkohshme etj., për ata anëtarë të diasporës që i kanë aftësitë e kërkuara, do t'i inkurajonin ata të fillonin punë në Shqipëri në veçanti në kontekstin e nismave pilot në sektorët që përjetojnë largimin më të madh të profesionistëve.

Analizimi i potencialit të komuniteteve të migrantëve shqiptarë jashtë vendit trajtohet gjerësisht edhe në Strategjinë Kombëtare për Diasporën, ku evidentohet nevoja për eksplorimin dhe shfrytëzimin e këtij potenciali, si dhe nxitja e kthimit të migrantëve të kualifikuar. Plani i Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Migracionin, në mbështetje të parashikimeve të Strategjisë Kombëtare për Diasporën, thekson domosdoshmërinë e ngritjes së infrastrukturës për realizimin me sukses të Regjistrit të Adresave të shtetasve shqiptarë me qëndrim jashtë vendit, si dhe zhvillimin e një metodologjie për mbledhjen e të dhënave mbi daljet dhe kthimin e shtetasve shqiptarë në Shqipëri, si dhe hyrjen e migrantëve, migracionin për qëllime punësimi dhe integrimin në tregun e punës të migrantëve të kthyer.

Njësoj si në vendet e tjera, mund të eksplorohet mundësia e krijimit të një fondi bursash për studime të mëtejshme jashtë vendit dhe pjesëmarrja në programet e shkëmbimit me kusht detyrimin e kthimit, të parashikuara edhe në Strategjinë Kombëtare për Diasporën. Shqipëria shënon një praktikë të mirë të kthimit të shtetasve me kualifikim të lartë përmes zbatimit të "Programit të Kthimit të Trurit", i cili mbështeti krijimin e stimujve të nevojshëm dhe mekanizmave të politikave kombëtare për angazhimin efektiv të Diasporës Shqiptare në zhvillimin shkencor, administrativ dhe ekonomik të vendit. Projekti synonte të kthente "rrjedhjen e trurit" të Shqipërisë dhe mbështeti Qeverinë në përgatitjen e një kuadri politikash për të trajtuar këtë çështje. U krijua një bazë të dhënash *on line* për të plotësuar kërkesën e institucioneve akademike të Shqipërisë, të administratës publike dhe të sektorit privat me ekspertizën e ofruar nga diaspora shqiptare. Ligjet dhe rregulloret u ndryshuan në lidhje me punësimin në Administratën Publike duke favorizuar të kthyerit si financiarisht, ashtu edhe me shpërblime për diplomat e fituara jashtë vendit dhe në provimet e pranimit.[56] Nisma të ngjashme të kthimit të përkohshëm, virtual ose të përhershëm të shtetasve me kualifikim të lartë mund të rezultojnë pozitive në adresimin e mungesës së aftësive në administratën publike dhe në tregun e punës në Shqipëri në përgjithësi.

Shqipëria ka një sistem kuotash[57] për menaxhimin e imigracionit të punës, i cili synon të përcaktojë aktivitetet dhe profesionet për të cilat lejohet punësimi, si dhe numri i lejeve të punës. Procesi i përcaktimit të kuotave vjetore për punësimin e imigrantëve varet shumë nga prioritetet e politikave të migracionit dhe nga situata e ndryshueshme në tregun e punës, sidomos në lidhje me punësimin sezonal. Ky proces ka pasur efekt të kufizuar dhe duhet të rishikohet për të reaguar më mirë ndaj nevojave të tregut të punës, veçanërisht në ato sektorë ku ka mungesë aftësish. Për më tepër, në të ardhmen e afërt, Shqipëria, njësoj si shumë vende fqinje të BE-së, do të duhet të marrë në konsideratë ofrimin e skemave specifike për tërheqjen e profesionistëve të huaj dhe të punëtorëve të kualifikuar në sektorët me kërkesë të lartë, përfshirë këtu edhe kombinimin e

[56] Programi u zbatua nga Këshilli i Ministrave. Partnerët kryesorë të qeverisë ishin Kabineti i Ministrave, Departamenti i Administratës Publike i Ministrisë së Brendshme, Instituti i Diasporës i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministria e Arsimit me financim të UNDP-së.

[57] Ligji nr.108/2013 "Për të huajt", në nenin 82 parashikon që brenda afatit 1 tetor të çdo viti, vendoset një kuotë vjetorë për vitin pasardhës në lidhje me punësimin e imigrantëve në Shqipëri.

lejes afatgjatë të qëndrimit dhe të punësimit.

Një politikë e ardhshme e mirë për migracionin për motive punësimi do të kërkojë që nevojat e migracionit për punë të monitorohen dhe të parashikohen rregullisht. Do të duhen vlerësime të rregullta të ndikimit aktual dhe të ardhshëm të flukseve migratore mbi vëllimin dhe strukturën e fuqisë punëtore kombëtare, së bashku me vlerësime të ndikimit të migracionit në tregjet kombëtare dhe rajonale të punës, në mënyrë që të përcaktohet qartë jo vetëm politika e migracionit për motive punësimi, por edhe nevoja për fuqi të huaj punëtore. Njësoj si në vendet e BE-së, ky proces do të kërkojë kapacitete të mira nga institucionet përkatëse të qeverisë shqiptare për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave për migracionin për motive punësimi dhe përdorimin e projeksioneve të migracionit, për të zhvilluar politika afatgjata të migracionit për motive punësimi.

Një politikë e mirë duhet të bazohet në një kuadër të mirë ligjor dhe institucional që do të mundësonte zbatimin e saj. Sistemi aktual i menaxhimit të migracionit për motive punësimi për *shtetasit shqiptarë* është mbështetur kryesisht në rolin e qeverisë në nënshkrimin dhe zbatimin e marrëveshjeve dypalëshe të migracionit për motive punësimi. Progresi i deritanishëm ka treguar kufizime të kësaj qasjeje, pasi efektiviteti i marrëveshjeve dypalëshe ka qenë i varur nga rregullat e imigracionit të vendeve të destinacionit, Greqia dhe Italia në veçanti. Politikat e reja duhet të marrin parasysh rolin në rritje të sektorit privat, përfshirë rekrutuesit dhe agjencitë e rekrutimit, si ofrues të drejtpërdrejtë të shërbimeve për migracionin për motive punësimi. Strategjia Kombëtare për Punësimin ka parashikuar zhvillimin e standardeve kombëtare për rekrutimin etik dhe të drejtë në Shqipëri, të cilat janë në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht.[58] Pas një vlerësimi të vitit 2017 mbi gjendjen e rekrutimit të punëtorëve migrantë përmes agjencive të rekrutimit, ministri i Financave dhe Ekonomisë nxori udhëzimin nr. 286, datë 21.5.2018 për disa rregulla specifike për punonjësit e përkohshëm, që punësohen nga agjencitë e punësimit të përkohshëm, i cili rregullon më tej procedurat e rekrutimit të ndjekura nga agjencitë private të rekrutimit dhe detyrimet e tyre për të raportuar rregullisht tek autoriteti qeveritar përgjegjës për punësimin. Megjithatë, ende nuk janë zhvilluar standardet kombëtare për rekrutimin etik të punëtorëve migrantë. Pasi të jetë bërë kjo, do të lindë nevoja për të siguruar zbatimin e standardeve etike të rekrutimit nga operatorët privatë përmes monitorimit periodik të aktivitetit të tyre dhe të raportimit.

- Mekanizma të efektshme për migracion sezonal dhe qarkullues

Shumica e migrantëve shqiptarë shkojnë drejt Greqisë dhe Italisë për punë sezonale. Marrëveshja midis Shqipërisë dhe Greqisë mbi "Punësimin e Punëtorëve Sezonalë" e majit 1996 përfshinte të gjitha profesionet sezonale, por në realitet zbatohej vetëm për punëtorët në bujqësi.[59] Një vlerësim i zbatimit të marrëveshjes dypalëshe në vitin 2013[60] tregoi se migracioni qarkullues zhvillohej kryesisht përmes rrugëve informale dhe përtej marrëveshjeve ndërshtetërore të punësimit. Pas liberalizimit të regjimit të vizave të BE-së për shtetasit shqiptarë në dhjetor 2010, procedura e "*metaklisit*", siç njihet ndryshe ftesa për migrantët qarkullues shqiptarë në Greqi, *de facto* është bërë inaktive. Në realitet është shfaqur një formë e re e parregullsisë, veçanërisht ajo e punësimit të parregullt qarkullues sezonal të atyre që hyjnë në Greqi në mënyrë të rregullt. Marrëveshja midis Shqipërisë dhe Italisë "Për punësimin e punonjësve sezonalë" e shkurtit 1998 u rinovua në dhjetor 2008 për të përfshirë

[58] Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) mbikëqyr rolin e agjencisë së rekrutimit dhe përpiqet që të avancojë legjislacionin dhe zbatimin e tij për rekrutimin etik të punëtorëve migrantë, qofshin ata shtetas të huaj apo shqiptarë. Në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe së fundi me Ministrinë e Diasporës, MFE ndërmerr negocimin e marrëveshjeve të reja të migracionit për punësim, si edhe për bartjen e përfitimeve sociale.

[59] Migracioni sezonal në Greqi është rregulluar nga i ashtuquajtur *metaklisi/ftesë* për punësim sezonal që u prezantua zyrtarisht nga qeveria greke në vitin 2001 (L.2910/2001) sipas një sistemi me kuota vjetore dhe në vitin 2005 (L.3386/05). Megjithatë në praktikë ky kanal nuk ka funksionuar sepse shumë punëdhënës grek që janë përpjekur të zbatojnë procedurën *metaklis/ftesë* janë zhgënjyer shumë dhe për rrjedhojë kanë hequr dorë nga kjo procedurë. Shihni: European University Institute (projekti MEITKOS): 2011, Migracioni qarkullues mes Shqipërisë dhe Greqisë: Rast studimor - projekt raport, maj 2011.

[60] Migracioni i parregullt shqiptar në Greqi: Një tipologji e krizës, Eda Gemi, ELIAMEP, 2013

protokollin e saj të zbatimit.[61] Gjatë vitit 2013, u krijua dhe u vu në zbatim një skemë pilote nga autoritetet shtetërore përkatëse,[62] megjithatë pa shumë sukses dhe nuk u përsërit më tej. Sistemi i kuotave të Italisë ka vazhduar të lejojë kuotën preferenciale të shtetasve shqiptarë për punësim sezonal dhe gjithashtu ka ndihmuar në rregullimin e statusit të qëndrimit për ata që janë me qëndrim të parregullt.

Kërkesa për zgjerimin e gjeografisë së marrëveshjeve dypalëshe të mobilitetit të punës me vende të tjera si Britania e Madhe, Franca dhe Gjermania ka qenë vazhdimisht në rritje gjatë viteve të fundit. Suksesi i ardhshëm i marrëveshjeve të reja të migracionit sezonal apo qarkullues do të mbështetet në aftësinë institucionale për të shqyrtuar me kujdes karakteristikat dhe përcaktuesit e migracionit për motive punësimi sezonal nga Shqipëria drejt vendeve të synuara, për të identifikuar problemet kyçe që lidhen me lëvizjen e parregullt në këto vende destinacioni dhe për të përdorur këtë njohuri si orientuese në procesin e negocimit për marrëveshje të reja të migracionit për motive punësimi. Është e rëndësishme gjithashtu të rishikohet fushëveprimi dhe dispozitat e marrëveshjeve dypalëshe në fuqi që rregullojnë migracionin për motive punësimi nga Shqipëria për të verifikuar që ato përmbajnë incentivë të mjaftueshme për lëvizjen qarkulluese.

Shërbimet para nisjes për migrantët e ardhshëm janë thelbësore për një politikë të efektshme të migracionit sezonal dhe qarkullues. Rrjeti i Sporteleve të Migracionit (SM) i ngritur në të gjithë vendin ofron informacione dhe orientim para nisjes për shtetasit shqiptarë që kërkojnë mundësi të rregullta punësimi jashtë vendit. Megjithatë, kapacitetet e SM-ve për përditësimin e shpeshtë të informacionit mbi mundësitë dhe rregullat e migracionit të rregullt jashtë vendit janë të kufizuara. Duhet të rriten gjithashtu edhe kapacitetet e tyre për adresimin e nevojës për informim dhe orientim të kategorive potencialisht vulnerabël. Duke pasur parasysh rolin në rritje të agjencive private të rekrutimit në lehtësimin e migracionit për motive punësimi të shtetasve shqiptarë, duhet të vendoset bashkëpunim më i fortë me ta për të identifikuar metodat e bashkëpunimit efektiv për shpërndarjen e informacionit mbi mundësitë e migracionit sezonal të sigurt dhe të rregullt.

Është e nevojshme të vlerësohet efektshmëria e dispozitave aktuale ligjore për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve sezonalë dhe adresimin e sfidave specifike të hasura në vendet kryesore të destinacionit. Ligji nr. 9668/2006 (i ndryshuar[63]) mbi emigracionin e shtetasve shqiptarë për qëllime punësimi, i cili rregullon aspektet kyçe të emigracionit të shtetasve shqiptarë dhe mbrojtjen e tyre jashtë vendit ka mbetur gjerësisht pa u zbatuar dhe duhet të rishikohet tërësisht siç tregohet në legjislacionin dytësor. Janë bërë përpjekje për të përmirësuar ndjeshëm shërbimet aktuale konsullore dhe ligjore të ofruara për punëtorët migrantë shqiptarë jashtë vendit nëpërmjet platformave *on line* të komunikimit dhe aplikimit *on line* për shërbime, si edhe për shkurtimin e kohës së marrjes së dokumentacionit të kërkuar, por nevojitet të bëhet një anketim i migrantëve dhe drejtuesve të komunitetit të migrantëve në vendet kryesore të destinacionit për të identifikuar nevojat shtesë me qëllim që të sigurohet mbrojtja e tyre maksimale jashtë vendit. Si pjesë e Mekanizmave Kombëtare për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave të Trafikimit, autoritetet shqiptare në vend dhe jashtë përdorin modele standarde të intervistimit të viktimave të mundshme. Një qasje e ngjashme mund të merret në konsideratë edhe për intervistimin e punëtorëve migrantë për të identifikuar rastet e shfrytëzimit apo diskriminimit, kur këto evidentohen nga shërbimet konsullore shqiptare jashtë vendit.

Kthimi dhe riintegrimi socio-ekonomik përbëjnë një pjesë të rëndësishme të ciklit të migracionit qarkullues. Strategjia e parë e riintegrimit nuk bëri dallim mes kthimeve vullnetare dhe të detyruara dhe u përqendrua në nevojën për të përmirësuar ofrimin e informacionit për të kthyerit dhe referimin e tyre te shërbimet e disponueshme publike, të tilla si Sportelet e

[61] Marrëveshja u miratua me *VKM nr. 866 të datës 12.08.2009 "Për miratimin e Marrëveshjes së Punës ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë".*

[62] Në bazë të një marrëveshjeje mirëkuptimi (MM) ndërmjet Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale të Republikës së Italisë dhe Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta të Republikës së Shqipërisë të nënshkruar më 19 korrik 2011

[63] Ndryshuar me ligjin nr.10389 të datës 3.3.2011.

Migracionit dhe ato private kur ishte e mundur. SM-të mundën t'i përmbushin pjesërisht këto detyra. Sportelet kanë shërbyer si qendër e rëndësishme për informimin dhe orientimin e të kthyerve për shërbimet publike dhe private, por kanë luajtur thjesht një rol lehtësues për riintegrimin. Bazuar në opinionet e të kthyerve, asistenca për orientim drejt shërbimeve publike duhet të plotësohet me mbështetje specifike për të aksesuar tregun e punës në Shqipëri, arsimin publik, trajnimin profesional, shërbimet shëndetësore dhe strehimore, si edhe për të përfituar mbështetje për të hapur një biznes. Këto çështje sugjerojnë nevojën për një analizë të thelluar të mekanizmit aktual të mbështetjes për riintegrim në vend. Në veçanti, nevojitet një ripërkufizim i qëllimit të mbështetjes për riintegrim, si edhe i kritereve të përshtatshmërisë që do të përcaktonin formën dhe përmbajtjen e programeve kombëtare qeveritare për kthimin dhe riintegrimin e migrantëve për qëllime punësimi.

Programet shtetërore gjithashtu, mund të bazohen në përvojën e ndihmës për riintegrimin e të kthyerve nga organizatat ndërkombëtare dhe aktorët e shoqërisë civile kryesisht në formën e mbështetjes për rivendosje dhe në kuadrin e programeve të kthimit të zbatuara nga vendet e BE-së. Për të adresuar këtë mangësi nevojitet vlerësimi i shkallës, kategorive dhe nevojave specifike të shtetasve shqiptarë që dëshirojnë të kthehen me anë të anketimeve, konsultimeve me diasporën dhe organizimit të aktiviteteve me punëtorët migrantë, si edhe në bazë të gjetjeve të këtij vlerësimi të përcaktohen masat dhe shtysat specifike për riintegrim dhe fushat ku kapacitetet e SM-ve duhet të forcohen më tej. Masat specifike mund të lehtësojnë krijimin e ndërmarrjeve të vogla nga të kthyerit (fondet e investimeve, ndihma juridike, huatë preferenciale). Praktika evropiane tregon se në përgjithësi vendet e origjinës përpiqen të drejtojnë potencialin e të kthyerve drejt nevojave më të gjera të ekonomisë së vendit.[64] Ashtu si me përvojat me Greqinë apo vende të tjera evropiane, Shqipëria mund të inkurajojë zhvillimin e mëtejshëm të migracionit të kthimit, duke shkuar përtej mbështetjes për riintegrim që synon vetëm nevojat themelore të të kthyerit dhe familjarëve.

Gjithashtu, programet e riintegrimit duhet të monitorojnë edhe treguesit e pjesëmarrjes në tregun e punës dhe mirëqenies ekonomike të të kthyerve dhe anëtarëve të familjeve të tyre për të identifikuar pengesat që hasen gjatë riintegrimit të kategorive të atyre që janë më në nevojë, si edhe për të ndërmarrë veprimet e duhura për t'i hequr këto pengesa. Çdo ndërhyrje në fushën e migracionit të kthimit duhet të ketë parasysh ndikimin e migracionit te zhvillimi i komuniteteve lokale, ku vendosen migrantët e kthyer. Shfrytëzimi i plotë i migracionit të kthimit ofron mundësi për zhvillim më të madh për komunitetet lokale, të shoqëruara me shërbime më të mira publike dhe private, të cilat duhet të ofrojnë stimuj të mjaftueshëm për të ndërprerë emigracionin e vazhdueshëm të të kthyerve dhe familjeve të tyre. Zhvillimi vendor gjithashtu mund të jetë një arsye e rëndësishme për të vazhduar mbajtjen e lidhjeve me vendin e destinacionit dhe përpjekjen për të eksploruar rrugët e mëtejshme për biznes ndërmjet dy vendeve përkatëse. Hartimi i planeve zhvillimore lokale do të jetë thelbësor për të lidhur migracionin me zhvillimin e Shqipërisë në të ardhmen.

Heqja e pengesave ndaj **njohjes së diplomave dhe të kualifikimeve** po aq sa edhe aftësive të fituara jashtë vendit është një faktor vendimtar për suksesin e kthimit dhe të riintegrimit në Shqipëri, si edhe për trajtimin e mungesës së aftësive në tregun kombëtar të punës. Shqipëria zbaton Kornizën Evropiane të Kualifikimeve dhe konsideron aftësitë e migrantëve për motive punësimi, kur vendos nëse do t'i pranojë ata apo jo. Ligji nr. 10247/2010 "Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve", i ndryshuar, u miratua në vitin 2010, ndërsa Lista Kombëtare e Profesioneve në bazë të Standardeve Ndërkombëtare të Klasifikimit të Profesioneve (ISCO 2008) u miratua në vitin 2009 me vendim të Këshillit të Ministrave. Deri më tani janë zhvilluar 640 përshkrime profesionale me përfaqësues të

[64] Në Greqi qeveria mori përsipër shpërndarjen e të kthyerve në zonat më pak të zhvilluara të vendit. Koser K. (2000) vëren që në rastin e Greqisë, të kthyerve që u vendosën në zonat rurale iu dha një shumë fikse me para. Një tjetër metodë e përdorur në Gjermani ishte përqendrimi i të kthyerve në sektorë të caktuar të ekonomisë, për shembull stimuj për të inkurajuar vetëpunësimin në bujqësi, tregti dhe kërkim shkencor. Por, në kontekstin e Shqipërisë përpjekjet për të promovuar investimet e të kthyerve drejt zhvillimit vendor pengohen nga mungesa e strategjive dhe planeve për zhvillimin e zonave.

biznesit dhe Agjencia Kombëtare për Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) i ka propozuar qeverisë një listë të kualifikimeve profesionale të lidhura me nivelet e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), të përbëra nga 20 fusha të kualifikimeve për nivelin e dytë të KSHK-së dhe më shumë se 100 profile të lidhura me nivelet 3-5 të KSHK-së. Për shumicën e profesioneve, Shqipëria ka një sistem akreditimi për njohjen e diplomave dhe të kualifikimeve të huaja.[65] Raporti i dytë i monitorimit për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Punësimin (2016) nënvizon përpjekjet e vazhdueshme për rishikimin e ligjit mbi Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) me qëllim përmirësimin e procesit të hartimit të kurrikulave në arsim dhe trajnim, si edhe njohjen e AFP-së në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, duke përmirësuar punësueshmërinë dhe lëvizshmërinë e punës për të diplomuarit e AFP-së. Migrantët që kthehen, sjellin një tërësi të çmuar kapacitetesh, aftësish dhe kompetencash formale dhe joformale të fituara në migracion. Është e rëndësishme që të ekzistojë një mekanizëm për të siguruar që këto të mund të zbatohen në kontekstin e Shqipërisë dhe që tregu lokal i punës të përfitojë prej tyre.

Plani Kombëtar i Veprimit për Punësim parashikon "*përzgjedhjen e organeve dhe zbatimin e procedurave për njehsimin e kualifikimeve, vlerësimin e aftësive, certifikimin dhe njehsimin / njohjen e të nxënit të mëparshëm*". Megjithatë raporti i dytë i monitorimit për zbatimin e këtij plani veprimi (2016)[66] tregon se mekanizmat për njohjen e të nxënit të mëparshëm janë përcaktuar dhe testuar në disa kualifikime, por baza ligjore ende nuk është plotësisht në fuqi. Ligji i ri i AFP-së mbështet zbatimin e procedurave për njohjen e të nxënit të mëparshëm, por nuk është i plotë pa ligjin e KSHK-së dhe aktet e tij nënligjore. Njohja e të nxënit të mëparshëm do të kontribuonte në zhvillimin e mundësive për të mësuar gjatë gjithë jetës, veçanërisht për të rriturit dhe në përmirësimin e pjesëmarrjes së tyre. Plotësimi i kuadrit ligjor do të çelte progresin e këtij aktiviteti.

Shqipëria merr pjesë në Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal (KBR/RCC) të Evropës Juglindore (EJL). KBR beson se lehtësimi i lëvizjes së lirë të njerëzve brenda rajonit mund të orientojë disa nga flukset migratore që deri më tani janë përqendruar jashtë rajonit, te lëvizshmëria brenda rajonit, e cila në vetvete duhet të kontribuojë në ruajtjen e bazës së aftësive dhe fuqisë punëtore potenciale në rajon. Si pjesë e zbatimit të Strategjisë së Zhvillimit të Evropës Juglindore 2020, KBR synon të heqë disa pengesa për lëvizshmërinë e profesionistëve, në veçanti përmes:

- marrëveshjeve rajonale për njohje reciproke të kualifikimeve profesionale në sektorë me interes të përbashkët deri në vitin 2020;
- heqjes së pengesave ndaj lëvizshmërisë së fuqisë punëtore të kualifikuar, në veçanti me anë të zhvillimit të standardeve dhe procedurave të përbashkëta për njohjen automatike të kualifikimeve akademike me cilësi të garantuar;
- heqjes së pengesave ndaj lëvizshmërisë së studentëve, kërkuesve dhe akademikëve përmes politikave, masave dhe instrumenteve të përbashkëta që synojnë rritjen e lëvizshmërisë akademike dhe kërkimore dhe bashkëpunimit në rajon dhe zhvillimit të një propozimi për Skemën e Lëvizshmërisë të Kërkuesve të Rinj të Ballkanit Perëndimor për të lehtësuar lëvizjen nga Ballkani Perëndimor dhe drejt tij deri në vitin 2020.

Në përputhje me këto objektiva, kuadri kombëtar për migracionin për motive punësimi duhet të përafrohet me atë të vendeve të Ballkanit Perëndimor për të ofruar edukim dhe trajnim profesional cilësor për të rinjtë dhe të rriturit. Nga kjo politikë përfitojnë tri kategori migrantësh, përkatësisht emigrantët potencialë, të kthyerit si edhe imigrantët.

- Politika dhe praktika për migracionin dhe zhvillimin

Kjo shtyllë e qeverisjes së migracionit është e lidhur ngushtë me politikën e migracionit për motive punësimi, i cili, kur organizohet mirë, ka potencial të lartë për të kontribuar në zhvillimin e vendit të destinacionit po aq sa edhe të vendit të origjinës. Meqenëse Strategjia e Diasporës dhe Plani i saj i Veprimit sigurojnë mbulim të mirë të të gjitha çështjeve që lidhen me migracionin dhe zhvillimin, masat e propozuara në këtë strategji dhe plan veprimi plotësojnë dispozitat e strategjisë së Diasporës.

[65] Udhëzimi i ministrit të Arsimit dhe Sporteve nr.17, datë 3.8.2016 përcakton që Shqipëria njeh diplomat që i korrespondojnë niveleve 5, 6, 7, 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve: Doktoraturë, Master, Bachelor dhe diplomë profesionale dy vjeçare. Shihni: Qeverisja e Migracionit në Shqipëri: Një Raport Vlerësimi, IOM, 2016 (f. 35, 36).

[66] F. 67

Në këtë dokument politikash janë përfshirë dy çështje kryesore në lidhje me ndikimin e migracionit te zhvillimi: remitancat dhe transferimi i tyre, si edhe investimet në Shqipëri nga këndvështrimi i zhvillimit të vendit.

- Remitancat dhe transferimi i tyre[67]

Rëndësia ekonomike e remitancave qëndron përtej asaj se çfarë sugjerojnë statistikat zyrtare të bilancit të pagesave, si për vendet dërguese, ashtu edhe për ato marrëse. Remitancat përfshijnë transferimin e "të ardhurave dhe pasurisë" monetare ose në natyrë nga punëtorët në vendin e tyre të origjinës. Transfertat monetare kontribuojnë në rritjen e drejtpërdrejtë të valutës në vendin e origjinës së migrantëve, ndërsa transfertat në natyrë kontribuojnë në rritjen e kursimeve në vendin pritës të migrantëve. Kur remitancat dërgohen nëpërmjet kanaleve zyrtare, ato regjistrohen në llogarinë rrjedhëse të bilancit të pagesave të vendit të banimit dhe të vendit pritës të migrantëve. Remitancat në natyrë janë mallra të dërguara për familjet në vendin e origjinës. Megjithatë vetëm një pjesë e tyre regjistrohen si importe, ndërkohë që shumica e pagesave[68] apo donacioneve të bëra nga migrantët rrallëherë regjistrohen si remitancë.

Gjatë viteve 2008–2017, raporti i remitancave me PBB-në në Shqipëri ishte mesatarisht 9.1%. Kjo përqindje u ul pak vetëm një herë pas krizës globale, megjithatë kjo nuk ndikoi në kontributin e rëndësishëm të këtij zëri në kuadrin makroekonomik të vendit. Ndikimi i remitancave te të ardhurat e familjeve në Shqipëri është i rëndësishëm. Banka Botërore ka vlerësuar se remitancat përfaqësojnë rreth 13% të buxhetit vjetor të familjeve në Shqipëri dhe një pjesë e konsiderueshme e remitancave është e destinuar për familjet që jetojnë në zonat rurale. Megjithatë studimet tregojnë se varësia nga dërgesat e emigrantëve mund t'i bëjë disa familje gjithnjë e më vulnerabël. Shumë familje përpiqen të dalin nga varfëria dhe të përmirësojnë standardet e jetesës me remitancat, por një përqindje e konsiderueshme e remitancave përdoret për konsum. Duke pasur parasysh se herët a vonë këto flukse të parasë do të bien, për të qenë të qëndrueshme, ato duhet të kanalizohen gjithnjë e më shumë drejt investimeve. Prandaj është thelbësore që të vazhdohet me zgjerimin dhe përmirësimin e kërkimit për mbledhjen e të dhënave për remitancat dhe analizimin e tyre, në mënyrë që politikat e reja të orientohen te transferimi i remitancave dhe përdorimi i tyre produktiv, pra për investime.

Përdorimi i kanaleve formale dhe joformale për transferimin e remitancave është një faktor i rëndësishëm për përdorimin produktiv dhe investimin e tyre, Strategjia e Diasporës dhe Plani i saj i Veprimit parashikojnë një sërë masash të rëndësishme në këtë drejtim, të cilat plotësohen nga parashikimet e kësaj strategjie sidomos në lidhje me nevojën e ndërmarrjes së anketave periodike për strategjitë financiare dhe modelet e përdorimit të instrumenteve financiare për të identifikuar boshllëkun në sistemin financiar dhe mundësitë për përmirësim në lidhje me remitancat, edukimin financiar dhe nevojën për fushata promocionale drejtuar migrantëve dhe marrësve të remitancave.

Në Shqipëri, shumica e remitancave transferohen në mënyrë joformale, pasi bankat përdoren shumë pak. Bazuar në analizën e mënyrës së dërgimit të remitancave, vlerësohet se 39% e flukseve të remitancave kanalizohen përmes kanaleve të parregulluara, ndërsa 57% përmes institucioneve financiare jobankare dhe vetëm 4% përmes bankave. Vërehet gjithashtu se remitancat në Shqipëri, edhe kur kanalizohen nëpërmjet rrugëve zyrtare të dërgimit, tërhiqen me para në dorë, duke nxitur kështu përdorimin e parave kesh në ekonominë shqiptare. Faktorët kryesorë për përdorimin e vazhdueshëm të kanaleve joformale të transaksioneve mund të jenë kombinimi i kostove të larta të transaksionit dhe përjashtimit socio-ekonomik jo vetëm të familjeve në zonat rurale, por edhe të familjeve pa njohuri financiare.

Duke pasur parasysh zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e familjeve, orientimi i remitancave përmes kanaleve zyrtare është jashtëzakonisht i rëndësishëm, sepse krijon dhe rrit aksesin në shërbimet bankare bazë për familjet që marrin remitanca nga emigrantët. Një anketim i Bankës Botërore në vitin 2016 *mbi sjelljen financiare të përfituesve të remitancave* tregon se një faktor i rëndësishëm për përfshirjen financiare të familjeve që marrin remitanca dhe kanalizimin e remitancave përmes rrugëve të rregulluara është zhvillimi i

[67] Analiza bazohet në një botim të Bankës së Shqipërisë, 2018 "Remitancat, mbështetje për zhvillim".

[68] Siç janë prim sigurimi, arsim, bileta për fluturime ndërkombëtare direkt me linjat ajrore

tregut të pagesave me pakicë të një vendi sipas standardeve ndërkombëtare. Tregu shqiptar i pagesave me pakicë përbëhet kryesisht nga bankat dhe disa institucione financiare jobankare, të cilat përqendrojnë aktivitetin e tyre kryesisht në transfertat e parave (cash-in-cash-out). Bankat dominojnë sistemin financiar me rreth 90% të totalit të aseteve të sistemit. Institucionet financiare jobankare ofrojnë alternativa të kufizuara në përdorimin e instrumenteve elektronike të pagesave.[69] Nga ana tjetër, prania e institucioneve të reja, si institucionet e parasë elektronike, është ende në një nivel të kufizuar në tregun shqiptar. Instrumentet e pagesave elektronike të ofruara nga bankat mund të përdoren gjerësisht për transfertat e dërgesave.

Kosto e ulët vlerësohet të jetë një faktor kyç për dërgimin e remitancave. Studimi i tregut të remitancave identifikon "koston" si arsyen e tretë pse bankat nuk përdoren si kanale për dërgimin e remitancave. Dy arsyet e para pse nuk përdoren bankat për të dërguar remitancat te familjarët janë: perceptimi se procedurat bankare janë të komplikuara dhe mungesa e një llogarie bankare nga individët. Kostot e dërgimit të remitancave në Shqipëri janë të larta. Më konkretisht, kostoja e dërgimit të remitancave në Shqipëri në tremujorin e parë të vitit 2018 është 8.64% e shumës totale të dërguar, duke qenë më e lartë se niveli global (7.13%) dhe mesatarja rajonale për Europën dhe Azinë Qendrore (7.55%).

Kostot e remitancave mund të reduktohen edhe më tej duke rritur nivelin e edukimit financiar të publikut. Projekti Greenback është një nismë pilote e Grupit të Bankës Botërore, me mbështetjen e Bankës së Shqipërisë, i cili zbatohet në Berat. Me qëllim edukimin financiar të emigrantëve dhe familjeve të tyre, të cilët presin remitancat, objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është rritja e efikasitetit të tregut të remitancave përmes promovimit të ndryshimit bazuar në nevojat reale të përfituesve fundorë të transfertave ndërkombëtare dhe nxitjes së bashkëpunimit ndërmjet emigrantëve dhe familjeve të tyre, ofruesve të shërbimeve të remitancave dhe autoriteteve publike.

Ndaj duhet zhvilluar produkte specifike dhe novatore, që do t'i shërbejnë emigrantëve dhe familjeve të tyre për t'iu mundësuar atyre akses në shërbimet e sistemit financiar dhe përfshirje më të madhe financiare. Banka e Shqipërisë ka evidentuar se sistemi bankar ofron shumë pak produkte që lidhen me remitancat, kryesisht transfertat bankare dhe depozitat. Ky institucion rekomandoi që bankat të rifokusonin vëmendjen e tyre në biznesin e remitancave, sepse: së pari, është me fitim për to për shkak të komisioneve; së dyti, remitancat në valutë të huaj janë një burim të ardhurash për bankat për shkak të kursit të këmbimit; së treti, bankat mund të shesin produkte të tjera që lidhen me remitancat, si emigrantëve ashtu edhe përfituesve të remitancave, p.sh. karta debiti, karta krediti dhe kredi konsumatore.

Qasja e institucioneve financiare jobankare ndaj tregut të remitancave është e ndryshme nga ajo e bankave. Këto institucione i kushtojnë më shumë vëmendje tregut të remitancave, pasi ato kanë produkte të përshtatura (të tilla si depozita me afat, kredi biznesi për familjet e emigrantëve dhe kreditë hipotekare), që u shërbejnë emigrantëve dhe familjeve të tyre dhe planifikojnë t'u shërbejnë atyre në të ardhmen me produktet që janë në përputhje me zhvillimet e reja dhe evoluimin e ciklit të zhvillimit të remitancave. Prandaj roli i tyre duhet të rritet dhe të mbështetet më tej.

- Promovimi i investimeve në Shqipëri

Sa u përket aktiviteteve ekonomike (zhvillimore) ndërkombëtare, përfshirja e diasporës shqiptare deri më tani ka qenë e kufizuar, me përjashtim të mbështetjes së ofruar gjatë konfliktit në Kosovë. Një sfidë për përfshirjen e diasporës në zhvillimin e vendit ka qenë identifikimi i duhur i grupeve të ndryshme, apo shoqatave të Diasporës për shkak të mungesës së organizimit dhe formalizimit, mungesës ose vazhdimësisë së aktiviteteve të tyre etj. Megjithatë, ka edhe grupe që janë të stabilizuara me pjesëmarrje aktive, të qëndrueshme dhe me angazhim serioz nga anëtarët e tyre. Ministri i Shtetit për Diasporën po krijon në mënyrë aktive një bazë të dhënash të të gjitha shoqatave dhe grupeve të komuniteteve shqiptare jashtë vendit

[69] Aktualisht, në tregun shqiptar ka nëntë institucione financiare jobankare të licencuara për pagimin dhe transferimin e shërbimeve, gjashtë prej të cilëve mund të konsiderohen të përfshirë në treg. Vlerësohet që remitancat kryesore janë kanalizuar kryesisht në dy nga këto institucione. Duhet theksuar që shërbimet që ofrohen aktualisht nga këto institucione nuk mbështesin përdorimin e instrumenteve elektronike të pagesave, *inter alia* si rezultat i kuadrit ekzistues ligjor dhe rregullator.

edhe nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Diasporës, të krijuar së fundmi, i cili do të përdoret gjerësisht për angazhimin e tyre në iniciativa të ndryshme për zhvillimin e vendit. Përpjekjet për të ofruar mundësinë e votimit jashtë vendit përfaqësojnë një nga incentivat e qeverisë shqiptare për nxitjen e përfshirjes së Diasporës në zhvillimin e vendit.

Angazhimi i diasporës është penguar edhe nga mungesa e informacionit të vazhdueshëm dhe të përditësuar mbi mundësitë e investimit në Shqipëri, si dhe nga ndryshimet në kuadrin ligjor dhe rregullator për të bërë biznes ose për të investuar në Shqipëri. Krijimi i Agjencisë Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve ka sjellë përmirësime të mëdha në marrjen e informacionit mbi mundësitë e investimeve, megjithatë përpjekjet e qeverisë shqiptare në këtë drejtim mund të kenë një ndikim më të madh, nëse shoqërohen me kontakte të shpeshta me rrjetet e biznesit të diasporës jashtë vendit me mbështetjen e shërbimit diplomatik shqiptar. Këto takime duhet të shërbejnë për të përcjellë informacion mbi mundësitë e investimit, po aq sa edhe për të vlerësuar nivelin e interesit për të investuar në Shqipëri nga grupet e Diasporës dhe për të identifikuar pengesat kryesore ndaj investimeve. Kjo është gjithashtu një nga objektivat kryesorë të Strategjisë Kombëtare për Diasporën dhe Planin e saj të Veprimit. Në zbatim të kësaj strategjie është miratuar ligji nr. 16/2018 "Për diasporën", ligji nr. 115/2017 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare për Diasporën", si edhe ligji nr. 32/2018 "Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës". Ky kuadër ligjor pritet të lehtësojë së tepërmi kontaktet e shpeshta me Diasporën shqiptare dhe nxitjen e angazhimit të saj në zhvillimin e vendit edhe përmes investimeve.

Angazhimi i diasporës gjithashtu mund të inkurajohet duke krijuar programe të dedikuara shtetërore për të tërhequr kapitalin njerëzor dhe financiar të anëtarëve të Diasporës dhe për ta përdorur atë për ecurinë socio-ekonomike të Shqipërisë. Në këtë drejtim, Shqipëria mund të përfitojë po ashtu edhe nga përvoja e suksesshme ndërkombëtare në angazhimin e Diasporës në zhvillimin kombëtar dhe vendor, si Qendra e Angazhimit të Diasporës në Moldavi ose programi 3x1 në Meksikë.[70] Përvoja të tilla do të bënin të mundur që qeveria shqiptare të inkurajojë transferimin e kapitalit njerëzor dhe të përvojës profesionale për zhvillimin akademik, social dhe ekonomik të Shqipërisë, si edhe krijimin e modeleve të suksesshme të gjetjes së fondeve për të mbështetur punë publike, që sjell përmirësimin e infrastrukturës së komuniteteve vendore (rrugë, shkolla, shërbime shëndetësore) dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik vendor (skemat e krijimit të punësimit etj.).

Për më tepër, kontributi i Diasporës mund të ndihmojë në projekte me interes strategjik për qeverinë shqiptare (si p.sh. në zbatimin e "Programit të Integruar për Zhvillimin Rural – Programi i 100 Fshatrave"[71]) që synojnë rritjen e investimeve në bujqësi dhe turizëm, përmes krijimit të kushteve lehtësuese, si edhe projekte të tjera që synojnë zhvillimin e agro-turizmit, rritjen dhe zhvillimin e agro-përpunimit, nëpërmjet futjes së linjave të përpunimit të prodhimeve bujqësore etj. Për më tepër Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural mund të lehtësojë për të gjithë shtetasit shqiptarë (përfshirë edhe migrantët) përthithjen e fondeve të BE-së, nëpërmjet projekteve që nxitin investimet në bujqësi, (si fondet IPARD, SARED

[70] Moldavia ka inkurajuar transferimin e kapitalit njerëzor dhe të përvojës profesionale për zhvillimin akademik, social dhe ekonomik të vendit përmes tri nënprogrameve që fokusohen në Kthimin e Profesionistëve të Diasporës, Projektet Inovative të Diasporës dhe Partneritetet Rajonale Tematike, si edhe Qendra Edukuese për Diasporën. Anëtarët ose shoqatat e ndryshme të diasporës përfitojnë grante për zbatimin e komponentëve të ndryshme të programit përmes financimit nga qeveria zvicerane. Programi 3x1 për Migrantët mbështet nismat e meksikanëve që jetojnë jashtë vendit dhe u jep atyre mundësinë për të kanalizuar burimet e tyre në punë me ndikim social, që janë direkt në përfitim të komuniteteve të tyre të origjinës në Meksikë. Projekti është zbatuar me ndihmën e klubeve ose federatave të migrantëve që jetojnë jashtë vendit, qeverisë federale (përmes SEDESOL, Sekretariati i Zhvillimit Social),shtetit dhe qeverisjes vendore. Ai përfaqëson një skemë financimi korrespondues, që do të thotë që për çdo peso të dërguar nga migrantët, qeveria federale, shtetërore dhe vendore shton 3 peso secila, duke u quajtur kështu programi 3x1. Tani programi është zgjeruar për të përfshirë edhe sektorin privat (4x1). Ky fond i mbledhur përdoret për të financuar punët publike që sjellin përmirësimin e infrastrukturës së komuniteteve vendore (rrugë, shkolla, shërbime të shëndetësisë) dhe për të promovuar zhvillimin ekonomik vendor (skema të gjenerimit të punësimit etj.).

[71] Më shumë informacion mbi këtë projekt mund të merret duke vizituar faqen http://www.bujqesia.gov.al/programi-i-integruar-per-zhvillimin-rural-programi-i-100-fshatrave-2/

etj.), uljen e TVSH-së për blerjen e makinerive bujqësore dhe inputeve, përjashtimin nga pagesa e taksës së infrastrukturës për ndërtimet e reja për subjektet e certifikuara si "Subjekt i certifikuar agroturizmi", uljen e TVSH-së në 6% për shërbimin e akomodimit dhe restorantit të ofruar nga një subjekt i certifikuar si "Subjekt i certifikuar agroturizmi" dhe aplikimin e një shkalle të reduktuar të tatimit mbi fitimin nga 15 % në 5%.

Të gjitha këto lehtësira hapin vende të reja pune, lehtësojnë investimet në bujqësi dhe blegtori, si për fermerët që ushtrojnë aktualisht aktivitetin e tyre në bujqësi, por edhe për pjesën e emigrantëve të cilët kanë vendosur të kthehen dhe të investojnë në këto sektor.

- SFERA 4. Integrimi dhe mbrojtja e të drejtave të migrantëve

Në lidhje me këtë sferë, janë të rëndësishëm elementet e mëposhtëm:

- Kuadër gjithëpërfshirës dhe jodiskriminues

Në lidhje me mekanizmat mbrojtës të zbatueshëm për migrantët, Shqipëria garanton zbatimin e një sërë të drejtash ekonomike dhe sociale të të huajve në vend. Legjislacioni shqiptar në përgjithësi është në përputhje me standardet e BE-së në lidhje me dispozitat ligjore mbi mosdiskriminimin. Barazia e të drejtave të të huajve me ato të shtetasve shqiptarë parashikohet në nenin 16 të Kushtetutës së Shqipërisë.[72] Gjithashtu, Kushtetuta i shtrin te joshtetasit një sërë të drejtash dhe lirish themelore të njeriut, sidomos barazinë dhe mosdiskriminimin.[73] Ligji nr. 10221/2010 "Për mbrojtjen kundër diskriminimit" është akt ligjor kryesor i legjislacionit shqiptar kundër diskriminimit. Po ashtu, të drejtat e migrantëve garantohen shprehimisht në disa akte ligjore[74] dhe vendime të Këshillit të Ministrave, si edhe në kuadrin rregullator në zbatim të këtyre akteve ligjore.

Shqipëria ka ratifikuar gjithashtu, shumicën e instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe konventat kryesore mbi të drejtat e migrantëve.[75] Shqipëria po zbaton me sukses shumicën e konventave ndërkombëtare për punëtorët migrantë dhe legjislacioni i brendshëm për migracionin pasqyron në përgjithësi parimet e konventave ndërkombëtare mbi të drejtat e emigrantëve.

Konventat e ratifikuara janë të detyrueshme për Shqipërinë. Si legjislacioni kombëtar, ashtu edhe praktika e autoriteteve të migracionit duhet të jenë në përputhje me to. Prandaj, disa fusha të veçanta kërkojnë vëmendje për të siguruar respektimin e plotë të konventave ndërkombëtare të ratifikuara: (1) Edhe pse

[72] "Të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë vlejnë njëlloj edhe për të huajt e për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur Kushtetuta e lidh në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare ushtrimin e të drejtave e të lirive të caktuara".

[73] Këto përfshijnë lirinë e shprehjes, lirinë e informimit, lirinë e ndërgjegjes dhe të fesë, ndalimin e torturës, ndëshkimit ose trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues, ndalimin e punës së detyruar.

[74] Kodi i Punës, ligji "për emigracionin e shtetasve shqiptarë për qëllime punësimi" (nr.9668 i datës 18.12.2005), ligji "Për të drejtën private ndërkombëtare" (nr. 10428 i datës 2.6.2011), ligji "për të huajt" (nr.108/2013 i ndryshuar); ligji "Për azilin në Republikën e Shqipërisë" (nr. 121/2014 ligji për shërbimin e huaj" (ligj nr.23/2015),

[75] Konventa e ILO-s për Migracionin për Punësim (C97), Konventa e ILO-s për Punëtorët Migrantë (C143), Konventa për Statusin e Refugjatëve dhe Protokolli i saj (1961), Konventa në lidhje me statusin e personave pa shtetësi (1954), Konventa për Reduktimin e Pashtetësisë (1961), Konventa e Vjenës për Çështjet Konsullore, Konventa për të drejtat e fëmijës, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat e Migrantëve dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre, si edhe dy Konventa të Këshillit të Evropës për të drejtat e migrantëve, përkatësisht Konventa për Statusin e Punëtorëve Migrantë dhe Konventa për Pjesëmarrjen e të Huajve në Jetën Publike në Nivel Lokal.

Shqipëria ka ratifikuar Konventën e Këshillit të Evropës për Pjesëmarrjen e të Huajve në Jetën Publike në Nivel Lokal, legjislacioni i brendshëm nuk është ndryshuar që të mundësojë disa të drejta të parashikuara nga kjo Konventë siç është e drejta për konsultime në çështjet lokale ose e drejta për të votuar në zgjedhjet lokale[76]. (2) Emigrantët shqiptarë jashtë vendit nuk mund të ushtrojnë të drejtën e tyre për të votuar për shkak të mungesës së infrastrukturës për t'ua mundësuar atyre votimin nga jashtë. (3) Sipas ligjit për të huajt, ofruesit e shërbimeve publike nuk duhet t'u ofrojnë shërbime të huajve me status të parregullt. Përjashtim bëhet vetëm për rastet e kujdesit të urgjencës. Ligji duhet të përfshijë gjithashtu edhe shkollat si një prej ofruesve të shërbimit që përjashtohen nga detyrimi për të identifikuar statusin ligjor të fëmijëve për të garantuar të drejtën e arsimimit për të gjithë fëmijët. Aktualisht ekziston rreziku që fëmijët e migrantëve me status të parregullt mund të mos e ushtrojnë të drejtën e tyre për arsim për shkak të statusit ligjor.

Një objektiv i përgjithshëm aftagjatë i qeverisjes së migracionit në Shqipëri vazhdon të jetë zgjerimi i garancive ligjore të mosdiskriminimit për të gjithë rezidentët në praktikë, pavarësisht nga statusi i tyre i qëndrimit[77]. Kjo në veçanti shërben për t'u siguruar që normat e përgjithshme të legjislacionit kombëtar, të cilat sigurojnë respektimin e standardeve ndërkombëtare, ndiqen pa asnjë diskriminim në praktikë. Në këtë kontekts, është e rëndësishme të rishikohet pozicioni aktual i punëtorëve të huaj, sidomos atyre të punësuar në mënyrë të parregullt, në lidhje me realizimin e një sërë të drejtash dhe standardesh, të parashikuara në Kodin e Punës.[78] Kjo duhet të plotësohet më tej duke u siguruar që të gjithë punëtorët migrantë, pavarësisht statusit të tyre ligjor, të paguhen plotësisht për punën e kryer.

- Zbatimi i rregullimeve për mosdiskriminimin

Është shumë vështirë të përcaktohet se deri në çfarë mase zbatohen rregulloret e mosdiskriminimit në Shqipëri. Kjo situatë pasqyron disa çështje ndërsektorialë, të cilat duhet të adresohen në mënyrë që të rritet kapaciteti i përgjithshëm i vendit për zbatim.

Së pari, nevojiten burime të përshtatshme njerëzore për të siguruar zbatimin e legjislacionit vendas dhe konventave ndërkombëtare. Kështu, rekomandohen trajnime të vazhdueshme të të gjithë nëpunësve në fushën e migracionit, sidomos atyre të policisë dhe punonjësve të kufirit, gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve si edhe punonjësve në nivel vendor, të cilët kanë të bëjnë me punëtorët migrantë. Këto duhet të ndihmojnë për të rritur njohuritë e tyre për procedurat e duhura që duhet të zbatohen për të zbuluar dhe ndjekur penalisht shkeljet ligjore nga të huajt ose në lidhje me të huajt në Shqipëri. Gjyqtarët dhe prokurorët nuk kanë njohuri të mjaftueshme mbi të drejtat e migrantëve në situata të parregullta, të parashikuara nga Konventat e ratifikuara nga Shqipëria.

Së dyti, siç rekomandohet nga Komiteti për Punëtorët Migrantë, nevojiten edhe fushata informuese për migrantët, me qëllim që të mundësohet aksesi në informacion për të drejtat e tyre dhe parimin e mosdiskriminimit të sanksionuar nga Kushtetuta Shqiptare dhe Konventat e ratifikuara. Rritja e ndërgjegjësimit për të drejtat e tyre duhet të sjellë një gatishmëri më të madhe për të raportuar rastet e shkeljeve.

Së fundi, nevojiten mekanizma më të efektshme për monitorimin e respektimit të parimit të mosdiskriminimit në lidhje me të drejtat e migrantëve. Informacioni i siguruar nga burimet zyrtare mbi zbatimin dhe respektimin e të drejtave të punëtorëve migrantë dhe grave migrante në Shqipëri mbetet i kufizuar dhe i parregullt. Gjatë viteve të fundit, Reporteri Special për Migrantët theksoi nevojën për informacionin e duhur për të kërkuar azil, kujdes më të mirë për fëmijët migrantë dhe ndihmë më të mirë me përkthimin për migrantët e parregullt që hyjnë në Shqipëri. Në këtë kontekst, kompetencat dhe kapacitetet e disa institucioneve duhet të forcohen më tej. Avokati i Popullit në

[76] Edhe pse Shqipëria ka shprehur rezerva ndaj të drejtës së votës për shtetasit e huaj siç parashikohet në Konventën për Pjesëmarrjen e të Huajve në Jetën Publike në Nivel Lokal, i është rekomanduar që të njohë këtë të drejtë për të huajt.

[77] Neni 4 i ligjit nr. 10221/2010

[78] Këto përfshijnë për shembull, të drejtën për të pasur një kontratë të shkruar në një gjuhë që e kuptojnë të dyja palët, që përcakton kushtet e pagës së drejtë dhe në kohë dhe përfitimeve si edhe respektimin e standardeve të sigurisë dhe të tjera në vendin e punës.

Shqipëri ka monitoruar dhe ka raportuar vazhdimisht mbi situatën e të drejtave të migrantëve dhe azilkërkuesve, përfshirë edhe kushtet e pritjes së imigrantëve të parregullt dhe azilkërkuesve. Ky rol duhet të vazhdohet. Për më tepër rekomandohet monitorimi dhe raportimi i procesit të zbatimit të të drejtave të punëtorëve migrantë në Shqipëri përmes krijimit të një mekanizmi specifik, i cili do t'u përgjigjej kërkesave të ICRMË-së, si edhe ngarkimi i një institucioni të veçantë me monitorimin e të drejtave të migrantëve.

- Identifikimi i migrantëve si kategori vulnerabël

Disa kategori të migrantëve, si shtetasit shqiptarë të kthyer apo edhe shtetasit e huaj me qëndrim në Shqipëri, njihen në politikat, kuadrin ligjor dhe programet shqiptare si të tillë dhe që u përkasin kategorive vulnerabël. Në veçanti, ligji për të huajt përfshin referenca për "Personat vulnerabël" të cilët janë të mitur të huaj, të mitur të pashoqëruar, persona me aftësi të kufizuar, të huajt e moshuar, gratë shtatzëna, prindërit e vetëm me fëmijë të mitur dhe persona të cilët kanë përjetuar torturë, përdhunim ose forma të tjera të dhunës psikologjike, fizike dhe seksuale. Ligji nr. 121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Social në Shqipëri" përfshin të huajt me qëndrim të ligjshëm në Shqipëri si një nga kategoritë që kanë të drejtë të përfitojnë nga këto shërbime. Ligji u drejtohet kategorive që kanë të drejtë për ndihmë shtetërore dhe ndër të tjera, viktimave të trafikimit, fëmijëve etj. Ligji përfshin edhe fëmijët që kanë nevojë për mbrojtje të veçantë, të cilët janë fëmijë të braktisur ose subjekt i shfrytëzimit, dhunës, diskriminimit etj. Në këtë kategori përfshihen edhe të miturit dhe të huajt e pashoqëruar.

Megjithatë, akte të ndryshme ligjore përmbajnë mospërputhje me përkufizimet e grupeve vulnerabël. Kjo vlen veçanërisht për grupin e të miturve të pashoqëruar, ku preken të drejtat dhe privilegjet në përputhje me Konventën për të Drejtat e Fëmijës. Për shembull, Ligji për shërbimet e kujdesit social nuk përfshin azilkërkuesin ose migrantët e parregullt si përfitues të shërbimeve sociale, gjë që ndikon në ofrimin e strehimit për të miturit e pashoqëruar që kalojnë kufirin në mënyrë të parregullt. Por sipas ligjit nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, specifikat e rasteve të fëmijëve të pashoqëruar në lëvizje që mund të hyjnë në Shqipëri sipas nenit 3/6 të këtij ligji, i përkasin kategorisë së fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Ligji për të huajt parashikon se të miturit e pashoqëruar vulnerabël duhet të strehohen në qendra të hapura, gjë kjo që kërkon krijimin një qendre për të miturit e huaj të pashoqëruar, në mënyrë që ata të mos vendosen në qendrën e mbyllur. Për më tepër, nevojiten mekanizma të dedikuara për ofrimin e kujdesit social dhe mbështetjes për fëmijët e migrantëve pa dokumente të kthyer nga vendet e destinacionit, familjet e të cilëve nuk janë identifikuar ende, ose këta fëmijë janë konsideruar të braktisur nga prindërit e tyre.

Vulnerabilitetet mund të dalin në pah edhe gjatë procesit të ndalimit të migrantëve të parregullt. Edhe pse termi "person vulnerabël" nuk përfshihet në Kodin e Procedurës Penale, ligji përfshin një të drejtë të posaçme për të huajt e ndaluar ose të arrestuar, përkatësisht e drejta për t'u informuar për të drejtën për të kontaktuar zyrën konsullore. Sidoqoftë, rekomandohet që migrantët e parregullt të ndaluar të konsiderohen si kategori vulnerabël në lidhje me ndihmën juridike në tërësi dhe prandaj atyre duhet t'u sigurohet ndihmë juridike falas gjatë kohës që janë të ndaluar. Një aspekt tjetër i rëndësishëm është ndërgjegjësimi i të ndaluarve për të drejtat e tyre përmes ofrimit të materialeve informuese që tregojnë procedurat e duhura për ankimim dhe mundësinë e ofrimit të ndihmës juridike. Për të siguruar trajtimin e duhur dhe respektimin e të drejtave të njeriut, kapacitetet kombëtare dhe lokale duhet të forcohen përmes alokimit të burimeve të duhura për procesimin e efektshëm të migrantëve dhe azilkërkuesve, në mënyrë që të garantohet *non refoulement* dhe identifikimi i shpejtë dhe efektiv i rasteve vulnerabël.[79]

Nevojat specifike të grave duhet të merren parasysh në hartimin e përgjithshëm dhe dhënien e ndihmës. Kjo kërkon së pari identifikimin e pengesave për punësimin e grave dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre nëpërmjet konsultimeve me

[79] Udhëzimi nr. 293/2015 "Për procedurat e trajtimit të të huajve me status të parregullt në Shqipëri" parashikon masa specifike për mekanizmat e përzgjedhjes dhe transferimit të viktimave të trafikimit dhe të miturve të pashoqëruar.

migrantët. Së dyti, nevojitet rishikim jo vetëm i akteve ligjore, por edhe i procedurave administrative dhe skemave të asistencës për të zbuluar pengesat ndaj përdorimit efektiv të mekanizmave të ndihmës nga gratë.

- Integrimi socio-ekonomik i migrantëve

Legjislacioni shqiptar i migracionit u jep rezidentëve të huaj afatgjatë të drejta ekonomike, shëndetësore dhe sociale me të njëjtat kushte si shtetasit shqiptarë.[80] Gjithashtu, aksesi është shtrirë te rezidentët me leje për arsye të bashkimit familjar, pasi sipas nenit 84 të ligjit për të huajt, anëtarët e familjes së rezidentëve afatgjatë që janë të gatshëm të punojnë, trajtohen njësoj si shtetasit shqiptarë. Sipas legjislacionit shqiptar, shtetasit e huaj që punojnë në Shqipëri për punëdhënësit shqiptarë dhe punëdhënësit joshqiptarë kanë të drejtën e sigurimit shoqëror, me kusht që të mos gëzojnë mbrojtje tjetër më të favorshme të sigurimeve shoqërore[81]

Shqipëria ka lidhur disa marrëveshje me vendet e tjera për mbrojtjen sociale, të cilat garantojnë transferimin e pensioneve të pleqërisë së bashku me përfitimet e tjera të sigurimeve shoqërore.[82] Ndërkohë, që numri i marrëveshjeve të lidhura kohët e fundit është rritur ndjeshëm, nevoja për të negociuar nënshkrimin e marrëveshjeve dypalëshe për mbrojtjen sociale të migrantëve me vendet kryesore pritëse është parashikuar shprehimisht në Planin e Veprimit të Diasporës, ku ato janë konsideruar vendimtare për transferimin efektiv të përfitimeve të sigurimeve shoqërore për shqiptarët e kthyer. Për këtë çështje, me urdhër nr. 43, datë 12.2.2019 të Kryeministrit, "Për caktimin e koordinatorit shtetëror për marrëveshje shtetërore në fushën e sigurimeve për shtetasit shqiptarë jashtë vendit", është përcaktuar një Koordinator Shtetëror në nivelin e zëvendësministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, i cili funksionon në kuadër të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës, si dhe raporton në mbledhjen e Komitetit Shtetëror për Diasporën (aktualisht në datën 3 maj 2019 e në vijim).

Në këtë kontekst, vlen të merret parasysh përfundimi i marrëveshjeve me vende të caktuara prioritare, si Italia dhe Greqia, që presin një numër të konsiderueshëm të migrantëve shqiptarë, shumë prej të cilëve kanë filluar të kthehen në atdhe.

Kuadri ligjor kombëtar është gjithëpërfshirës, por ka disa mangësi në sigurimin e kushteve të integrimit socio-ekonomik për të gjithë rezidentët. Për të realizuar garancitë kushtetuese për të drejta të barabarta për mbrojtje sociale (sigurime shoqërore, kujdes shëndetësor dhe të drejta të tjera sociale dhe ekonomike) për të gjithë shtetasit shqiptarë dhe imigrantët, duhet të identifikohen kategoritë e personave që nuk janë të mbuluar mjaftueshëm dhe të bëhen ndryshimet e nevojshme në legjislacionin kombëtar dhe në marrëveshjet ndërkombëtare. Këto pengesa janë të lidhura me kuadrin ligjor dhe administrativ (kushtet për marrjen e lejeve të qëndrimit nga anëtarët e familjes dhe mbajtjen e statusit të tyre të qëndrimit në rastet e vdekjes së punëtorit migrant, ose divorcit prej këtij të fundit), katalogun e të drejtave (e drejta e migrantëve të parregullt për t'u anëtarësuar në sindikata, fushëveprimi i mbrojtjes i vlefshëm për migrantët e parregullt dhe anëtarët e tyre të familjes, refugjatët dhe azilkërkuesit) dhe përshtatshmërinë për mbrojtje sociale (akses në programe dhe shërbime integrimi). Shumë nga këto çështje mund të trajtohen përmes një kombinimi të ofrimit më të mirë të informacionit, procedurave të lehtësuara dhe forcimit institucional të ofrimit të shërbimeve për migrantët.

[81] Neni 7 i ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë".

[82] Këto marrëveshje përfshijnë: Marrëveshjen për Mbrojtjen Sociale me Belgjikën që hyri në fuqi më 1 janar 2016, marrëveshjen për mbrojtjen sociale nënshkruar me Republikën Federale të Gjermanisë më 23 shtator 2015, një marrëveshje për mbrojtjen sociale nënshkruar me Republikën e Rumanisë në vitin 2015 që u ratifikua më 14 prill 2016, një marrëveshje e nënshkruar me Republikën e Maqedonisë më 17 mars 2015 ratifikuar me ligjin 123/2015, 12 nëntor 2015 dhe që ka hyrë në fuqi më 1 qershor 2016; një marrëveshje dypalëshe për transferimin e sigurimeve shoqërore nënshkruar ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës/UNSCR 1244/1999 më 5 shkurt 2015; një marrëveshje për mbrojtjen sociale me Republikën Çeke e nënshkruar më 13 tetor 2015 dhe e ratifikuar më 24 mars 2016, një marrëveshje për mbrojtjen sociale me Republikën e Hungarisë e ratifikuar me ligjin nr.151/2015 më 21 dhjetor 2015, që hyri në fuqi më 1 korrik 2016. Gjithashtu një marrëveshje me Turqinë ka hyrë në fuqi që nga 15 prilli 2005 dhe një marrëveshje me Kanadanë sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 336, të datës 22 prill 2015.

Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet atyre fushave ku janë identifikuar çështje specifike në mbrojtjen e të drejtave të disa migrantëve, veçanërisht atyre me status të parregullt. Këto janë, në veçanti, e drejta për të marrë kujdes shëndetësor dhe arsim.

E drejta për kujdes shëndetësor. Imigrantët, në varësi të statusit të tyre ligjor, gëzojnë të njëjtin status si shtetasit shqiptarë për akses në shërbimet shëndetësore të financuara nga qeveria. Të gjithë personat[83] ekonomikisht aktivë që janë me qëndrim të përhershëm në Shqipëri përdorin shërbime shëndetësore në bazë të kontributeve të tyre të detyrueshme në fondin e sigurimeve shëndetësore të shtetit.[84] Ligji për të huajt garanton kujdesin shëndetësor për të huajt e strehuar në mjedise të mbyllura të pritjes.[85] Një garanci tjetër po në këtë ligj është e drejta e ofrimit të kujdesit mjekësor për të gjitha kategorive të imigrantëve pavarësisht statusit të tyre ligjor kur gjenden në një situatë urgjente mjekësore dhe në rastet kur mungesa e kujdesit mjekësor mund të kërcënojë jetën e tyre[86].

Megjithatë, në një raport vlerësimi të kryer në vitin 2016 janë vërejtur disa vështirësi të të drejtës për kujdesin mjekësor për të huajt. Kështu, janë evidentuar mangësi në aftësinë e stafit mjekësor për të ofruar shërbime shëndetësore për të huajt në Shqipëri, duke treguar nevojën për trajnim që do t'i ndihmonte ata të kuptonin më mirë rreziqet përkatëse të shëndetit dhe përcaktuesit social të shëndetit, si edhe ndikimin që ka kultura e gjithë secilit te shëndeti dhe sëmundjet.

E drejta për arsimim. Pavarësisht statusit ligjor, të gjithë imigrantët gëzojnë të drejtën për arsimin fillor dhe të mesëm në Shqipëri.[87] Legjislacioni shqiptar garanton të drejtën e arsimit në Republikën e Shqipërisë për shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi, pa diskriminim në bazë të gjinisë, racës, ngjyrës, përkatësisë etnike, gjuhës, orientimit seksual, bindjeve politike ose fetare, statusit ekonomik apo shoqëror, moshës, vendbanimit, aftësisë së kufizuar ose shkaqeve të tjera të përmendura në legjislacionin shqiptar. Megjithatë, disa kategori migrantësh hasin vështirësi për ta gëzuar të drejtën për të marrë arsim. Në përgjithësi imigrantët dhe fëmijët e tyre duhet t'u ofrohet ndihmë për të tejkaluar pengesën gjuhësore, sepse pa të nuk mund të përdoren në mënyrë efektive shërbimet arsimore. Pengesat e tjera janë të karakterit administrativ. Mbajtësit e statusit të mbrojtjes nuk kanë regjistruar fëmijët e tyre në shkolla publike për shkak të mungesës së përkohshme të kartave të identitetit. Nga ana tjetër, megjithëse në parim e kanë të drejtën e arsimit për fëmijët e tyre, migrantët e parregullt nuk janë në gjendje të hyjnë në sistemin arsimor për shkak të mospasjes së qëndrimit të tyre të rregullt.

Programet e dedikuara të integrimit. Në strukturën aktuale institucionale, ka disa organe shtetërore që kanë përgjegjësi për integrimin social të të huajve. Sipas nenit 4, të ligjit nr. 108/2013, "*ministria përgjegjëse për punën dhe çështjet sociale, ministria përgjegjëse për arsimin dhe shkencën dhe ministria përgjegjëse për turizmin, kulturën, të rinjtë dhe sportet hartojnë dhe zbatojnë një program kombëtar të integrimit social të të huajve*". Koordinimi më i madh i aktiviteteve të tyre mund të ndihmojë në adresimin më të plotë të sfidave dhe pengesave ndaj të drejtave sociale dhe kulturore të punëtorëve migrantë dhe grave migrante në Shqipëri.

Krijimi i programeve të dedikuara të integrimit, duke marrë parasysh përvojat e ndryshme socio-kulturore të të huajve, mund të ndihmojë në bashkimin e burimeve dhe shkëmbimin e informacionit në mënyrë më të efektshme midis institucioneve të përfshira. Programet gjithashtu mund të konsiderojnë në mënyrë më të plotë nevojat e kategorive vulnerabël të të huajve (në veçanti, gratë dhe fëmijët). Hartimi i programeve të tilla duhet të marrë parasysh rezultatet e rishikimit të funksioneve të Sporteleve të Migracionit dhe institucioneve të tjera të përfshira në mekanizmin e referimit për riintegrimin që janë krijuar në kontekstin e Strategjisë së Riintegrimit. Kjo

[83] Kjo përfshin punëmarrësit, të vetëpunësuarit, familjarët e papaguar dhe persona të tjerë ekonomikisht aktivë.

[84] Neni 5, ligji nr.10383, datë 24 shkurt 2011 "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë"

[85] Neni 127, pika 2 e ligjit nr. 108/2013 "Për të huajt", i ndryshuar

[86] Neni 136, pika 2 e ligji të sipërcituar

[87] Neni 5 i ligjit nr.69/2012 për "Arsimin para universitar në Republikën e Shqipërisë".

mund të ndihmojë në vlerësimin e nismave të ndryshme të riintegrimit sektorial dhe në identifikimin e pasurive dhe kompetencave të institucioneve përkatëse.

- Statusi ligjor i qëndrueshëm i imigrantëve në Shqipëri

Në fund të fundit, çelësi për integrimin afatgjatë është perspektiva e qartë dhe transparente për status ligjor, në vijim të të cilit migrantëve u garantohet trajtim i njëjtë me atë që u ofrohet shtetasve të vendit të destinacionit. Shqipëria njeh rëndësinë e një politike migracioni të bazuar në të drejta që krijon mundësi ligjore për zgjidhjen afatgjatë dhe integrimin e plotë të atyre që kualifikohen.

- Qëndrimi afatgjatë

Një hap i rëndësishëm drejt bërjes së qëndrueshme të statusit të migrantëve është mundësia për të marrë qëndrim afatgjatë pas përmbushjes së kritereve transparente. Të gjithë të huajt që mbajnë leje qëndrimi të përkohshëm në Shqipëri kanë të drejtë të aplikojnë për një leje qëndrimi pa afat me të njëjtat kushte.[88] Aplikimi duhet të dorëzohet 60 ditë përpara mbarimit të afatit të lejes ekzistuese të qëndrimit tek autoriteti rajonal i kufirit dhe migracionit.[89] Aplikimi për leje qëndrimi afatgjatë mund të refuzohet vetëm për të huajt që vërtetohet se janë akuzuar ose dënuar për krime të kryera në Shqipëri dhe kur ekziston rreziku i kërcënimit të sigurisë kombëtare dhe rendit publik. Në rastet e refuzimit në përputhje me Kodin e Procedurës Administrative, duhet të jepet shpjegimi i arsyeve për refuzim dhe mundësia e ankimimit të vendimit në gjykatë. Statusi i qëndrimit afatgjatë është i përhershëm dhe leja rinovohet automatikisht pas shatë vjetësh. Ajo mund të revokohet vetëm nëse dokumenti është marrë nëpërmjet informacionit të rremë, mbajtësi është subjekt i largimit, përbën kërcënim për sigurinë publike ose ka jetuar jashtë vendit për më shumë se 12 muaj rresht.

Kushtet e marrjes dhe ndërprerjes së qëndrimit afatgjatë përgjithësisht janë në përputhje me praktikat ndërkombëtare, por aplikantët duhet të ndërgjegjësohen për kuptimin e saktë të kushteve dhe specifikave të kërkesave formale. Me përjashtim të rasteve të kërcënimit të vërtetë ndaj rendit publik dhe sigurisë kombëtare, aplikantëve duhet t'u jepet informacion i plotë për arsyet e refuzimit të kërkesës dhe informacion i mjaftueshëm se si të plotësohet kërkesa për riaplikim. Në rast të përfundimit të statusit për arsye që nuk lidhen me sigurinë (p.sh. për shkak të mungesës tepër të gjatë në territor), duhet të jepen mundësi për riaplikim pasi të eliminohen arsyet për refuzim. Në raste të tilla, rekomandohet të konsiderohen lidhjet me Shqipërinë (statusi familjar dhe kohëzgjatja e qëndrimit) si rrethana lehtësuese në vendimet për largimin nga territori.

- Shtetësia

Sipas nenit 6 të ligjit nr. 8442, datë 21.1.1999, "Për shtetësinë shqiptare", natyralizimi, pas lindjes dhe adoptimit[90] është një formë e fitimit të shtetësisë shqiptare, e cila është e hapur për të gjithë aplikantët e rritur, të huaj. Kërkesat kryesore janë periudha e qëndrimit të ligjshëm prej pesë vjetësh dhe zotërimi i nivelit bazë të gjuhës shqipe.[91] Legjislacioni lehtëson natyralizimin e bashkëshortëve të shtetasve shqiptarë dhe të fëmijës kur një prej prindërve të tij është shqiptar. Për më tepër, kushtet lehtësohen për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare.[92] Kërkesa depozitohet në Ministrinë e Brendshme, e cila është e detyruar të vendosë nëse do t'ia përcjellë kërkesën Presidentit të Republikës brenda 6 muajve, pas së cilës Presidenti nxjerr një dekret me të cilin jepet shtetësia. Në rast se Ministria e Brendshme vendos të mos e përcjellë kërkesën te Presidenti, ajo duhet të informojë aplikantët të cilët kanë të drejtë të ankohen në gjykatë.

[88] Përjashtimet përfshijnë të huajt që studiojnë në Shqipëri, punëtorët sezonalë, aplikantët ose përfituesit e mbrojtjes së përkohshme ose që janë azilkërkues përpara se të merret vendimi për kërkesën e tyre.

[89] Neni 61 i ligjit nr. 108//2013 për të huajt.

[90] Një fëmijë bëhet automatikisht shqiptar, nëse një nga prindërit është shqiptar. Nëse prindërit nuk janë shtetas shqiptarë, por janë me qëndrim të ligjshëm në Shqipëri, fëmija i lindur në Shqipëri mund të bëhet shtetas shqiptar nëse këtë gjë e kërkojnë të dy prindërit.

[91] Gjithashtu aplikantët nuk mund të jenë dënuar për një vepër penale që sanksionohet me deri në tre vjet burg ose pranimi i tyre në Shqipëri mund të përbëjë kërcënim për sigurinë publike dhe mbrojtjen kombëtare.

[92] Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.554/2013 "Për kriteret dhe procedurat e fitimit të shtetësisë shqiptare nga personat me origjinë shqiptare me përjashtime të shtetasve të Kosovës".

Megjithëse vendimi përfundimtar është diskrecionar, është e rëndësishme që procedura e shqyrtimit të jetë transparente, duke ofruar mundësi të vërteta për ankimim të efektshëm. Në veçanti, aplikanti duhet të njoftohet për çdo vonesë në shqyrtim dhe, nëse është e nevojshme, duhet t'i jepet mundësia për të ofruar prova të nevojshme në mbështetje të kërkesës. Standardet e shqyrtimit nga Ministria e Brendshme duhet të zvogëlojnë rastet e interpretimit arbitrar të shkaqeve formale për pranimin e kërkesës. Është sidomos e nevojshme që aplikantët të informohen sipas rastit për interpretimin e kriterit të qëndrimit të pandërprerë në vend. Rezultati negativ i shqyrtimit nga Ministria duhet të rezultojë në lëshimin e një njoftimi me shkrim, i cili, me përjashtim të shkaqeve të sigurisë publike dhe mbrojtjes kombëtare, duhet të përfshijë një shpjegim të detajuar të arsyeve për refuzim me referenca ligjore dhe faktike.

Ashtu si në procedura të tjera, marrja e shtetësisë duhet të marrë parasysh mirëqenien e fëmijëve si një grup veçanërisht vulnerabël. Shqipëria ka ratifikuar Konventën për Punëtorët Migrantë dhe Anëtarët e Familjes së tyre, e cila parashikon që çdo fëmijë i punëtorëve migrantë ka të drejtën e shtetësisë pavarësisht statusit të migracionit. Ndërsa, siç u përmend më lart, çdo fëmijë i lindur në vend, madje edhe nga prindër të huaj me qëndrim të ligjshëm ose nga prindër të panjohur, mund të fitojë shtetësinë shqiptare. Ligji për shtetësinë nuk mbulon fëmijët e migrantëve të parregullt, të cilët përndryshe do të mbeteshin pa shtetësi. Prandaj është e domosdoshme që, duke trajtuar këtë çështje, autoritetet shqiptare të përafrojnë legjislacionin kombëtar me konventat ndërkombëtare të ratifikuara në lidhje me shtetësinë dhe eliminimin e pashtetësisë, me qëllim që të garantohet që asnjë fëmijë të mos privohet nga mundësia për të fituar një shtetësi, duke shmangur kështu mospasjen e asnjë shtetësie.

- Bashkimi familjar

Shqipëria lejon bashkimin familjar të të gjithë migrantëve në kategoritë e vizave ose të qëndrimit, gjë kjo që është në përputhje me Direktivën e BE-së për bashkimin familjar. Ligji nr. 108 / 2013 "Për të huajt", u jep të drejtën e bashkimit familjar bashkëshortëve të shtetasve shqiptarë, si edhe fëmijëve nën kujdesin e tyre (neni 55), anëtarëve të familjes së imigrantëve të ligjshëm (neni 56) ose refugjatëve (neni 58).[93] Lejet e qëndrimit lëshohen nga autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin. Ligji parashikon mundësinë e lejes së qëndrimit të pavarur, por vetëm pas 5 vjetësh të qëndrimit në vend sipas rregullave të bashkimit familjar.

Në të njëjtën kohë, Komiteti Ndërkombëtar i Migrantëve ka vënë në dukje se ligji nuk parashikon rinovimin e lejes së qëndrimit për anëtarët e familjes së një punëtori migrant në rast divorci ose në rast vdekjeje të punëtorit migrant.[94] Për të përafruar legjislacionin e brendshëm me nenin 50 të Konventës për të Drejtat e Migrantëve dhe Anëtarëve të Familjes,[95] është e nevojshme që ligji për të huajt të garantojë të drejtat e familjeve të punëtorëve të vdekur ose të punëtorëve migrantë të divorcuar. Në veçanti, autoritetet duhet të marrin parasysh interesin më të lartë të fëmijëve kur vendosin për anulimin e lejes së qëndrimit të të huajit kur familja shpërbëhet. Nëse nuk jepet një autorizim i tillë, anëtarëve të familjes duhet t'u jepet kohë e arsyeshme para nisjes, që të rregullojnë punët e tyre në shtetin e punësimit.

Ndonëse ligji për të huajt nuk i referohet shprehimisht të drejtës të anëtarëve të familjes për punësim, ata gëzojnë të drejta të barabarta në tregun e punës si shtetasit, si mbajtës të lejeve përkatëse të qëndrimit. Po sipas nenit 70 të ligjit të sipërcituar rezidentët afatgjatë gëzojnë të drejta ekonomike, shëndetësore dhe sociale të njëjta me shtetasit shqiptarë, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Sipas nenit 84 për nevojat e tregut të punës për të punësuarit, anëtarët e huaj të

[93] Gjithashtu, të gjitha dispozitat përkatëse në lidhje me aplikimin për bashkim familjar, procedurën e bashkimit si edhe të drejtat e anëtarëve të familjes së refugjatëve janë përcaktuar në nenin 63, 64, 65, 67 të ligjit për azilin.

[94] Neni 34 i ligjit për të huajt parashikon që "l*eja* e qëndrimit nuk rinovohet nëse arsyet për të cilat është dhënë nuk ekzistojnë më, për shembull, martesa është zgjidhur". Anëtari i familjes gëzon të drejtën për leje qëndrimi të pavarur vetëm pas 5 vitesh qëndrimi në Shqipëri. Në rastin e vdekjes së sponsorit, anëtarët e familjes mund të kenë një rezidencë të pavarur pas 3 vitesh qëndrimi në Shqipëri.

[95] Sipas Konventës, Shteti i punësimit konsideron që t'u japë anëtarëve të familjes së atij punëtori migrant që qëndron në atë shtet një autorizim qëndrimi në bazë të bashkimit familjar. Shteti i punësimit merr parasysh kohëzgjatjen e qëndrimit të tyre në atë shtet.

familjes të shtetasve shqiptarë që janë të gatshëm të punojnë, trajtohen njësoj si shtetasit shqiptarë. Anëtarëve të huaj të familjes të shtetasve shqiptarë u jepet përparësi ndaj imigrantëve të tjerë për plotësimin e vendeve të lira të punës. Në këtë drejtim, neni 84 parashikon gjithashtu që vendet e lira të punës së pari plotësohen nga personat që kanë aftësitë dhe kualifikimet e kërkuara dhe janë të gatshëm të punojnë në vendin e lirë të punës, duke përfshirë anëtarët e huaj të familjes të shtetasve shqiptarë. Neni 85 parashikon që lejet e punës për anëtarët e familjes të shtetasve shqiptarë duhet të lëshohen me prioritet dhe pa referencë në tregun e punës.

Është e këshillueshme që në legjislacionin për të huajt të specifikohen të drejtat e anëtarëve të familjes së të huajve në Shqipëri, sidomos e drejta për arsim, trajnim profesional, punësimin dhe ndihmë sociale. Për më tepër, në përputhje me rekomandimet e Komitetit për Punëtorët Migrantë, të nxjerra në vitin 2010, është thelbësore që të monitorohet zbatimi i të drejtës së anëtarëve të familjes për të mbajtur lejen e qëndrimit. Megjithatë, siç u përmend më lart, statusi i qëndrimit të anëtarëve të familjes varet nga lidhja me mbajtësin kryesor të lejes, duke e bërë pozitën e anëtarëve të familjes të pambrojtur në rast vdekjeje ose divorci.

PJESA II
VIZIONI, OBJEKTIVAT E POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË TË STRATEGJISË

2.1 Vizioni dhe objektivi i politikave të strategjisë

Vizioni i Strategjisë Kombëtare për Migracionin, i frymëzuar nga proceset e migracionit global po aq sa edhe procesi i integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, është që deri në vitin 2022 të ofrohet përgjigje gjithëpërfshirëse dhe e plotë ndaj sfidave dhe mundësive të migracionit në kontekstin e Shqipërisë. Në përputhje me këtë vizion, qeveria shqiptare ka përcaktuar si qëllimin e kësaj politike:

"Qeverisjen e efektshme të migracionit në Shqipëri për të trajtuar sfidat që rezultojnë nga lëvizjet migratore dhe për të rritur ndikimin e migracionit te zhvillimi në të mirë të migrantëve dhe shoqërisë".

Ky objektiv do të arrihet përmes politikave koherente dhe të bashkërenduara të cilat i përgjigjen: nevojës për ndërtimin e një kuadri të qëndrueshëm ligjor dhe institucional për qeverisjen e migracionit, nevojës për të vazhduar forcimin e reagimit ndaj migracionit të parregullt nga, në dhe përmes Shqipërisë drejt Bashkimit Evropian, sfidave që lindin nga flukset e përziera të popullatave dhe nevojës për të siguruar mbrojtjen e duhur, nevojës për përmirësimin e qeverisjes së migracionit për motive punësimi; nevojës për promovimin e mëtejshëm të lidhjeve ndërmjet emigracionit të shtetasve shqiptarë me zhvillimin kombëtar dhe vendor të vendit, sfidat dhe mundësitë për ndërtimin e një kuadri të qëndrueshëm për integrimin e punëtorëve migrantë të huaj dhe anëtarëve të familjeve të tyre në Shqipëri.

Strategjia Kombëtare për Migracionin përqendrohet në katër prioritete strategjike, si më poshtë:

PJESA III
OBJEKTIVAT SPECIFIKË TË STRATEGJISË DHE PRODUKTET KRYESORE

Kushti themelor për qeverisjen e efektshme të migracionit në Shqipëri është të sigurohet një kuadër i qëndrueshëm politik, ligjor dhe institucional për qeverisjen e migracionit. Ky do të jetë gjithashtu edhe objektivi kryesor i strategjisë. Një kuadër i qëndrueshëm politikash do të bëjë që politikat e migracionit të integrohen mirë në politikat sektoriale dhe ndërsektoriale, për aq sa ato janë në përputhje me dokumentet strategjike gjithëpërfshirëse, si Strategjia Kombëtare për Migracionin, SKZHI-ja dhe procesi i anëtarësimit në BE. Përmirësimi i mbledhjes dhe analizimit të të dhënave për migracionin do të jetë një objektiv kryesor për të siguruar që kuadri i politikave të bazohet në fakte. Përveç kësaj, Shqipëria do të mbetet një partner aktiv në proceset rajonale, si edhe në proceset globale për migracionin dhe për të siguruar përkthimin e angazhimeve ndërkombëtare në fushën e migracionit në veprime konkrete. Objektivat specifikë dhe produktet e tyre kryesore janë si më poshtë:

A. Garantimi i qeverisjes strategjike të migracionit në Shqipëri

Përafrimi ligjor me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare dhe përmirësimi i kapaciteteve institucionale (si individualisht, ashtu edhe nëpërmjet koordinimit të shtuar) përbëjnë një prioritet strategjik për qeverinë shqiptare. Realizimi i tij është thelbësor për arritjen e progresit thelbësor në të gjitha shtyllat e politikës së qeverisjes së migracionit. Pritet që, si rezultat, kuadri ligjor dhe institucional të jetë në përputhje me praktikat më të mira evropiane, duke rritur aftësinë e organeve shtetërore shqiptare për të formuar partneritete efektive në qeverisjen e migracionit. Progresi në këtë fushë është gjithashtu me rëndësi thelbësore për ta bërë qeverisjen e migracionit më transparentë dhe të aftë për t'iu përgjigjur emergjencave në mënyrë fleksibël. Ky objektiv strategjik do të realizohet nëpërmjet objektivave specifikë të mëposhtme që do të prodhojnë rezultatet në vijim:

A. Garantimi i qeverisjes strategjike të migracionit në Shqipëri	
A1. Përafrimi i kuadrit ligjor kombëtar me kuadrin ligjor të BE-së dhe ndërkombëtar për qeverisjen e migracionit	A1.1 Miratimi dhe zbatimi sistematik i termave, normave dhe standardeve ndërkombëtare në fushën e migracionit
A2. Rritja e kapaciteteve institucionale për qeverisjen e migracionit	A2.1 Qartësimi i kompetencave të institucioneve & agjencive kryesore shqiptare dhe identifikimi i kapaciteteve të tyre për qeverisjen e migracionit
	A2.2 Përmirësimi i mbledhjes, analizimit dhe ndarjes së të dhënave për migracionin
A3. Përmirësimi i mekanizmave të koordinimit për qeverisjen e migracionit	A3.1 Përmirësimi i koherencës horizontale dhe vertikale përmes koordinimit të përmirësuar operacional dhe strategjik
A4. Forcimi i partneriteteve për qeverisjen e migracionit	A4.1 Rishikimi i partneriteteve ekzistuese institucionale për migracionin dhe formulimi i partneriteteve të reja

B. Garantimi i migracionit të rregullt nga, përmes dhe drejt Shqipërisë

Menaxhimi i integruar i kufirit dhe i migracionit ka marrë një pozicion qendror në përpjekjet e Shqipërisë për të reduktuar lëvizjen e parregullt në të gjithë kufijtë e saj dhe brenda territorit. Ky objektiv bazohet në angazhimet ekzistuese, me qëllim rritjen e efektivitetit të mekanizmave të kontrollit për pranimin, qëndrimin dhe lëvizjen transit të sigurt dhe të rregullt të të huajve dhe kthimin dhe riintegrimin e shtetasve shqiptarë. Ajo njeh rëndësinë e shpërndarjes së përshtatshme të burimeve për të përballuar sfidat e rrjedhave të migracionit në zhvillim dhe për të zhvilluar dhe forcuar mekanizmat e bashkëpunimit me autoritetet e vendeve të origjinës dhe destinacionit të emigrantëve.

Ky objektiv strategjik do të realizohet nëpërmjet objektivave specifikë të mëposhtëm:

B. Garantimi i migracionit të sigurt dhe të rregullt nga, përmes, dhe drejt Shqipërisë	
B1. Trajtimi në mënyrë të efektshme i lëvizjeve të parregullta në kufijtë e shtetit dhe në brendësi të territorit të Shqipërisë	B1.1 Përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës në kufijtë e shtetit dhe brenda territorit për të forcuar kontrollin e migracionit duke ruajtur të drejtat e migrantëve.
	B1.2 Sigurimi i eficiencës së punonjësve të kufirit
	B1.3 Përdorimi i procedurave të hyrjes dhe qëndrimit si instrumente të efektshme për parandalimin dhe reduktimin e migracionit të parregullt
	B1.4 Minimizimi i rasteve të qëndrimit të parregullt dhe transitimit me anë të kontrollit të ligjshmërisë së qëndrimit, masave për shkeljen e provuar të ligjshmërisë të qëndrimit dhe ofrimit të informacionit
B2. Përmirësimi i efektshmërisë së mekanizmave të kthimit në vendin e origjinës për shtetasit e huaj	B2.1 Kthimi i suksesshëm i shtetasve të huaj në vendet e tyre të origjinës përmes ripranimit dhe kthimit vullnetar
B3. Reagimi me efikasitet ndaj migracionit të parregullt të shtetasve shqiptarë në vendet anëtare të BE-së	B3.1 Sigurimi i zbatimit të masave të duhura për parandalimin e migracionit të parregullt të shtetasve shqiptarë
	B3.2 Mbështetja për kthimin dhe riintegrimin e shtetasve shqiptarë të ripranuar
B4. Menaxhimi i flukseve të përziera	B4.1 Zhvillimi i kuadrit strategjik dhe operacional për të përballuar sfidat e flukseve të përziera drejt Shqipërisë

C. Zhvillimi i politikave të efektshme për migracionin për motive punësimi duke rritur ndikimin pozitiv të migracionit te zhvillimi socio-ekonomik kombëtar dhe vendor

Migracioni i punës i shtetasve shqiptarë do të mbetet një faktor kryesor i zhvillimit të vendit. Aplikimi i një kombinimi masash është i nevojshëm për të reduktuar migracionin e parregullt, për të mbrojtur të drejtat e migrantëve dhe për të maksimizuar kontributin e përgjithshëm pozitiv të migrimit ekonomik në mirëqenien vendore dhe kombëtare. Ky objektiv synon të integrojë më mirë politikën e migracionit në menaxhimin e tregut kombëtar të punës duke ofruar stimuj për kthimin e punëtorëve në sektorët në nevojë, duke shfrytëzuar më mirë aftësitë e të kthyerve dhe duke promovuar përdorimin produktiv të remitancave dhe kontributet e tjera të emigrantëve. Furnizimi i emigrantëve të ardhshëm me informacion të plotë mbi të drejtat dhe mundësitë e tyre është veçanërisht e rëndësishme për lehtësimin e formave të rregullta të migracionit për motive punësimi (qarkullues dhe sezonale) dhe për inkurajimin e kthimit në tregun shqiptar të punës.

Ky objektiv strategjik do të realizohet nëpërmjet objektivave specifikë të mëposhtëm që do të sjellin këto rezultatet:

C. Zhvillimi i politikave të efektshme për migracionin për motive punësimi duke rritur ndikimin pozitiv të migracionit te zhvillimi socio-ekonomik kombëtar dhe vendor	
C1. Sigurimi i kuadrit të efektshëm të politikave të migracionit për motive punësimi	C1.1 Konsiderimi i dinamikave të migracionit të shtetasve shqiptarë në zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave kombëtare të punësimit
	C1.2 Përpilimi dhe zbatimi i politikave dhe skemave proaktive që synojnë të tërheqin shtetas shqiptarë, anëtarë të diasporës shqiptare, dhe të huaj me aftësi dhe kualifikime, për të cilat oferta është e ulët në tregun shqiptar të punës
	C1.3 Monitorimi i rregullt dhe parashikimi i nevojave për migracionin për motive punësimi
	C1.4 Krijimi dhe zbatimi i kuadrit rregullator dhe institucional për migracionin për motive punësimi
C2. Lehtësimi i migracionit sezonal dhe qarkullues për shtetasit shqiptarë	C2.1 Të njihen në vazhdimësi dinamikat e migracionit qarkullues dhe sezonal dhe të krijohet kuadri rregullator
	C2.2 Nxitja e bashkëpunimit ndërkombëtar për migracionin e punës
	C2.3 Sigurimi i ofrimit të shërbimeve përpara nisjes për punëtorët migrantë shqiptarë të mundshëm
	C2.4 Forcimi i kapaciteteve institucionale për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve migrantë
	C2.5 Lehtësimi i kthimit dhe riintegrimit socio-ekonomik të shtetasve shqiptarë
C3. Maksimizimi i ndikimit të migracionit te zhvillimi kombëtar dhe vendor	C3.1 Promovimi i kanalizimit formal dhe përdorimit produktiv të remitancave
	C3.2 Promovimi i investimit në Shqipëri

D. Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të migrantëve dhe integrimit të tyre

Shtylla e fundit e qeverisjes së migracionit përqendrohet në sigurimin e kushteve të favorshme për integrimin afatgjatë të migrantëve në Shqipëri. Kjo do të realizohet përmes identifikimit të sfidave aktuale me të cilat përballen shtetasit e huaj në ushtrimin e të drejtave të tyre të garantuara nga legjislacioni shqiptar dhe përmes propozimit të masave specifike për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Në veçanti, në këtë shtyllë njihet nevoja e rritjes së ndërgjegjësimit të migrantëve për të drejtat e tyre dhe lehtësimin e aksesit të tyre në forma të ndryshme të mbështetjes apo të shërbimeve. Vëmendje e veçantë i kushtohet reduktimit të pengesave për gëzimin efektiv të të drejtave nga kategoritë më vulnerabël, si emigrantët femra, fëmijët dhe të rinjtë.

Ky objektiv strategjik do të realizohet nëpërmjet objektivave specifikë të mëposhtëm që do të sjellin këto rezultatet:

D. Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të migrantëve dhe integrimi i tyre në vend	
D1. Garantimi i një kuadri gjithëpërfshirës jodiskriminues që mbron në mënyrë të efektshme të drejtat e migrantëve	D1.1 Shtrirja e garancive ligjore të mosdiskriminimit te të gjithë personat që qëndrojnë në territor
	D1.2 Ndërgjegjësimi i imigrantëve për të drejtat e tyre dhe procedurat për zbatimin e tyre
	D1.3 Përmirësimi i efektivitetit dhe monitorimit të mekanizmave të mbrojtjes
D2. Identifikimi i migrantëve si kategori vulnerabël për programimin dhe ofrimin e asistencës	D2.1 Dhënia e asistencës së përshtatur për të përmbushur nevojat specifike të fëmijëve dhe të të rinjve
	D2.2 Trajtimi i nevojave specifike të migrantëve
D.3 Përmirësimi i kushteve të integrimit kulturor dhe socio-ekonomik të migrantëve (për shtetasit shqiptarë dhe të huaj)	D3.1 Garantimi i të drejtës të barabartë për sigurime shoqërore
	D3.2 Dhënia e të drejtës për strehim, kujdes shëndetësor dhe edukim
	D.3.3 Hartimi dhe zbatimi i programeve të dedikuara të integrimit
D4. Ofrimi i zgjidhjeve të qëndrueshme për imigrantët	D4.1 Lehtësimi i fitimit të qëndrimit afatgjatë dhe bërja e statusit të qëndrueshëm
	D4.2 Ofrimi i një rruge të qartë drejt shtetësisë
	D4.3 Garantimi i statusit ligjor të familjarëve

PJESA IV
BURIMET FINANCIARE

Ky kapitull trajton në mënyrë të përmbledhur burimet financiare, që janë të nevojshme për zbatimin e planit të veprimit për "Strategjinë Kombëtare për Migracionin". Kostoja e përgjithshme e përllogaritur për zbatimin e masave nga të gjitha burimet e financimit, është rreth 341.25 milionë lekë ose afërsisht 2.7 milionë euro[96]. Burimet nga buxheti i shtetit janë të alokuara në programet buxhetore të Ministrive të linjës dhe të institucioneve që janë përgjegjëse për zbatimin e planit të veprimit.

Alokimi i fondeve për periudhën 2019–2021 është programuar duke mbajtur në konsideratë tavanet përfundimtare të projektbuxhetit afatmesëm (PBA 2019–2021). Burimet financiare nga buxheti i shtetit mbulojnë rreth 73.7% të kostos së strategjisë, përkatësisht rreth 251.3 milionë lekë. Ndërsa burimet e financimit të angazhuara nga donatorët mbulojnë 0.8% të kostos së strategjisë ose 2.76 milionë lekë.

Hendeku financiar i pambuluar nga buxheti është 25.53%. Ai është pjesë e kërkesave buxhetore shtesë dhe e bisedimeve me donatorë të ndryshëm. Kostot kryesore janë për aktivitete plotësuese, si vlerësime dhe studime të pavarura, fushata informimi, projekte për rritjen e kapaciteteve pritëse për migrantët dhe programe pilote për integrimin e kategorive vulnerabël të migrantëve.

Shpenzimet e nevojshme për zbatimin e PKV-së janë nxjerrë duke kostuar më vete secilën nga nënmasat e planit të veprimit. Në llogaritjen e shpenzimeve totale është marrë në konsideratë kohështrirja e masës, numri i përfituesve për aktivitete të caktuara etj. Kostimi i Planit të Veprimit është realizuar bazuar në praktikën e planifikimit buxhetor.

Tabela 1 paraqet buxhetin në vite sipas objektivave strategjikë. 59.6% e shpenzimeve që nevojiten për objektivin strategjik B.

[96] Kursi i këmbimit: 1 Euro = 125 lekë

Tabela 1. Buxheti sipas objektivave strategjikë për periudhën 2019–2022

PËRSHKRIMI	Buxheti 2019-2022				
OBJEKTIVAT, AKTIVITETET	VITI 2019	VITI 2020	VITI 2021	VITI 2022	TOTALI
Objektivi strategjik A: Garantimi i qeverisjes strategjike të migracionit në Shqipëri	3,872,000.00	7,489,000.00	4,446,000.00	4,446,000.00	20,253,000.00
Objektivi strategjik B: Garantimi i migracionit të sigurt dhe të rregullt nga, përmes, dhe drejt Shqipërisë	61,698,000.00	45,764,000.00	46,445,000.00	49,520,520.00	203,427,520.00
Objektivi strategjik C: Zhvillimi i politikave të efektshme për migracionin për motive punësimi duke rritur ndikimin pozitiv të migracionit tek zhvillimi socio-ekonomik kombëtar/lokal	936,000.00	33,007,000.00	20,098,000.00	20,623,000.00	74,664,000.00
Objektivi strategjik D: Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të migrantëve dhe integrimit të tyre	6,935,400.00	11,267,200.00	12,109,480.00	12,589,480.00	42,901,560.00
TOTAL (1+2+3+4+5)	**73,441,400.00**	**97,527,200.00**	**83,098,480.00**	**87,179,000.00**	**341,246,080.00**

Tabela 2 paraqet buxhetin sipas burimeve të financimit dhe hendekun financiar për secilin nga objektivat specifikë

Tabela 2: Kostimi i zbatimit të planit të veprimit sipas objektivave 2019–2021

Objektivat strategjikë dhe nënobjektivat të mbuluar nga dokumenti strategjik	Kosto totale (në lekë)	Financimi		Hendeku financiar	Komente për objektivat me hendek financiar
		Buxhet	Donatorët		
TOTALI	**341, 246,080**	**251,329,520**	**2,760,000**	**87,156,560**	
Objektivi strategjik A: Garantimi i qeverisjes strategjike të migracionit në Shqipëri	**20,253,000**	**10,383,000**	**300,000**	**9,570,0000**	
A.1 Përafrimi i kuadrit ligjor kombëtar me kuadrin ligjor të BE-së dhe ndërkombëtar për qeverisjen e migracionit	1,100,100	800,000	0	300,000	Planifikohet një vlerësim i pavarur për zbatimin e konventave; mund të financohet nga donatorët
A.2 Rritja e kapaciteteve institucionale për qeverisjen e migracionit	14,110,000	4,840,000	0	9,270,000	Projekt i ri për menaxhimin e të dhënave për migrantët; Kërkohet më shumë personel për sektorin e monitorimit të strategjisë; konsulenca për seminare dhe hartim modulesh trajnimi
A.3 Përmirësimi i mekanizmave të koordinimit për qeverisjen e migracionit	2,010,000	1,710,000	300,000	0	
A.4 Forcimi i partneriteteve për qeverisjen e migracionit	3,033,000	3,033,000	0	0	
Objektivi strategjik B: Garantimi i migracionit të sigurt dhe të rregullt nga, përmes dhe drejt Shqipërisë	**203,427,520**	**161,127,520**	**0**	**42,300,000**	
B.1 Trajtimi në mënyrë të efektshme i lëvizjeve të parregullta në kufijtë e shtetit dhe në brendësi të territorit të Shqipërisë	110,304,000	110,304,000	0	0	
B.2 Përmirësimi i efektshmërisë së mekanizmave të kthimit për shtetasit e huaj	3,400,000	3,400,000	0	0	
B.3 Reagimi me efikasitet ndaj migracionit të parregullt të shtetasve shqiptarë në vendet anëtare të BE-së	67,846,000	39,046,000	0	28,800,000	
B.4 Menaxhimi i flukseve të përziera	21,877,520	8,377,520	0	13,500,000	Projekt për rritjen e kapaciteteve pritëse të emigrantëve (2020)

Objektivi strategjik C: Zhvillimi i politikave të efektshme për migracionin për motive punësimi duke rritur ndikimin pozitiv të migracionit te zhvillimi socio-ekonomik kombëtar dhe vendor	**74,664,000**	**53,304,000**	**2,160,00**	**19,200,000**	
C.1 Krijimi dhe zbatimi i kuadrit rregullator dhe institucional për migracionin për motive punësimi	41,358,000	38,958,000	0	2,400,000	Vlerësim nevojash
C.2 Lehtësimi i migracionit sezonal dhe qarkullues për shtetasit shqiptarë	21,561,000	6,961,000	0	14,600,000	Vlerësim; skemë për mbështetjen e bizneseve, projekt i ri në 2020
C.3 Maksimizimi i ndikimit të migracionit te zhvillimi kombëtar dhe lokal	11,745,000	7,385,000	2,160,000	2,200,000	Anketa, konsultime
Objektivi strategjik D: Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të migrantëve dhe integrimit të tyre	**42,901,560**	**26,515,000**	**300,000**	**16,086,560**	
D.1 Garantimi i një kuadri gjithëpërfshirës jodiskriminues që mbron në mënyrë të efektshme të drejtat e migrantëve	13,335,960	5,549,400	0	7,786,5000	Hendeku kryesisht për fushata informimi; krijimin i një njësie në Inspektoratin e Punës (2021-2022)
D.2 Identifikimi i migrantëve si kategori vulnerabël për programimin dhe ofrimin e asistencës	6,772,000	6,772,000	0	0	
D.3 Përmirësimi i kushteve të integrimit kulturor dhe socio-ekonomik të migrantëve (shtetas shqiptarë dhe të huaj)	14,479,600	6,179,600	0	8,300,000	Program pilot për integrimin e kategorive vulnerabël të shtetaseve të huaj
D.4 Ofrimi i zgjidhjeve të qëndrueshme për imigrantët	8,314,000	8,014,000	300,000	0	

PJESA V
LLOGARIDHËNIA DHE MONITORIMI

Do të krijohet një sistem i dyfishtë monitorimi, i cili do të mbulojë realizimin e objektivave specifikë në të gjitha shtyllat e propozuara të strategjisë, si edhe përmirësimin e koordinimit të përgjithshëm të aktiviteteve. Ky kapitull përshkruan kornizën institucionale dhe operacionale të nevojshme për monitorimin efektiv të zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit.

Progresi në arritjen e objektivave të Strategjisë do të matet përmes një sërë treguesish, të lidhur me objektiva dhe masa specifike, siç përcaktohet në Planin e Veprimit. Përgjegjësia për monitorimin e përfundimit në kohë të secilës masë dhe sipas parashikimit, do të qëndrojë me një institucion qeveritar udhëheqës, i caktuar për çdo masë, përjashtuar rastet, kur kjo është e parashikuar ndryshe[97]. Institucioni udhëheqës do të përcaktojë nëntreguesit e detajuar, do të përcaktojë formatin dhe procedurat për raportimin dhe mbajtjen e komunikimit të rregullt me të gjitha agjencitë përgjegjëse për atë masë. Një person kontakti në institucionin udhëheqës do të jetë përgjegjës për hartimin e raporteve të rregullta në bazë të të dhënave standarde, të mbledhura nga agjencitë çdo tremujor.

Në Sektorin e Migracionit në Ministrinë e Brendshme do të krijohet një strukturë horizontale, që do të quhet Sekretariati Teknik. Kjo strukturë do të ndjekë monitorimin e progresit duke u siguruar që ai të jetë gjithëpërfshirës, që të mbulojë të gjitha shtyllat e Strategjisë dhe Planit të Veprimit, që është i përditësuar dhe që mbështetet në informacion aktual dhe standard. Sekretariati do të bashkërendojë aktivitetet monitoruese të të gjitha agjencive udhëheqëse, duke mbledhur raporte tremujore me qëllim harmonizimin, identifikimin e mangësive të të dhënave dhe analizën e tendencave. Sekretariati do të prezantojë një plan për dorëzimin e raporteve, si edhe do të sigurojë asistencë teknike për pikat e kontaktit, duke sqaruar metodologjinë.

Gjithashtu, do të integrojë kontributet e ndryshme që do të sjellin agjencitë udhëheqëse në një raport progresi gjashtëmujor mbi zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit, i cili do t'i dorëzohet një Komiteti Teknik të Migracionit të udhëhequr nga Zëvendësministri i Brendshëm dhe i përbërë nga Drejtorët e Departamenteve në secilën ministri apo institucion të caktuar me përgjegjësinë e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Migracionin. Raporti do të përfshijë rekomandime të hollësishme, duke trajtuar çështjet e reja në zbatimin e masave të veçanta.

Komiteti Teknik do të caktojë Sekretariatin Teknik për të bashkërenduar aktivitetet me qëllim përgatitjen e draftit të raportit njëvjeçar që do të mbulojë të gjitha masat e përcaktuara në Strategjinë dhe Planin e Veprimit, duke ofruar diagnozën e çështjeve dhe rekomandime për masa korrigjuese. Raporti më pas do t'i dorëzohet një Grupi Drejtues për Migracionin.

Grupi Drejtues për Migracionin do të jetë organ konsultativ me funksion mbikëqyrjen e progresit të përgjithshëm në arritjen e objektivave të politikave strategjike të migrimit dhe përmirësimin e mekanizmave të bashkërendimit. Grupi Drejtues do të përfshijë zëvendësministra, duke përfaqësuar institucionet e përfshira në zbatimin e Strategjisë dhe do të mblidhet të paktën një herë në vit për të miratuar drejtimet e përgjithshme të aktiviteteve në përmbushjen e Strategjisë, do të propozojë modifikime të planit të aktiviteteve dhe të hartojë propozime specifike për rishikimin e fushëveprimit të masave ekzistuese, si edhe miratimin e masave shtesë. Grupi Drejtues do të marrë parasysh tendencat ndryshuese të migracionit, situatën e buxhetit dhe ndikimin e strategjive të tjera qeveritare. Grupi Drejtues mund t'i paraqesë Këshillit të Ministrave rekomandime specifike nga mbledhjet e tij. Të paktën dy herë në vit do të organizohen takime periodike me aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile dhe aktorë të tjerë të përfshirë në çështjet migratore për të rishikuar progresin e arritur dhe për të forcuar bashkëpunimin mes institucioneve qeveritare dhe atyre joqeveritare për zbatimin e strategjisë.

[97] Në disa raste, institucionet joqeveritare, si Avokati i Popullit, do të drejtojnë zbatimin e disa masave specifike.

Rishikimi afatmesëm i Planit të Veprimit

Periudha e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit do të jetë 2019-2022. Në përfundim të dy viteve të para të zbatimit, mund të parashikohet një rishikim afatmesëm i Planit të Veprimit për të marrë në konsideratë tendencat e migracionit dhe për të përshtatur planifikimin buxhetor me planifikimin afatmesëm të qeverisë. Puna për rishikimin afatmesëm do të udhëhiqet nga Komiteti Teknik për Migracionin. Procedura e miratimit për Planin e rishikuar të Veprimit do të bëhet siç parashikohet me ligj dhe siç zbatohet në fillimin e kësaj Strategjie dhe Plani Veprimi. Rishikimi afatmesëm do të parashikojë të paktën një raund konsultimesh me shoqërinë civile dhe aktorë të tjerë në fushën e migracionit.

PLAN VEPRIMI PËR STRATEGJINË KOMBËTARE PËR MIGRACIONIN 2019 - 2022

Lista e akronimeve

ADISA	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara
AIDA	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve
AKD	Agjencia Kombëtare e Diasporës
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BSH	Banka e Shqipërisë
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DBE	Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri
DKM	Departamenti i Kufirit dhe i Migracionit
GNP	Grupi ndërinstitucional i Punës
KVA	Kthim Vullnetar i Asistuar
IKSSH	Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore
INSTAT	Instituti i Statistikave
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
KBR	Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal
MASR	Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë
MB	Ministria e Brendshme
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MSHD	Ministri i Shtetit për Diasporën
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MTM	Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
PSHSH	Policia e Shtetit Shqiptar
SM	Sportel Migracioni
SHKP	Shërbimi Kombëtar i Punësimit

Objektivi Specifik A: Garantimi i qeverisjes strategjike të migracionit në Shqipëri							Treguesit e Rezultateve: përafrimi 100% i kuadrit ligjor kombëtar me kuadrin ligjor të BE-së dhe atë ndërkombëtar për migracionin; niveli i duhur i stafit për të siguruar zbatimin e suksesshëm dhe koordiniminin e qeverisjes së migracionit; numri i partneriteteve të reja me aktorët joqeveritarë për mirëqeverisjen e migracionit	
Nr.	Nënobjektiv	Masat që duhet të merren	Afati kohor	Burimet financiare në Lek	Njësia përgjegjëse		Rezultatet & Treguesit	
					Agjencia kryesuese	Së bashku me	Rezultatet	Treguesit e Performancës
C2	**Lehtësimi i migracionit sezonal dhe qarkullues për shtetasit shqiptarë**	**C2.1 Të njihen në vazhdimësi dinamikat e migracionit qarkullues dhe sezonal dhe efektiviteti i kuadrit rregullator** a. të kryhet (të kontraktohet) një studim për karakteristikat dhe përcaktuesit e migracionit për punësim sezonal/qarkullues të shtetasve shqiptarë, si edhe për të identifikuar problemet kryesore që lidhen me lëvizjen e parregullt në vendet kryesore të destinacionit (sidomos mekanizmat e rekrutimit, kushtet e punës, standardet e shëndetit dhe të sigurisë, pagat dhe përfitimet dhe garancitë kundër shfrytëzimit)	2020	1,400,000	MFE	INSTAT MB IOM	Të ketë përfunduar raporti për karakteristikat dhe përcaktuesit e migracionit për punësim sezonal për të identifikuar problemet kryesore që lidhen me lëvizjen e parregullt në vendet kryesore të destinacionit; dhe gjetjet dhe rekomandimet të jenë ndarë me aktorët përkatës	Masa në të cilën miratohen si rekomandimet e raportit, ashtu edhe veprimet e ndërmarra për të lehtësuar migracionin sezonal të shtetasve shqiptarë
		b. të mundësohet konsultimi institucional dhe ai publik mbi gjetjet dhe rekomandimet e studimit, dhe të reflektohen ato në të gjitha politikat ekzistuese apo legjislacionin që rregullon migracionin sezonal/qarkullues për motive punësimi	2020-2022	684,000	MFE	MB IOM	Të jetë kryer konsultimi institucional dhe ai publik mbi gjetjet dhe rekomandimet e studimit	Masa në të cilën gjetjet dhe rekomandimet e studimit janë reflektuar në politikat dhe legjislacionin që rregullon migracionin sezonal/qarkullues për motive punësimi
		b. të rishikohet efektiviteti i dispozitave aktuale ligjore për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve migrantë shqiptarë dhe për trajtimin e sfidave specifike të hasura në vendet kryesore të destinacionit	2020	190,000	MFE	IOM	Të ketë përfunduar rishikimi i efektivitetit të dispozitave aktuale ligjore për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve sezonalë shqiptarë në vendet kryesore të destinacionit	Masa në të cilën miratohen nga autoritetet rekomandimet e raportit dhe veprimet e ndërmarra për të lehtësuar migracionin sezonal të shtetasve shqiptarë
		C2.2 Nxitja e bashkëpunimit ndërkombëtar për migracionin e						

		punës a. të rishikohet qëllimi dhe dispozitat e marrëveshjeve dypalëshe në fuqi që rregullojnë migracionin për motive punësimi nga Shqipëria për të verifikuar nëse ato përmbajnë stimuj të mjaftueshëm për lëvizje qarkulluese	2020	304,000	MFE	MEPJ IOM	Të ketë përfunduar rishikimi i të gjitha marrëveshjeve dypalëshe; të dhënat për stimujt për lëvizje qarkulluese të jenë mbledhur dhe ndarë me aktorët përkatës	Numri i stimujve për lëvizje qarkulluese të identifikuara në marrëveshje dypalëshe
		b. të identifikohen vendet prioritare me të cilat duhet të lidhen marrëveshje të reja për migracionin për motive punësimi, që mbulojnë migracionin qarkullues	2020	76,000	MEPJ	MFE SHKP	Të jetë përpiluar një listë me vendet prioritare për marrëveshje të reja dypalëshe	Numri i marrëveshjeve të reja dypalëshe për punë të iniciuara nga autoritetet shqiptare
		c. të lidhen marrëveshje me vendet e përzgjedhura të destinacionit, që ofrojnë skema pilot me stimuj për lëvizje qarkulluese	2020	380,000	MEPJ	MFE MSHD	Të jenë lidhur marrëveshjeve të reja për migracionin qarkullues	Numri i shtetasve shqiptarë që përfitojnë nga marrëveshje të reja/ekzistuese çdo vit; përqindja e migrantëve meshkuj/femra
		C2.3 Sigurimi i ofrimit të shërbimeve përpara nisjes për punëtorët migrantë shqiptarë të mundshëm a. të ofrohet informacion mbi mundësitë aktuale për migrim të rregullt për motive punësimi në vendet anëtare të BE-së përmes krijimit dhe përditësimit të një faqeje interneti dhe hartimit të paketave informative	2019-2022	2,000,000	MFE	IOM GIZ	Të jetë krijuar faqja e internetit për mundësitë e rregullta të migrimit dhe të jetë përgagtitur paketa informative; të ketë përditësimtë vazhdueshëmtë përmbajtjes së faqes së internetit	Numri i vizitorëve të faqes së internetit Numri i paketave informative të shpërndara
		b. të ofrohet trajnim për stafin e Sporteleve të Migracionit për orientim para nisjes, duke pasur	2019-2022	1,000,000	MFE	DKM/MB IOM	Të jetë kryer me sukse trajnimi i stafit të SM-ve për orientimin e	Numri i nëpunësve të SM-ve të trajnuar çdo vit për orientim para nisjes dhe për

		parasysh nevojat e grupeve më vulnerabël				Other actors	migrantëve dhe për mbrojtjen e të drejtave të tyre	të drejtat e migrantëve;
		b. të forcohet bashkëpunimi me institucionet homologe në vendet e destinacionit për transferimin e praktikave të mira për dhënien e informacionit migrantëve (vizita studimore, ndarja e materialeve etj)	2019-2022	1,500,000	SHKP	MFE	Të jetë vendosur bashkëpunimi me institucionet homologe në vendet e destinacionit për transferimin e praktikave të mira për dhënien e informacionit migrantëve	Numri i praktikave të mira ndërkombëtare për ofrimin e informacionit migrantëve, të cilat janë marrë dhe përdorur për të përmirësuar ofrimin e shërbimit në SM
		C2.4 Forcimi i kapaciteteve institucionale për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve migrantë a. të rishikohet qëllimi dhe efektiviteti i shërbimeve aktuale konsullore dhe ligjore që u ofrohen punëtorëve migrantë shqiptarë me anë të një anketimi të migrantëve dhe të komuniteteve kryesore të migrantëve në vendet kryesore të destinacionit' të merren masa për t'iu përgjigjur nevojave të identifikuara si rritja e burimeve njerëzore, rritja e buxhetit etj.	2020 -2022	1,000,000	MEPJ	MFE INSTAT IOM	Të jetë kryer vlerësimi në vendet kryesore të destinacionit për migrantët shqiptarë Burimet njerëzore/financiare në shërbimin konsullor shqiptar të jenë përshtatur sipas nevojës së identifikuar	Në shërbimin konsullor shqiptar janë bërë ndryshime për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve për punëtorët shqiptarë jashtë dhe për t'i mbrojtur ata Numri i stafit të ri të rekrutuar/në sportelet e shërbimit konsullor shqiptar jashtë vendit në bazë të nevojave aktuale; % e rritjes sëbuxhetit të konsullatave për të siguruar ofrimin më të mirë të shërbimeve për shtetasit shqiptarë

		b. të hartohen udhëzime standarde për shërbimin konsullor për intervistimin e punëtorëve migrantë që të identifikohen rastet e shfrytëzimit ose diskriminimit kur ato provohen	2021-2022	228,000	MEPJ	MFE MSHD IOM	Të jenë hartuar udhëzime standarde për intervistimin e punëtorëve migrantë për të identifikuar rastet e shfrytëzimit ose të diskriminimit	Numri i punëtorëve migrantë shqiptarë të intervistuar sipas udhëzimeve të reja dhe numri i rasteve të shfrytëzimit ose të diskriminimit të identifikuara dhe të referuara te shërbimet përkatëse
		C2.5 Lehtësimi i kthimit dhe riintegrimit socio-ekonomik të shtetasve shqiptarë a. të vlerësohet shkalla, kategoritë dhe nevojat specifike të shtetasve shqiptarë që dëshirojnë të kthehen me anë të anketimeve, konsultimeve me diasporën dhe organizimit të aktiviteteve me punëtorët migrantët	2020	1,500,000	MEPJ	MSHD MFE IOM	Të jenë kryer vlerësime periodike për shkallën, kategoritë dhe nevojat specifike të shtetasve shqiptarë që dëshirojnë të kthehen	Popullata e të kthyerve të mundshëm dhe nevojat e identifikuara për riintegrim
		b. të ndërmerret një rishikim i thelluar i funksionimit të mekanizmit të riintegrimit për shtetasit shqiptarë dhe partneriteteve me shoqërinë civile dhe aktorë të tjerë; të rekomandohen veprime që përmirësojnë bashkërendimin institucional në lidhje me riintegrimin	2019	475,000	MFE	MSHMS MB MSHD MASR MBZHR IOM Organizata të shoqërisë civile	Të jetë kryer një rishikim i thelluar mbi funksionimin e mekanizmit të riintegrimit për shtetasit shqiptarë; dhe të jenë kryer veprime që përmirësojnë bashkërendimin institucional për riintegrimin	Masa në të cilën role dhe përgjegjësi të qarta mbi rrintegrimin e të kthyerve u janë caktuar pushtetit qëndror dhe atij lokal si dhe aktorëve të tjerë; 20% rritje e numrit të të kthyerve që përfitojnë nga mbështetja për rrintegrim çdo vit; % e përfituesve meshkuj dhe femra

		c. të përpilohen dhe të publikohen paketa informuese për shërbimet e riintegrimit dhe kontaktet e ofruesve të shërbimeve; t'u shpërndahen ato shtetasve shqiptarë në pikat e kalimit të kufirit dhe zyrat e shtetit	2020	1,000,000	MFE/SHKP	DKM/MB MBZHR AIDA Ministri të tjera të linjës Institucione të pushtetit lokal Aktorë të tjerë joqeveritarë	Fletëpalosje/paketa për shërbimet e riintegrimit të jenë prodhuar dhe shpërndarë çdo vit	Numri i shtetasve shqiptarë që informohen çdo vit për shërbimet e SM-ve;% e përfituesve meshkuj dhe femra
		d. të merren masa specifike që lehtësojnë krijimin e bizneseve të vogla nga të kthyerit (fonde investimi, ndihmë juridike, hua preferenciale) në kuadër edhe të veprimtarisë së Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës	2021-2022	10,000,000	MFE	AIDA MSHD/ Fondi Shqiptar për zhvillimin e Diasporës	Të jetë krijuar fondi i investimit, ndihmës juridike dhe huave preferenciale për të kthyerit	Numri i shtetasve shqiptarë të kthyer që u është dhënë informacion për shërbimet e SM-ve çdo vit; % e atyre që paraqiten në SM dhe që kërkojnë shërbimet prej tyre Numri i masave ligjore dhe programatike të marra për të hequr barrierat ndaj riintegrimit të efektshëm të të kthyerve
		e. të përpilohen standarde dhe procedura të përbashkëta për njohjen automatike të kualifikimeve akademike në kuadër të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (KBR) të Evropës Juglindore	2021 -2022	456,000	MASR	MEPJ	Të jenë përpiluar standarde dhe procedura të përbashkëta për njohjen automatike të kualifikimeve akademike në kuadër të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal të Evropës Juglindore	Numri i shtetasve shqiptarë që përfitojnë çdo vit nga njohja e kualifikimeve në kontekstin e bashkëpunimit KBR; Të dhëna për përdorimin e standardeve nga autoritetet shqiptare;
		f. të bashkëpunohet me sektorin	2020 -2022	684,000	MFE	Në	Të jenë hartuar	Numri i modeleve të testimit

		privat dhe shkollat profesionale në Shqipëri për zhvillimin e testeve standarde, që konfirmojnë përftimin e aftësive profesionale që njihen, për ata persona që nuk kanë arsimin formal në një fushë të caktuar				konsultim me ministri të tjera të linjës	modelet për testet për aftësitë profesionale dhe kualifikimet për fushat përkatëse	të miratuara për përdorim Numri i shtetasve shqiptarë që përfitojnë çdo vit nga njohja e kualifikimeve të tyre
		g. të negociohen dhe të nënshkruhen marrëveshje bashkëpunimi me vendet kryesore të destinacionit për shtetasit shqiptarë në fushën e trajnimit profesional dhe njohjes së përbashkët të çertifikatave të trajnimit	2020 -2022	684,000	MASR	MFE MEPJ MD Koordinatori Shtetëror Komitetit Shtetëror për Diasporën	Të jenë nënshkruar marrëveshje të reja bashkëpunimi me vendet kryesore të destinacionit për shtetasit shqiptarë në fushën e trajnimit profesional dhe njohjes së përbashkët të certifikatave të trajnimit	Numri i marrëveshjeve të nënshkruara; numri i studentëve që përfitojnë çdo vit
C3	**Maksimizimi i ndikimit të migracionit në zhvillimin kombëtar dhe vendor**	**C3.1 Promovimi i kanaleve formale dhe përdorimi produktiv të remitancave** a. të ndërmerren anketa periodike për strategjitë financiare dhe modelet e përdorimit të instrumenteve financiare për të identifikuar boshllëkun në sistemin financiar dhe mundësitë për përmirësim në lidhje me remitancat	deri në fund të 2020	6,500,000	BSH	INSTAT Banka Botërore	Të jenë kryer anketa periodike që ofrojnë të dhëna mbi: a) karakteristikat e flukseve të familjeve dhe format e përdorimit, (b) lidhja ndërmjet modeleve të remitancave dhe modeleve të migracionit, (c) ndikimi i remitancave te kursimet, akumulimi i kapitalit fizik, edukimi, oferta e punës dhe pabarazia e	Përqindja e remitancave të dërguara përmes kanaleve formale në raport me totalin e përllogaritur të remitancave

							të ardhurave; d) instrumentet financiare të përdorura për remitancat.	
		b. të rritet aksesi në shërbimet bankare dhe ato financiare për dërgimin e remitancave përmes: - nxitjes së konkurrencës nëpërmjet aktorëve të rinj, promovimit të novacionit e cila do të reflektohet në shërbime efikase si nga pikëpamja e komisioneve, ashtu edhe të kohës së procesimit të dërgesave; rritjen e kushteve të transparencës dhe mbrojtjen e konsumatorit nëpërmjet miratimit të " Ligjit për shërbimet e pagesave në Republikën e Shqipërisë"; - edukimit financiar dhe fushatave promocionale drejtuar migrantëve dhe marrësve të remitancave duke përfshirë këtu dhe zbatimin e projektit *Greenback* në Berat dhe në varësi të rezultateve, replikimit në qarqe të tjera të vendit	2018 -2022	1,400.000 Greenback është projekt i financuar nga SECO, ndaj nuk mbart kosto direkte për BSH	BSH	MEPJ Shoqata e bankave Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare	Të jetë mundësuar rritja e aksesit në shërbime bankare përmes një sërë masash;	Volumi vjetor i remitancave të dërguara në Shqipëri përmes sistemit bankar dhe jobankar. Rritja e nivelit të kulturës financiare; njohja, përdorimi dhe zotërimi i produkteve financiare; niveli i përfshirjes financiare. Numri i familjeve shqiptare që përfitojnë nga zbatimi i projektit Greenback në edukim financiar në Berat dhe në rrethe të tjera, nëse do të replikohet

		c. të inkurajohen institucionet e tregjeve financiare për të zhvilluar produkte specifike dhe novatore për migrantët dhe familjet e tyre përmes konsultimeve periodike.	2019 -2022	760.000	BSH	Shoqata e Bankave AIDA Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ALSE Akademia (universitetet)	Të jenë organizuar konsultime periodike me institucionet e tregjeve financiare për zhvillimin e produkteve specifike dhe novatore për migrantët dhe familjet e tyre	Numri i institucioneve financiare të krijuara për të lehtësuar transferimin e remitancave dhe shërbimeve të lidhura me to në zonat rurale. Numri i konsultimeve të zhvilluara; numri dhe tipologjia e produkteve novatore të nxjerra nga institucionet e tregut financiar për migrantët dhe familjet e tyre çdo vit
		C3.2 Promovimi i investimeve në Shqipëri a. të zhvillohen dhe të përditësohen vazhdimisht materialet *on line* dhe *off line* për mundësitë aktuale të investimit në Shqipëri në bazë të informacionit të mbledhur nga autoritetet vendore	2020	114,000	MFE	AIDA IOM	Të jenë përgatitur materiale informuese për mundësitë aktuale të investimit në çdo rajon ; të përditësohen ato rregullisht	Numri i materialeve informuese për mundësitë aktuale të investimit në çdo qark të publikuara online dhe offline dhe të shpërndara mes komuniteteve shqiptare jashtë vendi çdo vit
		b. të kryhen anketa dhe konsultime të rregullta me sipërmarrësit shqiptarë që qëndrojnë jashtë vendit në vendet kryesore të destinacionit për të matur nivelin e interesit të tyre për investime në Shqipëri dhe për të identifikuar pengesat kryesore	anketa e 1rë deri në vitin 2020 Anketime të tjera çdo 3 vjet	1,200,000	AIDA	MEPJ INSTAT MFE MSHD MBZHR IOM	Të jetë identifikuar në mënyrë periodike niveli i interesit të diasporës për investime në Shqipëri; të jenë diskutuar mes palëve të interesuara barrierat kryesore dhe gjetjet e evidentuara	Numri i masave të marra për të hequr barrierat për të investim komuniteti i diasporës shqiptare në Shqipëri, numri dhe vlera e investimeve çdo vit dhe % e rritjes vjetore

		c. të ofrohen kushte të lehtësuara për të vendosur kontakte mes bizneseve me sipërmarrësit shqiptarë (dhomat e biznesit të diasporës, regjistrat e biznesit të diasporës)	2021 -2022	1,000,000	MEPJ		Qeveria e Shqipërisë të ketë përcaktuar stimuj për bashkëpunim mes bizneseve	Lloji dhe numri i kushteve lehtësuese të krijuara; Numri i bizneseve të diasporës dhe atyre të regjistruara në Shqipëri që kanë hyrë në bashkëpunim çdo vit, vëllimi i investimit në vend përmes bashkëpunimit mes bizneseve.
		d. Të angazhohen grupet e ndryshme të diasporës në zhvillimin kombëtar dhe vendor, përmes projekteve të hartuara posaçërisht për këtë qëllim	2020 -2022	171,000	MFE	MSHD MBZHR IOM	Të jenë identifikuar dhe propozuar për financim nga qeveria projekte/nisma për angazhimin e grupeve të diasporës në zhvillimin kombëtar dhe vendor të Shqipërisë	Numri i diasporës së angazhuar në projekte të zbatuara; numri i shtetasve që përfitojnë çdo vit; masa në të cilën nismat adresojnë nevojat vendore/kombëtare për zhvillim

Objektivi Specifik D: Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të migrantëve dhe integrimi i tyre							Treguesiit e rezultateve: % rritje mes popullatës së migrantëve që tregojnë ndërgjegjësim për të drejtat e tyre dhe kërkojnë zbatimin e legjislacionit; numri i rasteve të shkeljeve kundër punëtorëve të huaj që janë zbuluar dhe hetuar nga autoritetet shtetërore; numri i migrantëve dhe familjarëve të tyre që fitojnë statusin e rezidentit afatgjatë dhe shtetësinë çdo vit	
Nr.	Nënobjektiv	Masat që duhet të merren	Afati kohor	Burimet financiare /000 Lek	Njësia përgjegjëse		Rezultatet & Treguesit	
					Agjencia kryesuese	Së bashku me	Rezultatet	Treguesit e Performancës
D1	**Garantimi i një kuadri ligjor gjithëpërfshirës e jodiskriminues që mbron në mënyrë të efektshme të drejtat e migrantëve**	**D1.1 Shtrirja e garancive ligjore të mosdiskriminimit te të gjithë personat që qëndrojnë në territor** a. të kryhet një rishikim i plotë i situatës së zbatimit të instrumenteve ndërkombëtare në lidhje me ndikimin e tyre te pozicioni i shtetasve të huaj, si edhe të evidentohen boshllëqet specifike për mbrojtjen e këtyre individëve. Në veçanti të konsiderohet parashikimi në legjislacionin vendas i disa të drejtave për shtetasit e huaj, siç parashikohen edhe në Konventën për Pjesëmarrjen e të Huajve në Jetën Publike në Nivel Vendor	2019-2022	1,520,000	MB	Në bashkëpunim me një Grup Pune Ndërinstitucional	Të jetë rishikuar zbatimi i instrumenteve ndërkombëtare në lidhje me ndikimin e tyre te pozicioni i shtetasve të huaj; me palët e interesuara të jenë ndarë rekomandimet për trajtimin e boshllëqeve në lidhje me mbrojtjen e tyre Dokumenti i Bardhë mbi pasojat e dhënies së të drejtave shtesë të huajve në kuadrin ligjor shqiptar	Numri i akteve ligjore/administrative për të trajtuar boshllëqet në përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare për të mbrojtur shtetasit e huaj Dokumenti i Bardhë paraqitur në Këshillin e Ministrave me rekomandime specifike ligjore
		b. të kryhet vlerësimi i nevojave për rregullimin e marrëdhënieve të punës që përfshin të huajt e punësuar individualisht në Shqipëri, sidomos të konsiderohet shtrirja e garancive të Kodit të Punës (përfshirë kërkesën për të lidhur një marrëveshje me shkrim	deri në fund të 2020	114,000	MFE	MEPJ MB SHKP/MFE	Të jetë hartuar një listë me nevoja për të rregulluar marrëdhëniet e punës për punëtorët e huaj në Shqipëri dhe lista t'u jetë shpërndarë me palët e interesuara	Numri i akteve ligjore/administrative të miratuara për të rregulluar më mirë marrëdhëniet e punës për punëtorët e huaj bazuar në gjetjet për vlerësimin e nevojave

		me punëtorët e huaj, dhënien e garancive për pagimin e rrogës në kohë dhe respektimin e standardeve të sigurisë) te të gjithë punëtorët migrantë të punësuar në Shqipëri						
		c. të merren masa për të siguruar që punëtorëve migrantë t'u kryhet pagesa e plotë për të gjithë punën e kryer prej tyre, pavarësisht statusit të tyre ligjor; të përcaktohet një procedurë për t'i vënë këto masa në zbatim për punëtorët e parregullt.	2021 -2022	304,000	MFE	Grup Pune Ndërinstitucional	Të jenë propozuar ndryshimet ligjore (nëse nevojiten) administrative dhe procedurale që prezantojnë të drejtën e pagës për punën e kryer nga punëtori migrant	Ndryshimet ligjore (nëse nevojiten), procedurale/ administrative të miratuara në parlament dhe numri i punëtorëve migrantë që përfitojnë çdo vit
		D1.2 Ndërgjegjësimi i imigrantëve për të drejtat e tyre dhe procedurat për zbatimin e tyre a. të zhvillohen fushata informimi te të huajt për zbatimin e normave mosdiskriminuese dhe për procedurat për zbatimin e të drejtave të tyre; të vihet në dispozicion në gjuhët kryesore të përdorura nga migrantët informacioni për shërbimet e ofruara nga Komisioneri kundër Diskriminimit.	2019-2022	4,800,000	të gjitha ministritë e linjës	Avokati i Popullit në Shqipëri Komisioneri Kundër Diskriminimit	Të jenë zhvilluar fushata informimi te të huajt për zbatimin e normave mosdiskriminuese dhe për procedurat për zbatimin e të drejtave të tyre	Numri i migrantëve të informuar me anë të fushatave për normat mosdiskriminuese; numri i materialeve të prodhuara dhe të shpërndara; numri i migrantëve që kërkojnë zgjidhje ligjore çdo vit
		b. t'u jepet asistencë ligjore falas dhe informacion për të drejtat migrantëve të parregullt që janë të ndaluar	deri në fund të 2020	1,020,000	MD	Klinikat Ligjore Falas që menaxhohennga organizata të shoqërisë civile	Migrantëve të parregullt të ndaluar t'u jetë ofruar asistencë ligjore falas dhe informacion për të drejtat e tyre	Numri i migrantëve të parregullt të ndaluar që marrin asistencë ligjore falas çdo vit; përqindja e migrantëve meshkuj/femra

		c. gjatë lëshimit të lejes së punës dhe të qëndrimit, të shpërndahen fletë informuese për të drejtat e punëtorëve imigrantë dhe kontaktet e institucioneve/organeve/agjencive me të cilat mund të konsultohen në rast se shkelen të drejtat e tyre	deri në fund të 2020	410,400	SHKP		Imigrantëve t'u jenë shpërndarë fletë informuese për të drejtat e punëtorëve imigrantë dhe kontaktet e institucioneve/organeve/agjencive që mund të konsultohen në rast të shkeljes së të drejtave të tyre	Numri i materialeve informuese që u janë shpërndarë imigrantëve për të drejtat e tyre dhe kontaktet për të kërkuar mbështetje në rast të shkeljes së të drejtave të tyre
		D1.3 Përmirësimi i efektivitetit dhe monitorimi i mekanizmave të mbrojtjes a. të rishikohet aktiviteti aktual i Komisionerit kundër Diskriminimit në lidhje me monitorimin dhe mbrojtjen e të drejtave të të huajve me qëndrim në Shqipëri, sidomos me zbatimin e parimit të mosdiskriminimit; nëse mendohet e nevojshme, të caktohet një punonjës i veçantë që të fokusohet në vëzhgimin e respektimit të parimit të mosdiskriminimit për të huajt	2020	133,000	Komisioneri Kundër Diskriminimit	Parlamenti	Komisioneri të ketë paraqitur raportin me boshllëqet e identifikuara dhe rekomandimet përkatëse te Këshilli i Ministrave	Vënia në dispozicion e burimeve të nevojshme për Komisionerin Kundër Diskriminimit, përfshirë një punonjës të veçantë që ndjek respektimin e parimit të mosdiskriminimit për të huajt
		b. Bazuar në rishikimin e mësipërm, të prezantohet një procedurë e rregullt raportimi për monitorimin e respektimit të parimit të mosdiskriminimit në lidhje me të drejtat e migrantëve	2020-2022	608,000	Komisioneri për Mos diskriminimin		Komisioneri kundër Diskriminimit të ketë prezantuar një procedurë të rregullt raportimi për respektimin e parimit të mosdiskriminimit	Numri i raporteve periodike për pozicionin e të huajve në tregun e punës në Shqipëri të cilat janë hartuar dhe ndarë me palët e interesuara
		c. Të krijohet një njësi qendrore në Inspektoratin e Punës për të zbuluar dhe hetuar shkeljet kundër punëtorëve të huaj.	2021 dhe më tej	2,986,000	Inspektorati i Punës	MFE	Të jetë krijuar dhe të jetë funksionale një njësi qendrore në Inspektoratin e Punës që merret me zbulimin dhe hetimin e shkeljeve kundër punëtorëve të huaj	Numri i rasteve të shkeljeve kundër punëtorëve të huaj që janë zbuluar dhe hetuar çdo vit nga njësia e re e vendosur

								në Inspektoratin e Punës
		d. me anë të trajnimeve të forcohen kapacitetet e gjyqësorit dhe agjencive ligjzbatuese (gjyqtarë, prokurorë, policë, inspektorë të punës) për të zbuluar dhe ndjekur çështje të shkeljes së të drejtave të imigrantëve	2019-2022	1,440,000	MB	IOM Shkolla e Magjistraturës DBE	Të jenë organizuar seanca trajnimi për gjyqësorin dhe agjencitë ligjzbatuese për të zbuluar dhe për të ndjekur shkeljet e të drejtave të imigrantëve	Numri i stafit gjyqësor të trajnuar çdo vit për zbulimin dhe ndjekjen penale të rasteve të shkeljes së të drejtave të migrantëve; përqindja e meshkujve/femrave
D2	**Identifikimi i migrantëve si kategori vulnerabël për programimin dhe ofrimin e asistencës**	**D2.1 Përshtatja e asistencës për të përmbushur nevojat specifike të fëmijëve dhe të të rinjve** a. të sigurohet që kuadri ligjor dhe institucional ofron strehim për të miturit e pashoqëruar që kalojnë kufirin në mënyrë të parregullt, si edhe që burime të mjaftueshme vihen në dispozicion për këtë qëllim	deri në fund të 2020	5,760,000	MSHMS	MB MD	Ligji për shërbimet e kujdesit social të ketë ndryshuar që të ofrojë strehim për të miturit e pashoqëruar që kalojnë kufirin në mënyrë të parregullt Të jetë lënë mënjanë një fond rezervë që duhet të disbursohet për mirëmbajtjen e ambienteve pritëse	Numri i të miturve të pashoqëruar të parregullt që u ofrohet strehim çdo vit Masa e disbursimit të fondeve të alokuara
		b. të gjurmohet niveli i ofrimit të kujdesit social dhe mbështetjes për të miturit migrantë të pashoqëruar shqiptarë të kthyer nga vendet e destinacionit, familjet e të cilëve nuk janë identifikuar ose që janë konsideruar të braktisur nga prindërit dhe tyre; të evidentohen boshllëqet	deri në fund të 2020	228,000	MSHMB	DKM/MB	Të jenë përgatitur raporte të rregullta për shkallën e ofrimit të kujdesit dhe mbështetjes dhe për boshllëqet që duhet të trajtohen	Ofrimi i përmirësuar i kujdesit dhe i mbështetjes sociale për të miturit e pa shoqëruar të kthyer pa dokumentacion.

		D2.2. Trajtimi i nevojave specifike të migrantëve a. të vlerësohen aktet ekzistuese ligjore, procedurat administrative dhe skema të asistencës për punë që të identifikohen pengesat ndaj punësimit dhe mbrojtjes së të drejtave të grave në tregun e punës (me fokus tek imigrantët)	deri në fund të 2020	304,000	MFE	SHKP ISSH MSHMS IOM OJF-të aktive në mbrojtjen e të drejtave të grave	Të jetë vlerësuar kuadri ligjor dhe administrativ dhe të jenë identifikuar barrierat ndaj punësimit dhe mbrojtjes së të drejtave të migranteve në tregun e punës	Numri i ndryshimeve ligjore/administrative të miratuara për të siguruar të drejtën e punësimit dhe mbrojtjen e grave në tregun e punës
		b. bazuar në rezultatet e rishikimit, të zhvillohen dhe të zbatohen masat e synuara për të promovuar aksesin e migranteve në tregun e punës në Shqipëri. Të konsiderohet trajnimi i asistenteve femra që do të zhvillojnë konsultime me imigrantet, që do të publikojnë fletëpalosjet në gjuhët kryesore të përdorura nga imigrantet për t'i informuar ato për kontaktet e institucioneve shtetërore dhe OJQ-të që ndihmojnë në gjetjen e punësimit	2021-2022	480,000	MFE		Të jenë marrë masa për të promovuar aksesin e migranteve në tregun e punës në Shqipëri	Numri i fletëpalosjeve të prodhuara dhe të shpërndara në gjuhët kryesore të migranteve për t'i informuar ato për kontaktet e institucioneve shtetërore dhe OJQ-të që ndihmojnë për gjetjen e punësimit
D3	**Përmirësimi i kushteve për integrimin kulturor dhe socio-ekonomik të migrantëve**	**D3.1 Garantimi i të drejtës të barabartë për sigurime shoqërore** a. të identifikohen kategoritë e rezidentëve të huaj që nuk mbulohen me sigurime shoqërore mes të huajve, të zbulohen arsyet se përse ndodh kjo dhe të jepen rekomandime për ndryshimet e duhura ligjore dhe procedurale	2019-2022	1,641,600	ISSH/MFE	Këshilli i Ministrave	Të jenë bërë propozime për ndryshime në ligjin për shërbimet shoqërore 2016 dhe aktet nënligjore	Numri i propozimeve të miratuara nga Këshilli i Ministrave

		b. të informohen kategoritë e të huajve të identifikuar si më pak të informuar për mundësitë dhe përfitimet e sistemit kombëtar të sigurimeve shoqërore	deri në fund të 2020	600,000	ISSH/MFE		Të huajt të jenë të informuar mbi mundësitë dhe përfitimet që sjell sistemi kombëtar i sigurimeve shoqërore	Numri i fletëpalosjeve që janë shpërndarë për të sqaruar mundësitë dhe përfitimet nga sistemikombëtar i sigurimeve shoqërore; Nr. i të huajve që janë informuar mbi mundësitë dhe përfitimet nga mbulimi kombëtar i sigurimeve shoqërore çdo vit; % femra/meshkuj
		c. të bëhen ndryshimet e nevojshme në kuadrin ligjor që të sigurohet e drejta për kujdes social për të gjitha kategoritë e migrantëve të mitur	2020 -2022	570,000	ISSH/MFE	MSHMS MD IOM Bashkitë vendore UNICEF	Ligji për shërbimet shoqërore 2016 të jetë rishikuar që të sigurojë të drejtën për kujdesin shoqëror për të gjitha kategoritë e migrantëve të mitur	% rritje e numrit total të të miturve migrantë që përfitojnë kujdes shoqëror në Shqipëri çdo vit
		D3.2 Dhënia e të drejtës për strehim, kujdes shëndetësor dhe edukim a. të identifikohen dhe të hiqen pengesat për akses në shërbime publike për migrantët e parregullt; në veçanti, të rishikohen mundësitë për të ofruar shkollim parësor për fëmijët e migrantëve të parregullt dhe kujdes shëndetësor bazë për të huajt që nuk kanë status të rregullt (shtrirja përtej kujdesit në rast urgjent).	deri në fund të 2020	228,000	MSHMS	MFE MB	Të kenë bërë ndryshime ligjore (nëse të nevojshme) për të njohur shkollimin parësor për fëmijët e migrantëve të parregullt dhe kujdesin shëndetësor bazë për të huajt që nuk kanë status të rregullt	Numri i të huajve/fëmijëve që përfitojnë shkollim parësor dhe kujdes shëndetësor bazë çdo vit

		b. të rritet aksesi në shërbime publike për rezidentët e huaj duke u dhënë informacion (faqe interneti, aplikacione celulari, fletëpalosje, pika konsultative në zyra shtetërore) për pranueshmërinë, të drejtat, dokumentacionin e nevojshëm etj. në gjuhët që përdorin ata.	2019-2022	2,000,000	ADISA	Të gjitha ministritë e linjës përgjegjëse për zbatimin e këtij Plan Veprimi	Të jetë përforcuar e drejta për shërbime publike për rezidentët e huaj në Shqipëri me anë të ndarjes së informacionit	Numri i rezidentëve të huaj në Shqipëri që marrin çdo vit informacion për shërbimet publike përmes ADISA-s
		c. të trajnohen mjekët, infermierët dhe stafi spitalor dhe i kujdesit shëndetësor që të përmirësohen shërbimet ndaj të huajve dhe punëtorëve migrantë në vend duke kuptuar më mirë përcaktuesit e risqeve përkatëse shëndetësore dhe sociale si edhe ndikimin e kulturës te shëndeti dhe sëmundjet.	2019-2022	800,000	MSHMS	OBSH	Mjekët, infermierët dhe personeli spitalor dhe i kujdesit shëndetësor të jetë trajnuar për shërbime të përmirësuara ndaj të huajve dhe punëtorëve migrantë në vend	Numri i mjekëve, infermierëve dhe personelit spitalor dhe të kujdesit shëndetësor të trajnuar për ofrimin e shërbimeve për të huajt dhe punëtorët migrantë në vend
		D3.3 Hartimi dhe zbatimi i programeve të dedikuara të integrimit **a.** të bëhet një vlerësim i detajuar i kushteve të integrimit dhe barrierave si edhe modeleve të përdorimit të shërbimeve ekzistuese, përfshirë intervistat me të huajt që qëndrojnë në Shqipëri për të zbuluar nevojën për krijimin e programeve të dedikuara të integrimit	deri në fund të 2020	1,500,000	MB	MSHMS MASR MTM MK IOM Avokati i Popullit	Të jetë bërë vlerësimi i detajuar i kushteve të integrimit të të huajve me qëndrim në Shqipëri dhe të jenë formuluar rekomandime specifike për krijimin e programeve të dedikuara të integrimit dhe ato rekomandime të jenë ndarë me palët e interesuara	Hartimi dhe zbatimi i udhërrëfyesit për krijimin e programeve pilot dhe atyre të përhershme për promovimin e integrimit të të huajve në Shqipëri
		b. të hartohen programe përmes konsultave ndërinstitucionale që piketojnë nevojat e kategorive vulnerabël të të huajve dhe të monitorohet kërkesa për shërbime specifike	2021 -2022	6,000,000	MSHMS	Të gjitha ministritë e linjës përgjegjëse për zbatimin e këtij Plan Veprimi	Të jenë pilotuar programe që adresojnë nevojat e kategorive vulnerabël të të huajve; të jetë kryer monitorimi i vazhduar	Numri i nismave pilot të zbatuara për të përmirësuar integrimin e kategorive vulnerabël të të huajve në Shqipëri; numri i

								migrantëve që përfitojnë çdo vit nga programet
		c. Bazuar në rezultatet e monitorimit, të krijohen programe të përhershme të dedikuara integrimi dhe ato të modifikohen sipas ndryshimit të kërkesës	2021 -2022	1,140,000	MB	Të gjitha ministritë e linjës përgjegjëse për zbatimin e këtij Plan Veprimi	Të jenë krijuar programe të përhershme të dedikuara për integrimin për shtetasve të huaj rezidentë në Shqipëri; të jetë kryer monitorimi i vazhduar	Numri i programeve të përhershme që janë zhvilluar për riintegrimin e të huajve; buxheti i alokuar nga institucionet qeveritare çdo vit
D4	**Ofrimi i zgjidhjeve të qëndrueshme për imigrantët**	**D4.1 Lehtësimi i fitimit të qëndrimit afatgjatë dhe qëndrueshmëria e këtij statusi** a. të vazhdohet përafrimi i procedurës për lejen e qëndrimit afatgjatë me legjislacionin e BE-së	deri në fund të 2020	190,000	MB	MD	Të jenë hartuar raporte periodike mbi ndryshimet e nevojshme në lejen e qëndrimit afatgjatë në përputhje me legjislacionin e BE-së	Numri i ndryshimeve të miratuara në ligjin për të huajt që përfshijnë afatet standarde për kohëzgjatjen e procedurës së lejes të qëndrimit afatgjatë
		b. të njoftohen aplikantët me shkrim për arsyet e refuzimit të aplikimit dhe procedurën e ankimimit	deri në fund të 2020	760,000	DKM/MB		Të jetë përgatitur dhe në përdorim njoftimi standard me shkrim për refuzimin e aplikimit dhe procedurën e ankimimit për qëndrim afatgjatë	Numri i njoftimeve standarde me shkrim për refuzimin e aplikimit dhe procedurën e ankimimit për lejen e qëndrimit afatgjatë
		c. të hartohet material informues për aplikantët për qëndrim afatgjatë, që interpreton qartë kërkesat (sidomos periudha e qëndrimit pa ndërprerje dhe	deri në fund të 2020	300,000	DKM/MB		Të jenë përgatitur dhe shpërndarë materiale informuese për kërkesat për qëndrim afatgjatë	Numri i materialeve informuese për kërkesat për leje qëndrimi të shpërndara çdo vit

		njohuritë gjuhësore) dhe të përshkruhet procedura						
		d. të sigurohet që jeta e familjes dhe interesat e fëmijës merren në konsideratë në rishikimin e rasteve të anulimit (ndërprerjes) së statusit të rezidentit afatgjatë, të ofrohen mundësi riaplikimi, përve+ se në ato raste që përbëjnë kërcënim serioz ndaj rendit publik dhe sigurisë kombëtare	deri në fund të 2020	760,000	DKM/MB		Të jetë ulur numri i dëbimeve; të jetë rritur numri i kthimeve vullnetare	Numri i rasteve të dëbimit dhe numri i riaplikimeve pas largimit
		D4.2 Ofrimi i një rruge të qartë drejt shtetësisë a. të vendosen afate standarde për kohëzgjatjen e procedurës së natyralizimit; të vendoset njoftimi i detyrueshëm i aplikantit në rast kur vendimi i Presidentit nuk mund të jepet brenda kësaj periudhe standarde.	2019-2022	3,040,000	MB		Të jetë aplikuar afati standard për kohëzgjatjen e procedurës së natyralizimit dhe njoftimit përkatës	Numri i imigrantëve që aplikojnë çdo vit për natyralizim
		b. të njoftohen me shkrim aplikantët për rezultatin e rishikimit nga Ministria e Brendshme dhe për vendimin e Presidentit, duke parashtruar shkaqet e refuzimit	deri në fund të 2020	912,000	MB		Të jetë krijuar dhe aplikuar procedura e njoftimit me shkrim për refuzimin e shtetësisë shqiptare	Numri i aplikantëve të njoftuar me shkrim për shkaqet e refuzimit të shtetësisë shqiptare
		c. të përgatitet material informues për aplikantët për shtetësi që interpreton qartë kërkesat (sidomos periudhën e qëndrimit pa ndërprerje dhe njohuritë gjuhësore) dhe të përshkruhet procedura	deri në fund të 2020	300,000	MB		Të jetë shpërndarë material informues për aplikantët për shtetësi shqiptare për kërkesat që duhen përmbushur	Numri i materialeve informuese të shpërndara për aplikantët për shtetësi shqiptare
		D4.3 Garantimi i statusit ligjor të familjarëve a. Në përputhje me Konventën për të Drejtat e Migrantëve dhe	deri në fund të	760,000	MB	MFE MEPJ	Të jetë ndërmarrë ndryshimi i ligjit për të huajt që të parashikohen të drejtat e familjarëve të të huajve	Ndryshimet ligjore miratuar nga Parlamenti i Shqipërisë

		Anëtarëve të Familjes së tyre, të ndryshohet ligji për të huajt që të parashikojë të drejtat e familjarëve të të huajve me qëndrim të rregullt dhe të afirmojë parimin e statusit të tyre të barabartë	2020			MSHMS IOM	me qëndrim të rregullt dhe të afirmohet parimi i statusit të tyre të barabartë	
		b. të garantohet e drejta e anëtarëve të familjes për të marrë leje qëndrimi të pavarur kur plotësohen kushtet	deri në fund të 2020	304,000	DKM/MB		Ndryshimi ligjor të formulojë shprehimisht të drejtën për lejë qëndrimi të pavarur	Statistika të familjarëve që aplikojnë për leje të pavarura në rast vdekjeje ose divorci
		c. në interpretimin e nenit 34 të ligjit për të huajt, të konsiderohet ripërtëritja e lejes së qëndrimit të dhënë për bashkim familjar në rast divorci, nëse në marrëdhënie janë të përfshirë fëmijë, dhe në rast se largimi i të huajit nga vendi do ta bënte të pamundur jetën familjare me fëmijën/fëmijët	në vazhdimësi	760,000	DKM/MB		Ripërtëritja e lejes së qëndrimit të dhënë për bashkim familjar në rast divorci; nëse në marrëdhënie janë të përfshirë fëmijë të jetë marrë në interpretim të ligjit për të huajt	Statistika të procedurave sipas nenit 34 të ligjit për të huajt
		d. të prezantohet një procedurë e shpejtë për shqyrtimin e aplikimeve për leje pune nga mbajtësit e lejes së qëndrimit për bashkim familjar	2020	228,000	MFE		Të jetë krijuar procedura e shpejtë për shqyrtimin e aplikimeve për leje pune nga mbajtësit e lejes së qëndrimit për bashkim familjar	Numri i aplikimeve për leje pune nga mbajtësit e lejes për bashkim familjar të shqyrtuara me procedurë të shpejtë çdo vit

VENDIM
Nr. 416, datë 21.6.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 313, DATË 15.5.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2019, MIRATUAR PËR KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E VETËQEVERISJES VENDORE TË VITIT 2019"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 86, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikat 1 dhe 2, të vendimit nr. 313, datë 15.5.2019, të Këshillit të Ministrave, shifra 130 000 000 (njëqind e tridhjetë milionë) ndryshon dhe bëhet 200 000 000 (dyqind milionë).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 431, datë 26.6.2019

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIKUALIFIKIMI I SHESHIT 'ITALIA'", TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", si dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikualifikimi i sheshit 'Italia'", Tiranë.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, në shumën e përgjithshme 107 402 334 (njëqind e shtatë milionë e katërqind e dy mijë e treqind e tridhjetë e katër) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 107 402 334 (njëqind e shtatë milionë e katërqind e dy mijë e treqind e tridhjetë e katër) lekësh, të përballohet, si më poshtë vijon:

a) fondi prej 40 000 000 (dyzet milionë) lekësh, nga fondet e miratuara për shpronësim për Bashkinë Tiranë;

b) fondi prej 67 402 334 (gjashtëdhjetë e shtatë milionë e katërqind e dy mijë e treqind e tridhjetë e katër) lekësh, nga fondet e miratuara për Bashkinë Tiranë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2019, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, në zyrat e Bashkisë Tiranë.

8. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, të fillojë procedurat për

hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasurinë e shpronësuar në favor të Bashkisë Tiranë.

9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit.

10. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË PROJEKTIT "RIKUALIFIKIMI I SHESHIT 'ITALIA'", TIRANË

Nr.	Emër Mbiemër	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. totale truall m²	Sip. truall i prekur m²	Çmimi truall lek/m²	Sip. totale objektit m²	Sip. objektit e prekur m²	Kosto e ndërtimit Obj. lek/m²	Vlera në lekë	Lloji i dokumentit	Shënime në kartelë
1	Shtet	"Rrugë"	8160	7/14	1,442	53	66,969				**0**	shkresa nr. prot. 20/2, datë 20.5.2019, e ZVRPP Tiranë	
2	Shtet	"Truall"	8160	7/26	42	42	66,969				**0**	shkresa nr. prot. 20, datë 8.5.2019, e ZVRPP Tiranë	
3	Shtet	"Truall"	8160	7/25	174	174	66,969				**0**	shkresa nr. prot. 20, datë 8.5.2019, e ZVRPP Tiranë	
4	Shtet	"Truall"	8160	7/27	206	206	66,969				**0**	shkresa nr. prot. 20, datë 8.5.2019, e ZVRPP Tiranë	
5	Shtet	"Trotuar"	8160	7/8	1,524	610	66,969				**0**	shkresa nr. prot. 20, datë 8.5.2019, e ZVRPP Tiranë	
6	Shtet	"Truall"	8160	7/9	753	185	66,969				**0**	shkresa nr. prot. 20, datë 8.5.2019, e ZVRPP Tiranë	
7	Shtet	"Shesh"	8160	7/56	3,685	3142	66,969				**0**	shkresa nr. prot. 20, datë 8.5.2019, e ZVRPP Tiranë	
8	Bashkia Tiranë	"Truall"	8160	7/53	2,661	400	66,969				**0**	shkresa nr. prot. 20, datë 8.5.2019, e ZVRPP Tiranë	
9	Shtet	"Truall"	8160	7/54	16,927	118	66,969				**0**	shkresa nr. prot. 20, datë 8.5.2019, e ZVRPP Tiranë	
10	Shpëtim Mustafa Dama	"Truall"	8160	7/7	348	348	66,969				**23,305,212**	shkresa nr. prot. 20, datë 8.5.2019, e ZVRPP Tiranë	Në seksionin "E" ka shënimin: Vendoset masa e sekuestros konservative
11	Engjëll Bashkim Burimi	Njësi	8160	7/26/ND – N1	0	0		218	218.00	44,827.89	**9,772,480**	shkresa nr. prot. 20/2, datë 20.5.2019, e ZVRPP Tiranë	Në seksionin "E" ka shënimin: Vendoset hipoteka ligjore deri në shlyerjen e detyrimeve pranë ALUIZNI-t
12	Bashkim Arben Burimi Bianca Arben Burimi Sofia Arben Burimi	Njësi	8160	7/26/ND – N2	0	0		218	218.00	44,827.89	**9,772,480**	shkresa nr. prot. 20/2, datë 20.5.2019, e ZVRPP Tiranë	Në seksionin "E" ka shënimin: Vendoset hipoteka ligjore deri në shlyerjen e detyrimeve pranë ALUIZNI-t
13	Shpëtim Mustafa Dama	Njësi	8160	7/26/ND – N3	0	0		100	100.00	44,827.89	**4,482,789**	shkresa nr. prot. 20/2, datë 20.5.2019, e ZVRPP Tiranë	Në seksionin "E" ka shënimin: Vendoset hipoteka ligjore deri në shlyerjen e detyrimeve pranë ALUIZNI-t
14	Dorjan Istref Leknikaj	Njësi	8160	7/26/ND – N4	0	0		64.8	64.80	44,827.89	**2,904,847**	shkresa nr. prot. 20/2, datë 20.5.2019, e ZVRPP Tiranë	Në seksionin "E" ka shënimin: Vendoset hipoteka ligjore deri në shlyerjen e detyrimeve pranë ALUIZNI-t
15	Engjëll Bashkim Burimi	Njësi	8160	7/26/ND – N5	0	0		79.1	79.10	44,827.89	**3,545,886**	shkresa nr. prot. 20/2, datë 20.05.2019, e ZVRPP Tiranë	Në seksionin "E" ka shënimin: Vendoset hipoteka ligjore deri në shlyerjen e detyrimeve pranë ALUIZNI-t
16	Bashkim Arben Burimi Bianca Arben Burimi Sofia Arben Burimi	Njësi	8160	7/26/ND – N6	0	0		79.1	79.10	44,827.89	**3,545,886**	shkresa nr. prot. 20/2, datë 20.5.2019, e ZVRPP Tiranë	Në seksionin "E" ka shënimin: Vendoset hipoteka ligjore deri në shlyerjen e detyrimeve pranë ALUIZNI-t
17	Shpëtim Mustafa Dama	Njësi	8160	7/26/ND – N7	0	0		368	368.00	44,827.89	**16,496,664**	shkresa nr. prot. 20/2, datë 20.5.2019, e	Në seksionin "E" ka shënimin:

												ZVRPP Tiranë	Vendoset hipoteka ligjore deri në shlyerjen e detyrimeve pranë ALUIZNI-t
18	Engjëll Bashkim Burimi	Njësi	8160	7/26/Nd – N8	0	0		184	184.00	44,827.89	**8,248,332**	shkresa nr. prot. 20/2, datë 20.5.2019, e ZVRPP Tiranë	Në seksionin "E" ka shënimin: Vendoset hipoteka ligjore deri në shlyerjen e detyrimeve pranë ALUIZNI-t
19	Bashkim Arben Burimi Bianca Arben Burimi Sofia Arben Burimi	Njësi	8160	7/26/ND – N9	0	0		184	184.00	44,827.89	**8,248,332**	shkresa nr. prot. 20/2, datë 20.5.2019, e ZVRPP Tiranë	Në seksionin "E" ka shënimin: Vendoset hipoteka ligjore deri në shlyerjen e detyrimeve pranë ALUIZNI-t
20	Dorjan Istref Leknikaj	Njësi	8160	7/26/ND – N10	0	0		381	381.00	44,827.89	**17,079,426**	shkresa nr. prot. 20/2, datë 20.5.2019, e ZVRPP Tiranë	Në seksionin "E" ka shënimin: Vendoset hipoteka ligjore deri në shlyerjen e detyrimeve pranë ALUIZNI-t
	Totali				**27,762**	**5,278**		1,876	**1,876**		**107,402,334**		

1. Për tokën "truall", çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja nr. 89, datë 3.2.2016.
2. Për ndërtesat, vlerësimi është bërë sipas VKM nr. 138, datë 23.3.2000 (i ndryshuar) dhe sipas çmimeve të EKB-së, për qytetin e Tiranës, të miratuara me udhëzimin nr. 3, datë 28.12.2016 të Këshillit të Ministrave, vënë në dispozicion me shkresën nr. prot. 684, datë 27.3.2018.

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 1120 lekë